

UNË

**D
U
A**

TË

DËGJOHEM

**LIBËR KUJTIMI ME RRËFIMET E GRAVE TË
MBIJETUARA TË TORTURËS GJATË
LUFTËS SË FUNDIT NË KOSOVË**

PRISHTINË 2017

**UNË
DU
A
TË
DËGJOHEM**

**LIBËR KUJTIMI ME RRËFIMET E GRAVE TË
MBIJETUARA TË TORTURËS GJATË
LUFTËS SË FUNDIT NË KOSOVË**

**Integra
Prishtinë 2017**

Udhëheqësit e projektit:

Korab **Krasniqi**

Kushtrim **Koliqi**

Bashkëpunëtoret:

Atifete **Jahjaga**

Feride **Rushiti**

Vjollca **Krasniqi**

Koordinatore:

Sebahate **Pacolli**

Intervistuese:

Vjosa **Devaja**

Melita **Kallaba**

Selvije **Izeti Carkaxhiu**

Mimoza **Salihu**

Transkriptimi:

Dren **Berishaj**

Jeta **Rexha**

Lektura dhe editimi:

Arben **Ahmeti**

Dizajni:

Milky Way Creative

Shtypi:

Prograf

Publikuar nga

Integra

forumZFD - (Forum Civil Peace Service / Forum
Ziviler Friedensdienst e.V.)

Prishtinë

2017

Ky projekt implementohet nga **Integra** dhe **forumZFD** – programi në Kosovë në bashkëpunim me **Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarëve të Torturës**, me mbështetje nga **Rockefeller Brothers Fund**, **Charles Stewart Mott Foundation**, **Ministria Federale për Bashkëpunim** dhe **Zhvillim Ekonomik e qeverisë Gjermane**, dhe **UN Women**.

UNË DUA TË DËGJOHEM

Libër kujtimi me rrëfimet e grave të mbijetuara
të torturës gjatë luftës së fundit në Kosovë

UNË DUA TË DËGJOHEM

Libër kujtimi me rrëfimet e grave të mbijetuara të torturës gjatë luftës së fundit në Kosovë

Koncepti i torturës dhe i dhunës seksuale në luftë mund të mos kufizohet në akte të izoluara të kryera nga individët, për shkak se ato më përparrë përfshijnë një gamë të gjerë strategjish të projektuara jo vetëm për të shkatërruar njerëzit, por përfshijnë edhe ndjenjën e 'unit' dhe të të qenit "njeri". Dhuna seksuale dhe tortura gjatë luftës qëllimisht përdoren si instrumente të terrorist, zhvatjes së parave dhe detyrimit të njerëzve për t'u larguar nga votrat. Kjo është një takikë e gjerë dhe sistematike 'ushtarake' kundër një numri të madh të grave (dhe të burrave), që përdoret për të nënshtuar gjithë popullatën.

Dhuna seksuale gjatë luftës nuk mund të kuptohet dhe të trajtohet vetëm si një traumë diskrete (psikologjike apo fizike), që mund të trajtohet sistematikisht dhe të shërohet me kalimin e kohës, për shkak se ajo ka ndikim gjatë gjithë jetës dhe ndër breza. Gati dy dekada pas përfundimit formal të konfliktit në Kosovë, tregimet e torturës dhe abuzimit seksual po mbahen të heshtura (në shumë shtresa shoqërore) dhe jashtë metanarracionit të luftës dhe diskursit publik. Për më shumë, të mbijetuarat(it) e dhunës seksuale dhe të torturës në luftë i nënshtrohen stigmës shoqërore, përjashtimit dhe politikave jokonsistente institucionale. Familjet (në njëfarë mase) dhe njerëzit e dashur janë qarku i heshtjes, ku fshihet e vërteta.

"... Unë isha e plagosur në këmbë dhe krahëror. Ata nuk më kursyen. Nuk kishin konsideratë... Nga krahërori më rridhte shumë gjak. Nuk mbaj mend shumë... Kur m'u kthyvetë, mbaj mend se pashë dy burra përmbi mua; njëri po më mbante me forcë, tjetri po më...të gjitha u shkatërruan. Jashtë dhomës ishin fëmijët tanë dhe gra të tjera. Të gjithë kanë dëgjuar klithjet..." Ky është një fragment i një momenti të tmerrshëm, i treguar nga A.G. Ekzistojnë tregime të panumërtë të këtyre akteve degraduese, të cilat janë bërë dhe më degraduese duke u kryer në publik dhe para syve të njerëzve të dashur, fqinjëve, e nganjëherë, madje edhe para syve të njerëzve krejt të panjohur.

Këto tregime në këtë libër jepin një grumbull më të gjerë implikimesh për të gjitha gratë. Kjo jep një shembull se si tortura dhe dhuna seksuale u shërbejnë qëllimeve të pushtetit dhe represionit, gjë që na detyron të rishkojmë mënyrën se si e definojmë torturën, dhunën seksuale dhe mjetet e tjera të dhunës së ushtruar mbi gratë dhe po ashtu strategjitet që përdorim për të çrrënjosur dhunën me bazë gjinore në konfliktet e armatosura.

Vënia e të mbijetuarave të dhunës seksuale dhe torturës në qendër të vëmendjes në këtë libër, na shtyn të shqyrtojmë rolin e strukturave shtetërore, bashkësisë ndërkombëtare, shoqërisë civile, akademive, artistëve, hulumtuesve, etj. në trajtimin e dhunës me bazë gjinore gjatë luftës së fundit në Kosovë. Për të ardhur në këtë pikë, shumë çështje etike dhe metodologjike u

sollën në perspektivën e ciklit të projektit dhe gjithë procesit të mbledhjes së kujtimeve.

Më 14 maj 2015, në Prishtinë ishte organizuar një tryezë e rrumbullakët me hisedarët kyçë relevantë, bashkëpunëtorët, akademikët dhe institucionet përfaqësuese kombëtare dhe ndërkombe, për të diskutuar, reflektuar dhe grumbulluar rekomandimet për iniciativën. Ky takim solli rekomandime të mprehta që kontribojnë në një proces të drejtë dhe të strukturuar, i cili merr parasysh aspekte të rëndësishme si: kontributi në drejtësinë shoqërore dhe transacionale, ndërhyrja në narrativat mbizotëruar dhe hegjemonikë të luftës, tregimet e heshtura e të papranuara dhe përvojat e grave, qasja e mosdëmtimit dhe ritraumatizimit, fuqizimi i mbështetjes institucionale të ofruaa për të mbijetuarat, njojja ndërkombe, krimave të luftës të kryera kundër grave në Kosovë, etj. Nga ky takim doli një dokument (analizë) me udhëzime të qarta për procesin dhe hapat që duhen ndjekur. Si rezultat i kësaj, sot jemi të gatshëm të mbajmë këtë libër që shpalos 10 kujtime të kohës së luftës, të grave subjekte/objekte të torturës dhe sulmit seksual në luftë dhe dy burrave (bashkëshortë) në rolet mbështetëse. Të gjitha kujtimet e mbledhura dhe të dokumentuara në këtë libër, janë bërë në pajtim të plotë me të gjitha subjektet.

Metodologja e përdorur për mbledhjen e kujtimeve nga të mbijetuarat e torturës dhe dhunës seksuale në luftë, është ajo e Historisë Gjore. Ne e përdorëm këtë metodë për të marrë informata të larmishme që nuk mund të gjenden në burimet e shkruara dhe publike. Mbledhja e kujtimeve të grave në luftë ofron një bazament për parashikimin mbi të kaluarën e vështirë dhe aspektet gjinore në forma të reja, derisa reflektohet mbi dinamikat e të tashmes. Mbledhja e intervistave nga të mbijetuarat e torturës dhe të dhunës seksuale do të ndihmojë për ta kuptuar kohezionin e ngjarjeve para, gjatë dhe pas konfliktit, formimin dhe kontestimin e narrativave mbizotëruar dhe aspektave të veçanta, si identiteti gjinor.

Me këtë libër duam të dokumentojmë narrativën individuale të kujtimeve të grave në luftë, gjë që, për më shumë, do të kontribojë në procesin e ballafaqimit me të kaluarën, drejtësinë shoqërore dhe transacionale dhe në të njëjtën kohë, do të paraqesë një burim të qëndrueshëm për aktivistët e të drejtave të njeriut, grupet e vëzhgimit dhe të mbrojtjes, politikëbërësit, hulumtuesit, akademikët dhe artistët, për procesim të mëtutjeshëm.

"Unë dua të dëgjohem" është një libër i shpresës dhe i të vërtetës. Ripërjetimi i momentit dhe rivizitimi i vendit, ku dikush është lënduar, është i vështirë. Përmes jetës që të mbijetuarat e jetojnë sot, na është përkujtar krejt çfarë është e mundshme në prag të tmerrit.

Korab Krasniqi
Kushtrim Koliqi

Parathënie

Ishte një mëngjes i freskët në vjeshtën e vitit 2013. Mora veturën time dhe vozita afro një orë për të takuar një grua në Drenicë, rajon në qendër të Kosovës. Kisha biseduar me të në telefon më herët atë javë dhe ishim pajtuar që të takohemi po që se respektohej privatësia e saj e plotë. Ajo dëshironte të më takojë vetëm mua dhe dëshironte që unë të isha i vetmi njeri i pranishëm në dhomë në momentet që ajo do të rrëfente tregimin e saj. Për mua ishte bërë shumë e pazakontë të shkoja diku vetëm meqë kishte më shumë se dy vite prej se isha zgjedhur president dhe, si e tillë, isha vazhdimisht nën përcjelljen e pjesëtarëve të mbrojtjes së afërt. Por, atë mëngjes vendosa të shkëputem tërësisht nga realiteti im personal për të fituar një pasqyrë të plotë e të vërtetë të jetës se dikujt tjetër.

Ne u takuam në një kafeteri në një qytet të vogël, jo shumë larg fshatit të saj, dhe u ulëm në një kënd të qetë për të biseduar. Nuk e kisha takuar kurrë më parë. Megjithatë, ndjeja një lloj afërsie të pashpjegueshme me të. Shqetësimi i saj vërehej, duart dhe zëri i dridheshin, sytë i kishte të hapur plotësisht duke më shikuar me një shprehje që nuk do ta harroj kurrë. Në sytë e saj shihja frikë, por shihja gjithashtu shpresë, pritje, dhe lehtësim. Ajo ishte një nga të mbijetuarat e para të dhunës seksuale gjatë luftës me të cilën jam ulur ballë-për-ballë por, siç do ta dëshmonte e ardhmja, ajo fatkeqësisht nuk do të mbetej e vtmja. "Me trevo çkado që ke nevojë të më tregosh. Mos u ndjej e obliguar të flasësh për çkado nëse nuk ndihesh rehat", i thashë që në fillim të bisedës sonë.

Rrëfimi i saj ishte përplot vuajtje e dhembje.

Rrëfimi i saj më preku shumë; më tronditi; më shokoi. Derisa po e dëgjoja përjetova një furtunë ndjenjash të përziera: pafuqi, keqardhje, zhgënjim, dhe vuajtje. Ndihesha e pafuqishme sepse nuk kisha qenë në gjendje ta ndihmoja në kohën kur ajo po përdhunohej. Më vinte keq dhe, në të njejtën kohë, isha e zemëruar për faktin se ajo kishte përjetuar atë krim të tmerrshëm. Poashtu, isha thellësisht e zhgënjyer dhe e inatosur me sistemin tonë i cili ia kishte kthyer shpinën kësaj gruaje përfshirë pesëmbëdhjetë vite.

Lexuesit me gjasë do të kalojnë nëpër të njejtën valë emocionesh kur do të lexojnë rrëfimet e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë të mbledhura në këtë libër. Gratë që flasin përfshirë përjetimet e tyre në këtë libër i bëjnë të dukshme plagë e thella që lufta e 1998-1999 ka lënë në rreth 20.000 gra e burra që vlerësohet se janë përdhunuar seksualisht gjatë luftës në Kosovë. Rrëfimet flasin përfshirë se si janë përfballur të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës me paragjykimet, stigmatizimin, dhe diskriminimet në përpjekjet e tyre të përditshme përfshirë paqe dhe përfshirë

marrë drejtësinë e merituar. Për më shumë, rrëfimet e mbledhura në këtë libër na japid më shumë hollësi mbi efektet e dëmshme që mund të ketë mentaliteti patriarchal i një shoqërie dhe mungesa e vullnetit për t'u ballafaquar me të kaluarën mbi procesin e shërimit dhe atë të ndërtimit të paqës.

Përgjatë viteve të fundit, kam dëgjuar shumë rrëfime nga gratë si ajo që takova para tre vitesh në Drenicë. Kam qarë me ato që kanë pasur nevojë të qajnë me mua, dhe kam qëndruar stoike me ato të cilat kanë pasur nevojë të më shohin më të fortë. E ndjeja si obligim timin moral që si femër të jem e gatshme t'i dëgjojë, t'u zgjas dorën përt'indihmuar e mbështetur, dhe t'u lejojë që të flasin përmes zërit tim.

Në vitin 2014, inicova themelimin e Këshillit Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale Gjatë Luftës në Kosovë, i cili bashkoi në një tryezë përfaqësuesit e qeverisë, të komunitetit ndërkombëtar, dhe të shoqërisë civile në vend. Së bashku arritëm t'i shtyjmë përrpara shumë çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë duke krijuar kushte më të mira për qasje në shërbimet shëndetësore, edukim, dhe fuqizim ekonomik. Instalacioni artistik i Alketa Xhafa-Mripës "Mendoj për Ty" që u realizua nën patronatin tim si presidenti ishte një kontribut i jashtëzakonshëm në procesin e shërimit kolektiv meqë inkurajoi solidaritet shoqëror me viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Pas varjes së mijëra fundeve e fustaneve në stadiumin e futbollit në Pristhinë si akt që simbolizoi mbështetjen përviktimat, dhuna seksuale gjatë luftës nuk trajtohet si temë e fshehtë më.

Me të vërtetë është bërë shumë, por duhet të bëhet edhe më shumë. Procesi i verifikimit të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë pritet të nisë shumë shpejtë, dhe shpresoj se ky libër do të inkurajojë më shumë viktima të dhunës seksuale gjatë luftës që të dalin përrpara me rrëfimet e tyre dhe të aplikojnë përtë drejtat që u takojnë.

Do doja që kurrë të mos kisha pasur nevojë të shkruajë parathënien për një libër mbi dhunën seksuale gjatë luftës në Kosovë. Do doja që kurrë të mos kishte ndodhur lufta në Kosovë. Por, fatkeqësisht, këto krimet kanë ndodhur. Është për keqardhje që, edhe pas më shumë se 17 vitesh, ne ende nuk jemi ballafaquar tërësisht me pasojat e luftës dhe gjëra që kanë ndodhur me të vërtetë gjatë asaj kohe.

Besoj fuqishëm që ky libër do të mbështes procesin e ndërtimit të paqës në Kosovë duke shërbyer si një mjet i rëndësishëm në përpjekjet tona për t'u ballafaquar me të kaluarën dhe përtatthyer kulturën e mosndëshkimit të atyre që kanë kryer këto krimet.

Le të na shërbejë ky libër si përkujtues për atë që i ka ndodhur popullit tonë. Dhe, le t'u mundësojë gjeneratave të ardhshme të popullit në Serbi të mësojnë nga gabimet e tmerrshme të paraardhësve të tyre në mënyrë që këto krimet mizore të mos përsëriten kurrë më.

Atifete Jahjaga
Presidente e Republikës së Kosovës
(2011-2016)

LUFTIMI I STIGMËS DHE PARAGJYKIMEVE: PËRPJEKA PËR NJOHJE SHOQËRORE DHE LIGJORE TË TË MBIJETUARAVE TË DHUNËS SEKSUALE NË LUFTË

Rëndësia e disuktimeve në lidhje me dhunën seksuale si krim lufte

Kosova ka dalë nga një luftë që solli shumë mizori, vrasje masive, shkaktoi zhdukje, vrasje [jashtëgjyqësore] dhe dhunë seksuale e përdhunime të lidhura me konfliktin. Me shekuj, përdhunimi i organizuar ka qenë aspekt integral i luftimit, që synon të shkaktojë trauma dhe, në këtë mënyrë, t'i shkatérrojë lidhjet familjare dhe solidaritetin e grupit brenda kampit armik. Dhuna seksuale e kryer në Kosovë ishte pjesë e një modeli të akteve kriminale të kryera në kontekstin e një agresioni masiv.

Së dyti, përdhunimi është pëedorur nga trupat serbe jo vetëm për t'i abuzuar vetë gratë, por edhe për të shkaktuar lëndim dhe mllif tek burrat e tyre¹. Duke i sulmuar seksualisht këto gra, trupat serbe janë përpjekur të përhapin animozitet mes familjeve kosovare dhe të largojnë bashkëshortët nga gratë e tyre. Vajzat ishin "përdhunuar në grup para syve të baballarëve të tyre, gratë përpara syve të burrave... vetëm për të dehumanizuar, vetëm për të përulur."² Edhe pse këto përdhunime janë kryer pa pajtimin e këtyre grave, burrat prapëseprapë janë larguar nga bashkëshortet kur këto krimet kanë ndodhur. Arsyja për këtë është shnderimi: Gratë e "prekura" ... kanë sjellë turp në shtëpitë e bashkëshortëve" dhe shnderim mbi familjen për shkak se "sapo ta prekësh gruan, ke prekur nnderin e familjes dhe ke provokuar reagimin e burrit".

Ekzistojnë tregime të panumërtë të këtyre akteve degraduese, të cilat janë bërë dhe më degraduese duke u kryer në publik dhe përpara syve të njerëzve të dashur, fqinjëve, madje, nganjëherë, edhe përpara njerëzve krejt të panjohur.³

Problemet e trashëguara kulturore dhe mentaliteti i shpërfilljes

Ndërsa vitet e pasluftës kanë shënuar fillimin e një vetëdijeje më të lartë ndaj përdhunimit dhe mbrojtjes kundër tij, ekzistojnë shumë viktima kosovare që nuk kanë paraqitur pretendimet dhe rastet e tyre, e të cilat ende nuk janë trajtuar. Vendimet për rastet ende janë duke u marrë edhe tanë, më shumë se dhjetë vjet më pas, më së shumti për paditësit që kanë aplikuar jashtë shtetit, që kanë këruar azil në vendet e huaja, me të vetmin justifikim të "frikës për të qëndruar në Kosovë".

Me mungesën e "inventarit të krimit", me traumën, paragjykimin dhe me shumë barriera institucionale dhe ligjore, përpjekja kundër dhunës seksuale dhe me

¹ Shih p.sh., Amra Zejneli, *Sa gjatë mund ta mbash një sekret? Për Viktimat e përdhunuara gjatë luftës në Kosovë, përgjigja është: nadoshta përgjithmonë*, Radio Free Europe/Radio Liberty (3 gusht 2015), <http://www.rferl.org/content/kosovo-wartime-rape-victims-kept-secret/25403115.html>

² Markus T. Funk, *Victims' Rights and Advocacy at the International Criminal Court*, (2010).

³ Donatella Lorch & Preston Mendenhall, *A War's Hidden Tragedy: Newsweek and MSNBC Revisit Kosovar Albanian Women raped During the War* 3 (Aug. 8, 2000) http://www.donatellalorch.com/articles/scars_of_war.pdf.

bazë gjinore (DhSBGj) gjatë luftës ka bërë thirrje për vëmendje dhe nevoja të mbijetësës. Të dhënët e sotme vlerësojnë një shifër ndërmjet 10,000 deri 20,000 viktimate.

Ndërkohë që nuk janë shpalosur shifrat se sa gra në Kosovë kanë vuajtur nga probleme të shëndetit mental apo kanë vrarë veten, raporte të ndryshme dhe puna jonë në terren tregojnë se këto krimet seksuale kanë shkaktuar efekt shkatërrues. Frika e refuzimit dhe izolimit nga vetë familjet e tyre dhe nga komuniteti ka reflektouar në pasojat psikologjike që kanë penguar rehabilitimin, qasjen në drejtësi dhe riintegrimin socio-ekonomik. Për një kohë të gjatë, ato e kanë konsideruar veten si të "lëna vetëm". Mbetjet psikologjike dhe efektet e përdhunimit nuk janë të lehta për t'u trajtuar. Çrregullimi i stresit post-traumatik, depresioni e madje edhe dëshira për vetëvrasje, janë vetëm disa nga efektet afatgjata të dhunës seksuale që i plakosin këto gra.

Të gjithë këta faktorë shoqërorë (pabarazia ekzistuese gjinore dhe stereotipet), vështirësitë ekonomike dhe mungesa e çdo perspektive gjinore, kanë krijuar parakushtet për eskalim të dhunës në familje dhe torturë psikologjike. Këta faktorë kanë ndikuar negativisht në kushtet e të "mbijetuarave"; dhe me këtë, kanë ndikuar në jetën e të afërmve të drejtëpërdrejtë (veçanërisht fëmijëvë të tyre), që kanë trashëguar traumë të gjeneratës-së-dytë dhe efekte të lidhura me to.

Pyetja mbetet: si mund të arrihet drejtësi totale në Kosovën e pas-konfliktit, kur "ndjekja penale" ende nuk është e mjaftueshme? Si mund të arrihet ajo, kur edhe në rastet e fundit, viktimate nuk u garantohet lehtësim përkundër ofrimit të dëshmive se kanë përfjetuar dhunë seksuale në të kaluarën? Pasojat e tjera të luftës, si dëmtimi i pronës, papunësia dhe plagët fizike, mund të shërohen dhe të sanohen përgjatë kohës. Ndërsa ndjekja penale ndihmon mbajtjen e kriminelëve të pasojave shkatërruese të përdhunimit, larg nga rruga dhe në burgje, ekzistojnë rrugë të shumta ku Kosova po lëviz në drejtim të drejtësisë transacionale në adresimin e aspekteve tjera të kësaj çështjeje.

Thyerja e tabuve, heshtja dhe dhuna

Ky seksion do t'i dedikohet angazhimit tim personal, përkushtimit profesional përgjatë më shumë se 17 vjetëve të punës kushtuar grupeve të marginalizuara të të mbijetuarve të luftës dhe viktimate të torturës.

Gjatë luftës, isha mjeke që po kryeja specializimin për Mjekësi në Universitetin e Tiranës. Kontakti im i parë me refugjatët kosovarë ishte në Spitalin Universitar. Më kujtohet se po kërkonin trajtim mjekësor dhe mbështetje psikologjike. Menjëherë vendosa që të angazhoheshë vullnetarisht përmes një OJQ-je vendore në Tiranë, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit nga Trauma dhe Tortura, e cila (në atë kohë) ishte e angazhuar në programin emergjent që ndihmonte të mbijetuarit e luftës dhe fëmijët refugjatë në Kukës, Tiranë dhe Durrës. Fillova punën në strehimoret emergjente, ku ndihmoja familjet kosovare që forcërisht dhe masivisht ishin dëbuar nga qytetet, fshatrat, shtëpitë. Vuajtja njerëzore

më dha një forcë të jashtëzakonshme që të ndryshoj jetën time bashkë me orientimin profesional dhe të bëhem një "mbrojtëse e të drejtave të njeriut" dhe person i palodhshëm drejt emancipimit shoqëror dhe ndryshimit të qëndrueshëm.

Fluksi i kthimit të kosovarëve në shtëpitë e tyre kërkonte ndërhyrje më të gjerë dhe mbështetje të menjëherëshme për përballimin e traumës. Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimate të Torturës ishte kriuar si përgjigje ndaj nevojës për mbështetje mjekësore dhe psikologjike për viktimat e torturës dhe dhunës sistematike në mesin e popullatës civile gjatë luftës. Ky përkushtim është arritur me ambicjen e madhe për të kthyer shpresën dhe jetën për ato(a) që vuanin nga pasojat shpirtërore, mentale dhe fizike të luftës. Qendra filloi menjëherë të ofrojë këshilla dhe asistencë nga mjekët, psikologët, punëtorët socialë dhe këshilltarët ligjorë përviktimat e përdhunimit.⁴

Këto të gjitha ishin mënyra reaktive të trajtimit të një konflikti të tillë mizor, megjithatë, QKRT (KRCT) vazhdimesh ka ndërmarrë masa të shumta proaktive që ofrojnë shpresë për popullatën femërore të Kosovës. Gratë ishin grupe kryesore i mbetur pas luftës, për të ndihmuar shërimin e kombit dhe për të ngritur vetëdijen për këto çështje, pasi që afro 12,000 njerëz, një pjesë e madhe e së cilëve burra, ishin vrarë gjatë luftës.

Roli i pazendësueshëm i shoqërisë civile në procesin e njohjes

Qoftë në fazën fillestare të ndihmës emergjente a në rindërtimin e mëvonshëm kompleks dhe të gjatë të shoqërisë civile në Kosovë, OJQ-të kanë ndërmarrë një numër detyrash kyçë, të cilat shteti ose aktorët multilaterale ngurrojnë ose nuk kanë mundësi t'i kryejnë.

Përpjekjet e jashtëzakonshme nga aktorët e shoqërisë civile dhe lidereve të grave, vazhdimesh kanë adresuar nevojën përnjohje ligjore përgjatë tilla të marginalizuara dhe zëri ynë është dëgjuar vetëm pas një dekade, përgjatë procesit të njohjes së statusit të "veteranëve civilë të luftës" nga të mbijetuarat(e) DhsBGj.

Procesi i njohjes ligjore është përkrahur fuqimisht nga Këshilli Kombëtar për të Mbijetuarat e Dhunës Seksuale dhe nga angazhimi personal i Presidentes së Republikës, Znj. Atifete Jahjaga, me mbështetjen e të mbijetuarave përmes takimeve personale me to dhe duke dëgjuar nevojat e tyre. Prioritizimi i nevojave për kategoritë e të mbijetuarave ishte një çështje e lartë prioritare për Presidenten dhe kjo drejtpërdrejt u bë mundësia e vetme për Shoqërinë Civile për të artikular nevojat për rehabilitim psikologjik dhe mjekësor sikur edhe përfuqizim ekonomik. Fushata të ndryshme dhe aktivitete mediale janë organizuar për të kontribuar drejtpërdrejt në ndryshimin e mentalitetit dhe perceptimit social me qëllim të krijimit të momentumit për njohjen e viktimate

⁴ Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimate të Torturës,
<http://krct.org/site/images/documents/reports/annual/en/ANNUAL%20REPORT%202005.pdf>

që vuajnë... mirëpo ende nevojitet shumë punë.

Paralelisht me këto aktivitete, ne kemi kontribuar me hartimin e legjisacionit sekondar sikur edhe me përgatitjen dhe finalizimin e Formave të Aplikacionit për të mbijetuarat, për qasje tek komisioni shtetëror për identifikim dhe dokumentim.

Në këtë fazë, duhet të bëhet një kërkesë urgjente për themelimin e Komisionit Shtetëror për Dokumentim dhe Hetim, që do të adresonte mbështetje të mëtutjeshme për të mbijetuarat në nevojë dhe mbështetje të vazhdueshme psikosociale dhe mjekësore. Vëmendje e posaçme duhet t'u kushtohet menjëherë atyre viktimate që janë të gatshme për të dëshmuar dhe për të pasur qasje në drejtësi, atyre që duan të thyejnë heshtjen dhe të kërkojnë reparacione dhe dëmshpërblim, sikurse edhe fuqizim ekonomik.

Këtyre grave duhet t'u garantohet, me të gjitha mjetet, qasja e plotë në shkollim, duhet të lejohen të hyjnë në çdo lloj të fuqisë punëtore që e zgjedhin dhe të "konfirmojnë se proceset gjyqësore dhe institucionet e konfliktit, post-konfliktit dhe ato transicionale janë të ndjeshme nga ana gjinore. . . njohin statusin ligjor të viktimate të përdhunimit, publikisht njohin shkallën e përvojave të tyre, kompensojë ato përlëndimet e tyre dhe të ndjekë penalisht kryesit e këtyre veprave." Të gjitha këto veprime demonstrojnë se jo vetëm institucionet si tërësi janë të përkushtuara përfuqizimin e zërit të grave, por se vetë femrat janë po ashtu forcë shtytëse e kësaj kryqëzate për kërkimin e drejtësisë shoqërore.

Neglizimi, braktisja ose anashkalimi i trajtimit të DhSBGj ndaj grave dhe vajzave gjatë luftës, është një "gabim" që shkakton dështimin e sundimit të ligjit dhe një barrierë për konsolidimin e një shoqërie paqësore me mirëqenie të garantuar.

Feride Rushiti,

Drejtoreshë ekzekutive në Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT)
Prishtinë, 2016

DHUNA SEKSUALE NDAJ GRAVE NË LUFTË: FUQIZIMI PËRMES RRËFIMIT

Asgjë të re nuk themi kur themi se dhuna seksuale në luftë duhet të kuptohet si armë luftë. Dhuna seksuale ndaj grave - posaçërisht dhunimi, ka përcjellë të gjitha luftërat e bëra për qëllime të ndryshme politike dhe ushtarake. Deri vonë, ky fenomen, përkundër përsëritjes së shpeshtë, në shumë histori, kultura e shoqëri është heshtur dhe mbajtur i fshehur. Kështu, shumë rrëfime të grave që kanë përjetuar dhunimin kanë mbetur të pa treguara dhe të padëgjuara. Në dekadat e shekullit të kaluar, veçanërisht lufta në Bosnje dhe Hercegovinë bëri që dhuna seksuale dhe dhunimi të vihet në vëmendje të së ashtuquajturës 'bashkësi ndërkombe tar', akademisë dhe aktivisteve për të drejtat e grave. Feminizmi luajti një rol të madh në paraqitjen e dhunës ndaj grave në luftë si pjesë e pandashme e luftës (Stetz 2001). Në vitet e 1990-ta, në statutet e Tribunalit Ndërkombëtar për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi dhe në Tribunalin Ndërkombëtar për Krime të Luftës në Ruandë, dhunimi dhe dhuna seksuale u kodifikuan si krime luftë. Kampet e dhunimit në Bosnje dhe Hercegovinë luajtën një rol të rëndësishëm për arritjen e këtij qëllimi. Dhuna seksuale në luftë është problem universal: në Bosnjë dhe Hercegovinë, në Kosovë, në Ruandë, në Timorin Lindor, në Irak, në Siri etj., gratë dhe vajzat ende vuajnë nga dhuna seksuale e përjetuar në luftë.

Feministet qe një kohë të gjatë pohojnë se kombi, identiteti kombëtar dhe nacionalizmi janë konstrukte shoqërore të pabarabarta gjinore. Ato argumentojnë se në diskursin nationalist gratë luajnë role të ndryshme biologjike, prodhuese shoqërore, kulturore, dhe si vepruese (Yuval-Davis 1996, 1997; Peterson 1999), gjë që ato i bën shënjestë të dhunës në luftë. Siç theksion Lene Hansen, dhunimi i 'grave të kombit' është pjesë e luftës dhe jo akt i dhunës ndaj grave individuale. Përmë shumë, dhuna seksuale shërben si qëllim për instalimin e një maskuliniteti të shfuqizuar si pjesë përbërëse e identitetit të burrave. Përmes dhunimit dhe torturave fizike në luftë (ndaj vajzave dhe grave) synohet shkatërrimi i një grupei specifik - kombit/etnisë.

Gjatë luftës në Kosovë, në vitet 1998-1999, dhunimi dhe dhuna seksuale ndaj grave ishin instrument i luftës dhe pjesë e strategjisë për spastrim etnik. Dhunimi ishte një mjet i qëllimshëm i luftës. Për një kohë të gjatë, për hulumtuesit/et e krimeve të luftës mbledhja dhe dokumentimi i rasteve të dhunimeve ishte një punë mjaft e vështirë. Shkalla e vërtetë e dhunës seksuale në Kosovë mund të mos dihet kurrë. Dhunimi në luftë është një çështje shumë e ndjeshme. Për shkakun se stigma që përcjell dhunimin është e fuqishme, shumë të mbijetuara/r të dhunës seksuale në luftë vazhdojnë të heshtin. Viktimat e dhunimit mendojnë se paraqitja e dhunimit mund ta

shkatërrojë të ardhmen e tyre, se mund t'i stigmatizojë familjet e të mbijetuarave dhe mund t'i ri-traumatizojë të mbijetuarat.

Dhuna seksuale në luftë, e ndrydhur pasluftës, meriton më shumë diskutim. Dhunimi në luftë nuk ka prekur vetëm gratë, por edhe burrat. Dhuna seksuale në luftë ka qenë rezultat i persekutimit politik. Në pasluftë, një kohë të gjatë, dhunimi ka qenë një kategori e heshtur e viktimate civile të luftës. Në vitet e fundit, si rezultat i aktivizmit të shtuar të grave, dhuna seksuale në luftë u bë pjesë e diskursit të drejtësisë dhe e politikës sociale. Disa të mbijetuara të dhunës seksuale në Kosovë kanë vendosur që të mos jetojnë më me heshtjen. Ato kanë vendosur që të rrëfejnë për tmerrin, dhembjen dhe humbjen e përjetuar.

Në këtë libër, disa nga gratë e mbijetuara të dhunës seksuale në luftë, dhe bashkëshortët e tyre, rrëfejnë përvojat e tyre të luftës. Ato rrëfejnë historitë e tyre personale të luftës, duke e vënë theksin te dhuna që ato vetë e kanë përjetuar. Përvojat e tyre janë përvoja edhe të shumë grave të tjera jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë. Rrëfimet e tyre janë më të fuqishme se stigma, heshtja dhe harresa. Dhuna që përshkruanë ato, është më komplekse sesa dhuna e konceptualizuar në drejtësinë tradicionale. Rrëfimet e tyre, sado individuale, shpërfaqin metodat e dhunës institucionale, pjesë e ekonomisë së luftës dhe e sistemeve kriminale të drejtura kryesish ndaj civilëve. Këto rrëfime kontribuojnë për njojen më të mirë të mbijetesës së grave dhe për ndërtimin e kuptimit se sa dhe si lufta dhe dhuna në luftë prek gjininë. Rrëfimet e grave mundësojnë konceptualizimin e përvojës së jetuar dhe transformimet në nivel të jetës së përditshme dhe të subjektivitetit. Të mbijetuarat e dhunës, të cilat shprehin se dhimbja dhe humbja është e madhe, janë të vetëdijshme se të emërosh të keqen është një hap në kërkim të drejtësisë.

Për më shumë, i gjithë ky narracion i të mbijetuarave të dhunës është një kujtesë transformative. Rrëfimet këtu paraqesin të mbijetuarat e dhunës seksuale në luftë jo si subjekte të pathemelta apo si viktima të izoluara. Përmes rrëfimit të së kaluarës, gratë e ridefinojnë veten si subjekte. Ato flasin dhe veprojnë përtë rindërtuarjetën e tyre, të familjeve dhe të komuniteteve të tyre. Përmes rrëfimit, ato lëvizin në mes të traumës dhe integrimit. Narrativet e tyre shpërfaqin se si kujtesa, po ashtu edhe veprimi, nuk janë të pandryshueshme, por dinamike dhe të shumënduarshme.

Rrëfimet e këtyre grave, përmes kujtesës personale, janë shumë të rëndësishme për ndërtimin dhe interpretimin e historisë. Këto rrëfime bëhen edhe burime të rëndësishme të transformimeve të kujtesës së luftës në Kosovë. Të mos harrojmë, kujtesa është fluide. Rrëfimet e grave këtu, si edhe rrëfimet në përgjithësi, qëndrojnë në marrëdhënie me kohën dhe kontekstin shoqëror. 'Rrëfimet ecin në kohë' (Portelli 1991). Rrëfimet dëshmojnë për rëndësinë e zërave të grave në ndërtimin e narrativave dhe të kujtesës së luftës. Në këtë fluiditet shumëdrejtimshëm, gratë flasin jo vetëm për të kaluarën, por edhe për të tashmen dhe për të ardhmen. Duke treguar mbijetesën dhe veprimet e tyre, ato shprehin dëshirën që vuajtjet e tyre të

njihen edhe nga të tjerët. Por, më e rëndësishme këtu është, se gratë, përmes rrëfimit, konstituojnë veten si subjektivitete të fuqishme dhe të dinjitetshme. T'ia rrëfesh përvojat personale një publiku të gjerë, si ky që synohet përmes këtij libri, është një akt veprim i një subjekti të fuqizuar.

Vjollca Krasniqi

Sociologe dhe profesoreshë në Universitetin e Prishtinës
Prishtinë, 2016

RRËFIMET

O1 - TEUTA:

UNË DUA TË DËGJOHEM

Libër kujtimi me rrëfimet e grave të mbiqetuarar
të torturës gjatë luftës së fundit në Kosovë

KTHIMI I GABUAR • NGA ZVICRA

TEUTA kurrë nuk e kishte menduar se një ditë do ta përjetonte atë që po e shihte në televizor në mesin e viteve të 90-ta.

Me gruan e shefit tek i cili punonte, ajo po shihte rrëfime për luftën në Bosnjë që po ndodhët asokohe. Teuta atëherë jetonte në Zvicër.

Pak vite më pas, burri do të vendoste që të kthehet në Kosovë për t'i bashkuar UÇK-së. Teuta e ndjek vullnetin e burrit.

Por, kthimi përshtatzënët do të ishte edhe vendimi më i gabuar i jetës së saj. Ajo do të përjetonte ato që njihen si dy ofensivat e ushtrisë serbe nëpër fshatrat e Kosovës.

Do t'i duhej të jetojë në mal të hapur, të përjetonte krismat, plagosjen nga një granatë, dhunën seksuale dhe sërisht torturën e dëbimit nga shtëpia, derisa gjatë gjithë kohës nuk ka qenë e vetme. Të pesë fëmijët e vegjël e kanë përcjellë këtë nënë në ato që do të mund të vlerësohen si muajt e përballjes me të pa njerëzishmen.

Ajo ka pësuar në këmbë dhe në gjithë nga dy copa të një granate që është hedhur në mes të kolonës së civilëve, të cilët po ecnin nën kërcënimin se kush ndal hapin do të vrtej.

Pak më vonë do të shihte tmerrin nga ata që, ajo i quan ushtarë të Sheshelit, të cilët do ta plaçkitin. Të tjerët që ajo i quan të Arkanit do t'i prisnin kokën një foshnjeje me qëllim që t'i tmerroni gratë që po iknin.

"I dinim të kujt janë sepse thërrisin: rroftë Shesheli ose rroftë Arkani. Këta të Arkanit kanë qenë me maska, ata Sheshelit me mantela të gjatë", tregon Teuta...

Ajo, bashkë me 50 gra është dhunuar seksualisht pak javë para përfundimit të luftës, në një duzinë ku janë mbajtur për disa orë.

“I kishin pasë krejt aletet e'masakrës. Na e kanë marr nji djalë dy vjeç edhe e rroki me thikë njani prej tyne. E kam dorën e lehtë, e kom dorën e lehtë, mos u tutni, bërtitke. Fëmija kajshin e britshin”.

• Rrëfimi në vetën e parë:
• **ISHA E PLAGOSUR, POR NUK MË KURSYEN**
Teuta

Jam një nanë e pesë fëmive, e kam edhe bashkëshortin. Kemi qenë shumë motra evillazni.

Kam kujtime t'mira, kam shumë... Kemi mrri, i kemi shkollu t'gjitha motrat, e kemi kry shkollën. Momentet ma t'mira kanë qenë për Bajram. Kur vike Bajrami i rrrokshim defat, knojshum, dilshim nëpër shpija, u veshshin nuset. Shumë kënaqësi.

E kom pas fejesën, për 6 mujë jom martu. Kena bo darsëm, po me tre mujë

m'ka ra me shku n'Gjermani. Edhe atje kom shku kom jetu me burrin. Atje kom qenë, kom punu bashkë me bashkëshortin. Kena nejt pesë vjet në Zvicërr. Kam qenë shatatzanë kur jam kthy n'Kosovë. Atje kom punu, i kam kqyrë pesë çika t'shefit, burri ka punu.

Jemi kthy me ni pushim, u kon ai vit, jom konë shtatzanë... Po du me lidhë kur kemi qenë '92-tën, '93-tën, atje ka qenë lufta n'Bosnjë, e po du me lidhë qetash te Bosnja. Atje kur ka qenë lufta, kur e kom kqyrë unë me grunë e shefit, e kqyrëm televizorin u çojsha prej veni se krejt trupi mu rrënqethke, kajke gruja e shefit, edhe unë shumë kom kajtë kur e pajsha luftën n'Bosnje çka po ndodhë, çka po bohet. E nuk e kom paramendu me përjetu unë vetë luftën n'Kosovë.

As se kom mendu kurrë po nuk kom mujtë as n'televizor me shiku atje n'Zvicërr t'u kajtë, e t'u u largu me grunë e shefit prej shpisë, t'u dalë me fmi t'u i shëtitë se s'guxojsha me kqyrë televizorin. Edhe jemi çu kemi ardhë n'gusht nji pushim, aty s'na ka tregu kërkush se çka osht' t'u ndodhë n'Kosovë, aty kur ka ardhë koha pe shoh që burri n'mbramje po vanohet. Unë isha shtatzanë, i kisha edhe dy fmi, çikën edhe djalin. U vanoje çka o tu bo... at'here ka qenë edhe gazeta "Rilindja", se gjithë na kena msu edhe kem pas qef shumë me lexu. Kur e kom pa "Rilindjen" vetëm e kish shkru n'fillim t'gazetës që vetëm sa s'ka kërsitë lufta n'Kosovë, u kon n'97-tën. Edhe aty m'ka hi nifarë frike. E pajsha që natën po bojnë lëvizje. Burri ish veshë me uniformën e UÇK-së.

I thash, unë du me i marrë fmitë edhe du me ec, edhe vjehrri m'ka thonë merri fminë edhe shko. Burri ka thonë jo, për atdhe le t'vdesim te tonë!

Unë linda... Kom lindë me ni qiri se s'ka pasë as mjek. Nuk kishe çka me pa prej forcave serbe. Qat'here ndodhi një masakër. Qaty ku ka fillu lufta për mu, ka qenë qai momenti kur kom lindë unë edhe tri javë i kom pasë që kom nejt n'shipi. Tri javë me qat fminë e vogël e me bebën edhe tanë burri nuk kom ditë kah u shku mo se ushtria nuk e ka leju as n'shipi me ardhë.

Mandej kemi lëvizë prej një katuni në katunin tjetër. Tu u enë... Nata ka qenë e jona, dita ka qenë e shkive. Se ata natën, kur bijshin n'punkta t'vetë mo nuk guxojsin me bo lëvizje, vetëm ditën. Dita u konë e tyne... Ka ra shi shumë, ka ra breshën. Bukë nuk kishëm... Traktori mo s'kish naftë, traktori mo met'. Me tesha, me kotesha krejt qaty na kanë metë. Vetëm nisëm me ec. Krejt gra e fëmijë jemi konë. Kemi fillu n'kamë, kemi ardhë, jena mshef n'nji ahër edhe aty kur na kanë pa neve t'ushtrisë në fshat na kanë percjellë gjendjen krejt kah, ku po shkojna na, kah po himë, ku po dalim. E kanë pa që kambësoria po Ishohen nëpër shpija me hi. Edhe kta kanë pritë deri u Ishu terri, po si u Ishu terri n'tokë kanë thonë ata që mo na nëpër terr nuk guxojsin me dalë me i marrë. Na jena mbyllë me ni dhomë, me ni ahër edhe aty kemi dalë jashtë me marr ni kofe me ujë prej bunarit edhe i kena ni kamtë tu ec nëpër rrugë trap tap tap {imiton zhurmën}. Edhe na kemi fillu me kajtë, erdhëm, se ku e kanë nxonë pakicën e kanë bo masakër. Aty ia kem fillu me kajtë e me bërtitë çikat e reja, po për fat kishte qenë ushtria jonë. Kishin ardhë me na nxjerrë. Me na ndihmu. Neve na kanë nxjerrë atë natë, menxi kemi dalë. Kemi bujtë me ni katun tjetër. N'mëngjes, n'mëngjes, na kanë pru ushtartë grurë t'zimë me hangër, fmija s'kishin as çka hajnjë...

Edhe ja kanë nisë fmija me hangër grurë, po nuk e hankshin pa sheqer. Ushtria e kishin zi se s'kanë pas miell, edhe ja kanë fillu po thojnë "ni traktor pe kqyrim

t'mujshim diqysh me marrë edhe me ju qitë." Na ishim kogja kallabllak. Me dy traktora. Edhe jena nisë. N'gjysë t'rrugës na nuk kemi ditë mo kurgjo hiç, na kanë ardhë automatat mi kry tu gjue. Na knej n'traktor, na sen s'kena ditë veç kur e ka rrokë gumën e traktorit, u shpërthy guma, e kena ditë se janë tu gjujtë shkitë. Aty i kanë nalë traktorat, shoferat kanë ikë. I kem shti fminë n'mal edhe jon ikë ushtriajonë qysh jon konë krejt jon largu, jon tërhekë, se shkiet ishin kanë tu ardhë me tenka.

Aty kemi nejtë tri ditë e tri netë n'mal, se mo fmive u dufke me ua mshel gojën se krejt terrenin e kqyrshin me automata e me gulinova. Tani hishin kambësoria, gjithë ata tu gjue, e tu gjue, deri ra terri n'tokë, ata e kanë pastru terrenin. Ia kanë fillu me ardhë tenkat, kur ia kanë fillu tenkat me ardhë, toka u dridhke. Kambësoria u hypë nëpër tenka edhe kanë fillu me shku n'katun. Tani mo me rrokë, me rrokë kah e kishin n'plan ofensivën, edhe na e kalum atë natë, shkumë dy netë, në t'tretë...

I kena marrë fminë aty zhag, jemi shku me ni shpi me ni katun tjetër. Aty ju kena dhonë me hongër, ju kena dhonë me pi qysh e kishin lon gjinja bukën gatshëm. Kish pasë pasul, bukë t'nxeha që jonë ikë kur i kanë ni automatat. Kena hongër bukë, n'mëngjes, n'pesë n'sabah ja kena fillu me ec. Për ofensivën e parë jom tu tregu, edhe aty kanë fillu na kanë qu me ni traktor. Qysh jena hi na kanë qu te familja jem. Po kish pasë refugjatë shumë anej tu nejtë. E jena vendosë, e kanë kry ofenzivën knej, knej nuk kthehen. Po kjo ish konë politikë e tyne, edhe ofenziva e parë mo qajo u konë na kanë kallë shpinë, na kanë shkatërru me çka ka, edhe mo ia ka fillu n'shtator ofenziva të njëjta.

Qat'herë ka fillu lufta e ashpër që ka bo mo, qat'here kur u bo marrëveshja, nënshkrimi për me sulmu NATO. Tash nuk e di, na kemi qenë n'ahër edhe mo s'kemi pasë kohë as fminë me i kapë. Merre me men nuk u dijke as kah po vjen plumbi, nuk dishe as kah po t'vjen.

Atë ditë që fillunë, n'mars, na kanë tubu mo at'herë neve na kanë tubu krejtve, s'na kanë lonë vend kérkun hiç as nëpër male mo s'na kanë lonë vend. Na kanë tubu neve krejt nëpër fshatna edhe jena shku n'shkollë të një katuni. Mo me fmi, me granim, me krejt qaty kena nejtë tri ditë.

Jem dalë nëpër shpija kemi lypë miell. I kena qitë njo tri bukë me i pjekë, po diqysh ma shumë si lloq si thojnë, si t'langt bukën që s'mujshim kérkun me pjekë. Veç me shku me i qitë dikun si petë me i pjekë mi shporet, për me hongër fmija, me ia mushë shpirtin fmisë. Çikën e kisha n'gji. Gji nuk kisha, çika m'kajke... untë. S'kisha e ngrata me fmi tu kajtë, edhe kur erdhën krejt, qata bukë që e kena pjekë edhe ata na kanë marrë, na kanë gju shkelma jashtë shkollës.

Kur ka ardhë tash Shesheli, ka ardhë edhe Arkani. T'parët kanë qenë t'Shesheilit. Na e dijshim cilët janë se ata thojshin, "Rrnoftë Shesheli", e britshin e piskitshin. Ata që thojshin "Rrnoftë Shesheli" kanë qenë me mantilla t'gatë. Ata kanë lypë dukat, unë e kom pas dukatin se burri m'ka thonë "Mos e le duakin n'shpi, le t'qëllon për çdo rast", sikur te dijke.

Kur kanë ardhë t'Arkanit, ata ishin konë krejt t'qart. Ata ishin konë krejt me maska, ishin konë krejt qela, me shamia n'kry.

I kishin pasë krejt aletet e masakrës. Na e kanë marr nji djalë dy vjeç edhe e rroki me thikë njani prej tyne. "E kam dorën e lehtë, e kom dorën e lehtë, mos u tutni" bërtitke. Fëmija kajshin e britshin.

Çikën e kisha t'smutë, t'veglën, gji s'kisha me i dhonë, me hangër s'kisha edhe e

kom ditë që m'ka vdekë çika. At'herë kanë hi n'mesin e grave, n'mesin e çikave edhe tu ju hi shkelma. Do i shtishin nëpër shpija me kqyrë a ka UÇK, i kapshin i ngrehshin zhag. Aty na kanë da 20 veta, krejt zhag na kanë ngrehë shkelma, tu na sjellë brije. Na kanë çu mas shkollës. Edhe aty na kanë deshë, na i kanë marrë teshat, na i kanë tubu me na kallë.

E na murrën i ndajtën çikat, besa ka pasë edhe grue që i ka pasë 65 vjet, ka pasë edhe gra shtatëzana e na kanë çu mas shkolle. Aty kur na kanë çu mas shkolle, na kanë deshë, na kanë mshtetë krejt për zidi cullak, flakën na kanë qitë edhe aty mo vjehrra jem ka folë, e kjo çika ka kajtë shumë e ka bërtitë. E ka shku kah bari e iu ka lutë që Ishona ren!. Po kish do që ishin t'mirë, do kish që ishin t'kajjë. Tani i ka thonë, "Cila osht' reja jote?", ma ka bo vjehrra, "Hajde"... Kanë nga tri shoqe para meje, ato: "Unë jam, unë jam" vjehrra ka thonë "s'janë ato". Thotë, "Po, pse?" thot, "Jo s'janë ato", thotë "ato s'janë". "Une e kom vjehërr", e atyne ju ka ra kondakt n'guj edhe i kanë lonë n'dy gujë tri femna. Unë i kom marrë teshat e ni gruje, veç sa jom mshtjellë me dalë te vjehrra. Tani do gra mi kanë dhonë do tesha, tani krejt ju kem bashkangjité kolonës. Edhe kom mendu që po pshtoj, menjajem pshtova, thojsha.

Ato gratë që kanë mbetë aty mas shkolle kurrë s'jonë gjindë as... s'e dijmë as vorrin ku e kanë, kurrë. Jena bashkangjité kolonës, jena ungjë krejt, kryt n'dhe. Mo s'kena pasë, as me ni diçka, sa mujshin gjujshin. Aty kena nejtë deri vonë, jonë ardhë kolonat, jonë bashkangjité shkitë, kanë fillu me knu. Me mjekrra deri kha, kishin marrë kingja, kishin marrë dele, krejt i kishin mushë ato pragat e tyne e tu knu serbisht e tu fishkllu. Shumë sene që kanë marrë, sene që i kanë vjerrë nëpër tenka, dukatin e krejt t'vjerrun nëpër tenka. Edhe na krytë te poshtë, tenkat kanë pri përpara na kemi qenë mas tenkave...

Mas tyne, edhe nonstop tu na ra me ksi kondakt t'automatave, brive e ksajde s'mujshim mo. Fminë e kisha, çikën e kisha n'dorë. Dy fminë, njonin e merrke kunata, njonin vetë pér dore që mos t'ém largohet prej kolone. Me vjehërr me kunata, me motër t'burrit e krejt, e kemi fillu kolonën. Kur jemi ardhë në një fshat na i kanë marrë krejt pleqt. I kanë vra para syve tonë 13 pleq. Kqyrni thojke, "Cili osht' baba juj?" I kapshin t'ngratit ata pa u bo sen, e ulshin kryt, automat n'kry. Kuku çka kena pa na, aty tani kanë fillu gratë çka i kishin n'kolica nanat e paralizume, i detyrojshin me i shti n'mal, e ata hishin e i vrajshin n'mal. Edhe i lejshin n'mal nanat që kanë qenë t'paralizume ose i çojshin me kolica...

Kemi fillu, kemi ecë, edhe na ka ra granata midis kolone. Aty ka pasë gra pa kry, aty ka pas gra pa kamë, pa dorë. Po unë, kur e kom vrejtë veten që m'ka përfshi edhe mu copa e granatës, çikën ma ka përfshi pak n'ftyre, mu m'ka rrokë n'gji edhe n'kamë.

Veç tu ecë e kom vrejtë çikën thashë, "Nanë, çikën ma paska rrokë copa e granatës" edhe aty kush ishin me gjak, kush ishin veç i skajojshin prej kolone edhe i vrajshin. Ma ka bo vjehrra, "Ec, as mos u kthe me kqyrë çikën diqysh, se marove edhe ti me fmi". Kah me ecë, kah me ecë po m'shkojke gjak kamës. M'shkojke gjak kamës "Oj nanë veç po dridhna, s'po muj mo me ecë, majë çikën". Gratë m'kanë dhonë do pelena me mlu çikën, ma kanë lidhë kamën gratë deri jem shku n'qytet... rrugës vjehrra ma ka bo, "A din... çika ka vdekë!"... "Çka me bo oj nanë, ku me lonë?" i thashë. Vetë isha e plagost, e kisha varrën. Po hala jon konë do që jon konë ushtarë, do policë që jonë konë, ushtri e rregulltë, ka pasë, po ata që ishin me maska, ata has vrajshin. E kom marrë

çikën e kom Ishue te një mulli, atë mulli s'du me pa kurrë. Edhe kur e kom Ishu, ma ka bo ni shka, "Mos e le se e han naj qen". Ushtar me uniformë ka qenë, ushtar ka qenë edhe ma ka bo, "Mos e le", lehke si qen vetë, "merre" ma bojke serbisht "merre". E kena marrë çikën. Edhe kur jena afro ngat qytetit na kanë gjujtë me nifar ledine, edhe aty kanë fillu na kanë nda edhe na kanë shti me ni kooperativë. Aty na kanë shti 130 veta, tash na nuk kena guxu me dal me kqyrë kah po i qojnë tjerat, edhe jemi hi na, jem vendos në kooperativë. Kur jemi hi atje kem nejtë. Edhe aty vjehrra na ka shtru ni palltë e ka pasë, e majke se ftoftë u konë koha. Kanë ardhë gratë, qysh me ia bo, me gërshonë ma kanë hekë ket pjesën e mishit që mos me u infektu. Ma kanë pre gratë, ma kanë lidhë kamën mi kanë qitë mill që me u nalë gjaku, pak u qetsu. E për gjinin, gjinin nuk mujsha me nalë kurrqysh, çikën e kisha n'gji, kur çika lypke me thithë. Ia nisën me m'rrokë temperaturë, ia nisën me m'rrokë ethe...

Ia nisa edhe pak çikës me i dhonë tamël që ma prunën do gra me ia lagë buzët. Çika veç filloj me i çelë sytë, çika gjallë ish konë. Edhe mo çika filloi me u përmirsu, aty kemi nejtë njo tri netë, po jom konë shumë smutë. Veç ni doktor e falenderoj shumë.

Ata mo u vendosën aty para koperativës krejt shkitë, edhe kanë nxanë rini shumë. Aty kcejshin prej toke n'cull t'barkut para neve tu na i rrehë djemtë. Krejt shkojke gjaku te poshtë, u cillke, u roke përzidi. Cili e rroke me kondakt, a e hangshin, e jepshin orën, a dukatin djemtë e ri. Hiç s'vijke n'shprehje, prej toke shkelma që kcejshin e i shtishin n'kamiona. Na aty ia nisum po kajmë, po piskasumi, po bërtasum. Na u afro ni shka, e rrehi ni plak. E rrehi edhe ni çikë. Ajo u kanë e re, veç që i ka pasë floktë e shkurtune mushki edhe tha "UÇK a?" Na e ka rrehë ato nërsy krejtve. Edhe na kanë bërtitë, "Pse po bërtitni?" edhe na kanë shti apet mrena.

Kur na kanë shti neve aty mrena, edhe thashë, zahere pi marrin djemtë e ri, krejt i mushën kamionat. Edhe na thamë, po largohen, po i marrin e po largohen. Kur jena hi mrena edhe hinën dy vetë, ishin pak ma te ulët, thojshin, "Lshoni fëminë edhe perjashta!" Përjashta krejt fëmia jonë dalë edhe s'i lamë me i vra fëminë, na asnjo nuk pranojshum. Hiç s'dojsa me pranu, dy fëminë i kom lidhë qishtu edhe thojsha le t'ëm vrajnë me fëmi se s'largona kurrë. Evladi ish shpirti i shpirtit.

Aty tani ia kena fillu me kajtë, tha, "Burrat ia u kena vra. Ia u kena kallë shpijat. Çka pritni ju ma? Pse s'jeni shku në Shpni? Albania... pse s'shkojshi?" thojke. "O na i ke vra me burrë e me krejt, une mo as fëmitë s'i lshoj. Me fëmitë vramë". E ka hekë automatin, edhe kur e kom pa fëmitë që kanë fillu me dalë, do t'grave që i kanë lëshu fëminë. Unë fëminë s'i kom Ishu, o siç um ka rrokë shuplakë, me veshin vonë kom pasë problem me vesh.

Aty i kanë marrë fëminë, mu m'kanë rrehë edhe kanë fillu me na nda... 130 veta jena kanë, 50 veta na kanë nda në qat ven që kemi qenë. Fminë i murren, i qitën jashtë. Kanë marrë gra, ma s'kena pasë... Na krejt u tranum krejt t'u bërtitë që ma kurrë ai za s'um heket prej veshit (qan). Edhe aty tu bërtitë e tu piskitë ia kanë fillu, na si kena ndigju që janë kanë ushtarë e jonë kanë me asi të masakrës, jonë konë me alete, thika shtrafcigera, s'di qysh me thanë, jonë kanë me maska.

Me mjetet që i kanë pasë, edhe tash kur u hi ai i madhi me maska e di që ni dhamë të dukatit e ka pasë në gojë. Kur ka bërtitë, "Për ni minutë krejt mu

deshë, krejt! Ktu afat s'ka! Veç ni minut keni mu deshë krejt”.

Na jena kanë 50 veta, prej 130-ve që jena kanë, 50 veta na kanë nda qaty, na kanë marrë. O brima që u shkue, piskama që u shkue, as s'dishum cilën me ngushllu, cilën me afru s'guxojshum tu sjellë, tu i rrehë. Tu na deshë me zor, me thikë bre jelektë që mi kanë pre qitu, ma bike thikën (qan). Une jom kanë e plagostë, po nuk më kanë kursy. Jom kanë e plagostë në kamë e në gji. S'u ardhë në shprehi hiç, veç gjaku që m'shkojke për gjini knej. Veç e di kur m'ka ardhë vetëdija, e di, dy vetë i kom pasë përmi. Njani m'ka majtë, tjetri e ka bo punën e vet. Krejt jena kanë të qarta të prishta. Ata mo qysh e bojshin qefin e vetë, qysh dijshin aty mo s'ki pasë shancë, dy orë, tri, as s'i kanë çelë as dyrtë. Edhe jashtë kanë qenë me fëmi, e me gra, e me krejt. E kanë ni brimën, e kanë ni piskamën. Krejt aty jena kone, gjynah, a din, sebep mas sebepi jemi njoh krejt. Ma as s'kom ditë as ku jom. S'kom pasë as vetëdije, vetëm vjehrrën e maj n'men pak që ma ka gju ni qebe kur o' hi. Tani i kanë marrë me veti, s'e di sa i kanë marrë me veti, veç pak, 30 veta jena met!. 20 veta prej atyhit i kanë hekë. E ma, u ardhë vjehrra me na mbulu, e kan hi krejt. Çika e madhe e mban men thotë, “O mam qysh britshit e piskitshit, s'du mo me pa, as televizorin”. Pesë vjeç u kanë.

Edhe aty kanë fillue gratë me ujë te nxeh të me na la. At'here as ujë s'kishum, s'kishe ku me marrë as ujë. Kemi nejtë aty edhe ni javë ditë, rrafsh ni javë ditë, po ata qasjade jonë konë. Edhe tjerët që jonë shku, po qaty kemi nejtë, nonstop n'kontroll të tyne jena konë.

Kanë ardhë prapë t'nesrit. T'nesrit kanë ardhë tjetra parti. Unë kom hypë në tavan me ni çikë, kom pshtu n'tavan, edhe mo s'jom dalë poshtë hiç. Deri kur u kry.

Kanë ardhë gratë, kanë ardhë kush ka pasë mundësi, kush ka pshtu do sene, kush ka pas sene nepër shpija, na kan mlu. Kush ka pas do tesha, u munojshin me na bo nifar ushqimi me hangër, po hiç s'ka pas shancë, tani na kanë pru mjekët menxi, varrat me i ly pak.

Po aty në atë koperativën kena nejtë edhe ni javë edhe masi ka përfundu edhe ma s'kena pasë ku me shku na, nuk e dishum a na kanë pshtu djemtë, a u vra kush! Kemi dalë në ledinë, kajshin gratë, tana sot me i pa trupi me rrëqethet, edhe kemi dalë në ledinë jemi ungjë, kemi kajtë gjitha gratë që na kanë ndodhë. Po sa kena nejtë në atë javë, gjashtë fëmi i kemi varrosë, se s'kanë pasë çka me hangër, s'ka pasë çka me pi. Vorrin e marojshim mi at koperativën veç sa mi shti në dhe, se s'ke pasë ku mi shti. Tani dilshum i kajshum vorret edhe kur pi shoh vllaun e burrin që po vijnë. Khu Zot, qysh mi dalë përpara, kta kishin ni çka ka ndodhë krejt po s'ja dhojshin vetit që pe dinë! Erdh vllaun, erdhët tani kta djemtë e mixhallarve që jon kanë të vesht me tesha të ushtrisë, tani burri. Tani tha nana, “Hiç mos bo zo, le te dinë tonë qe je e rehëtë”, se edhe kto kanë me thanë “që jemi të rehëta”. Edhe qashtu vendosum, që jena të rehëta, po thashë si sot si nesër me ni, ma mire le te din çka osht’, le të osht’ me kohë, le t'vendosë sa t'jom qitu. Aty kom qenë kur nuk e kom njoftë kush osht’ a o' burri jem a s'osht... Edhe tash burri kur afrohet ngat kqyr, çka me pa, nuk isha veç une po ishum shumë gra tjera. Krejt secilën te kqyrësh, shumë pleh, si të smuta, të qarta, edhe u afru ngat, dola i kapa përqafe vllaun e burrin e krejt ata çka kanë pshtu prej lufte. Tha burri: “A pshtutë?” thashë, “Pshtumë”. M'ka kapë edhe njëherë përqafe edhe m'tha, “Ku jonë fmija?”. Të tubumë krejt qaty ia nisën do

fjalë, e kom marrë burrin e kom largu, edhe i kom thanë qishtu-qishtu na këndodhë, "Ndaç prano, ndaç mos prano", thashë "qishtu, jo veç mu po krejtë qishtu na kanë nda". Tha që e din, "edhe ti ke me kanë gruaja jem qysh je kanë gjithë, gjithë ki me kanë". Edhe gjithë burri m'ka përkrahë. Tani kanë ardhë KFOR-i, si i kom pa, m'ka hupë vedija... Thojsha "Prapë ja nisi lufta", ka pas problem burri, vjehrra se ma nuk mujsha me deshtë kërkimin. Nuk mujsha ma hiç, hiç mu adaptu se jetë jem u shkatru, se jetë jeme s'osht' si perpara qysh ka qenë si para lufte, si mas lufte. Gjithqysh, ka pasë kohë që bijsha me flejtë, nuk mujsha me flejtë, u çojsha n'kamë, hinën, erdhën, shkunë, u çojsha, britsha piskitsha në gjumë.

Ama kta krejt e dijnë që jom kanë shumë e rrehtë. Edhe baba ka qenë në dijeni, shumë ma, aty u munojshum nifar jete po nuk kishum vullnet. I kisha fmitë, vjehrri ma ka hekë kanopin prej fytë, jom shku vetën me furë në garazhdë, vjehrri ma ka hekë kanopin "Çka je tu bo bre bijë?! Çka ki bre bijë?!", psiqikisht unë kom pas lu pejmenve...

Mas lufte shumë kom hekë, tri vjet jom kanë psiqikisht e lujtne. Kurrë s'kom guxu me nejtë pa kokrra,ksi qetsuse...

Prej 2008-ës ju falënderona kësaj shoqate ku po flasim. Zaher jam kanë e mbylltë, tash ma mirë. Unë e kom rrëfy luftën për herë të parë në kët vit. Ka pas aty... s'jonë kanë veç dy-tre vetë, po kemi qenë shumë që ia kom rrëfy luftën se s'ka mujtë me m'nalë kërkush, me më nalë tu folë. Çka kom folë, po unë kom folë, kam fol për përfjetimet e luftës. Se kom dit se edhe më vonë do të flas... tash e po vij, po dal pak. Kur kom shku për herë të parë, aty kom edhe burri m'ka thonë, "Shko" se burrin e kom pasë n'punë. "Shko, osht' diçka, pse mos me shku? Jonë shku gratë". Po shumë kemi qenë, dy kombë kemi shku, gra, burra, krejtjemi shku me shprehë luftën çka kena përfjetue.

I kom vrejtë ndryshimet masi kam folë. Se pak m'u dukshin njerëzit ma t'gjallë, ma m'pritshin ma mirë. M'u duke kanihere vetja që sen nuk po një çka m'ka ndodhë. Qe dy vjet e knej, mirë jam me burrin, qe dy vjet. Pe një që jam me burrin pak e afrume se nuk kom deshtë... Ai e ka kuptu gjithë. Osht' ni person shumë i kuptushëm, osht' ni person shumë i qetë. Edhe vetë jom shumë nervoz, e bash kur jom nervoz ai m'qetëson, ai m'flet mirë, "Hajde dalum pak, hajde shëtitum pak. Hajde... s'ki... thotë çka ki mu bo nervoz nusja jem? Pse po bahesh kaq nervoz? Ka kalu lufta mo, ajo o shku, ajo duhet me u harru. Tash e kem t'ardhmen, fminë, familjen". Shumë osht' i qetë, e falemnderoj me zemër se e kam ni ksi burrë...

Sot ma e mira që pres me ndodhë, veç fëmia që t'ëm shkollohen. Prej fëmive e pres t'ardhmen, që t'i shoh t'u u shkollu, t'i shoh t'u u punësu që mos t'përsëritet kjo, dhashtë Zoti mos t'përsëritet kurrë, oh Allah që po t'lutna.

Po arrihen, qato që i kom mendue, që qato hjekë që kom hjekë, pe shoh që pas kom pasë për kon me nga, kom pasë për kon.

Porosia ime osht', ma s'shumti, t'falemnderoj që na keni dhonë këtë mundësi që t'flasum, që po e pres me gjithë zemër ni libër që ta lexoj, e jetën qysh e kena përfjetu para lufte, e qysh kom përfjetu mas lufte. Qajo osht' dëshira ime, që t'e shoh librin n'dorë t'e lexoj. Që ta shohin t'gjithë n'Kosovë, që ta lexojnë se çka kena përfjetu nanat. Çka kena përfjetu përfëmi, çka kena përfjetu për këtë vend. Qajo osht' porosia ime e fundit.

02 - E.T. :

UNË DUA TË DËGJOHEM
Libër kujtimi me rrëfimet e grave të mbijetuara
të torturës gjatë luftës së fundit në Kosovë

• DY HERË MË KA NDODH

Ajo e ka përjetuar dy herë dhunën seksuale brenda disa javësh. Ende lufton me pranimin nga familjarët. Djali i vogël, ish-ushtar i UÇK-së e ka vëzhguar nga larg se si gratë janë futur në shtëpinë ku është bërë dhunimi. E ka parë edhe nënën e tij. Nuk e mbështet. Përkundrazi e gjykon ende për këtë tragedji. E torturon me pyetjen pse hyre në atë shpi?!

“Ata menojsin që shkollën ka me bombardu NATO. Hishin shpejt. U ngutshin. Thojshin, “Shpejt e shpejt me e kry këtë punë e me dalë se do me bombardu.” E krynë punë, tani deri nesër n'mengjes.”

Rrëfimi në vetën e parë:
• **ATA LAHPERA S'MUJSHE ME I DALLU**
E.T

Prej nanës jem kanë, vetë e treta jom kanë. Unë jom kanë e madhja edhe dy vllazën. Vllaznit kanë vdekë, unë kom mbet. Jam rritë si vajzë e vetme deri n'gjashtë vjeç. Në moshën gjashtë vjeçare baba u nda me nanën... edhe u martu.

U ndanë për shkak t'fëmive. S'ju rritshin fëmija nanës. Për tjetër sen jo. E u martu baba e e murrë nji gru. Ajo tani e gjet djalin për ni mujë. Apet mas nji viti, apet tjetër. Kemi jetu bashkë me njerkën, por unë e kisha, qysh me thanë, nji ndjenjë që s'e kisha nanë. Kurre s'e kom pa ma nanën. Ajo u martu edhe ma s'e kom pa. S'kena pasë kontakt dej sa jom martu une, hiç.

E kam kry klasën e parë veç. Nja gjashtë muaj. Ma ndërpreni baba me ia kqyrë fëminë me ia rritë. Kush m'u kujdesë për fëmi t'saj? Për çdo vjet e gjajke ka nji djalë. E tash u dashke mandej m'u kujdesë për fëmitë e saj.

Me dalë pak me shoqe n'oborr, njerka i thojke babës, “Çika jote s'ëm ka ngu” pritsa që n'mramje m'rrehkë baba, “Pse mi ke lanë fëmitë vetun?”. U rrita kishe pak, 12 vjeçare m'fejoi. Vetë baba, vet m'ka feju qaty. Se une s'kom ditë kurrgjo, sikur tash që vetë vajza del e sheh, e flet e... Jo, jo, n'atë kohë unë s'e

kom pa hiç. Baba bashkë ish kanë ushtar me ta. Gjeneratë e babës tem. Qashtu, burri jem gjeneratë me babën tem. Njëzet vjet martesë i kish pasë me gru t'parë. Grun gjallë e ka pasë po s'ju rritshin fëmija as asajna, e për shkak t'fmijëve tani ka thanë hajde nji çikë t're... Unë fëmi. Po ai ish i knaqun me fëmi. Tha ai "Prej fëmije del diçka se prej plake s'del kurrgjo". As s'e kom ditë çka o fejesa e çka o martesa. Dej ma erdh koha, kishe erdh ai mu me m'lypë me thanë "Dojna me nda vade, dojna me e marrë robin se osh' ka hjek robi këtu te ti. Ti shumë fëmi, kjo s'po bohet rahat...". Burri edhe ortakja. Edhe janë ardhë, e kanë nda vaden. Dy javë m'kanë... qashtu m'kan lanë qysh thonë "Nër unazë" edhe teshat m'i prunë. Dy sanaka, qashtu do far sanakash t'drunit. Kur u bonë dy javë me ardhë tani me m'marrë. Aty tani t'u knu çikat. Kur erdhën ato që i thojshin "jangjia" ato, tu i shajtë..."Bismilah e kamën n'qilim kur u çojshë gjytyrym", e diqysh do fjalë ju Isojshin këtu. Për shembull, këto kushërinat e mia, me def e qysh o kanë adeti at'here me i shajtë ato... Unë s'disha kurrgjo. M'i gjetën do kanë. M'i bojshin do shoqe do adete qashtu. Po s'nisha kënaqësi kurgjo... Kur erdha kha, me defa e dajre na dulën përpara. Tu knu... Kish pasë krushqi, kish pasë. Po at'herë Ramazan ish ajo kohë. Do me Ramazan ishin, do qashtu. Me hoxhë ktyneherë. Tani ish aty zakoni me t'kapë kunati qashtu e me t'shti n'sobë. Kap, qeshtu m'kapi edhe m'shtini n'sobë... N'grykë, se fëmi i vogël. M'kapi. Unë isha e re. Gati 40 vjeçar u kanë ai, a ma shumë a. Unë 12 vjeçare e ai 40, burri, a 42. Njizet vite martesë me gru t'parë. E tani ai kur erdh n'sobë qashtu, po unë isha shumë e re. Ja nisi, po ma hjek duvakin e dorëzat. E qashtu tu u mërzitë e tu kajtë. Ai m'thojke, "Çka po kanë se ki me bo sefa, e ki mu knaqë", po ashtu diqysh, "Kom me t'çu te nana. Ki me e pa nanën. Mos u mërzit ti hiç. Ka me ardhë nana te ti". E qeshtu kësi far fjalësh. Tani mandej, "Hajde po binal!", "Hajde dathëm...". Shtrat i drunit. Qashtu si i ktynehershrit. "Hajde dathmi çorapat. Lami kamtë!" uh, ma boni burri. Diqysh une s'isha msu kurrë. Menxi ia lava kamtë aty me njifar legeni, njifar tazi qashtu. E tash, "Hajde bonëm gati! Deshëm me ra". Une s'mujsha, m'vike keq mu deshë. "Hajde hajde se tash ti je e jemja, une jam i yti. Ma s'kem na ndamë na dy kurgjo" (psherëtinë). M'kujoitet ajo natë si sot. U desha, rashë. Ia nisi me m'dashtë, me m'përkdhelë, e qashtu diqysh. Po unë shumë, shumë diqysh dojsha m'u tranu. Veç kajsha unë me za, jo kështu. Kajsha me za sa t'mujsha. E aty m'tha, "Mos kaj!" "Qysh mos me kajtë? Ku jom ardhë unë këtu?" "Ani ki me bo sefa, ki m'u knaqë". Thashë, "Jo s'kom m'u knaqë kurrë!" Tani kur ja ka nisë marrëdhania qashtu diqysh, me fëmi me pasë marrëdhania që ja nisi. Ma prishi virgjinitetin. M'erdhën masanej menstrucionet. Unë tani kur e pashë gjakun unë edhe ma zi u tranova. "Ah mirë se shumë mirë. Shumë mirë". Thashë, "Po çfarë miri kqyre m'prishe krejt. Nji fëmi me e prishë ti". Ai "Jo, jo, jo, shumë mirë osht kjo punë". Edhe ma tani qashtu. Tri vjet ma s'kom pa kurgjo hiç menstracione. Kur i kom bo 15 vjet, masi që i bona, m'erdhën. E thojshin, "Met nusja me bark, met, met, met, met!" Thojsha, "Çka? Barkun e kam. Qysh bark?" Unë isha fëmi për veti, nuk e dijsha çka o barki. "Qysh more, unë barkun e kam!" E qashtu diqysh. Njifar, s'di qysh me t'thanë. Jo burri shumë m'ka dashtë, ortakja, s'ja hupi. Ata për mu janë kanë shumë t'mirë. Mandej mbeta shtatzanë. Isha e lumtun, por u tutsha, thojsha mos pe abortoj apo diçka. Shumë diqysh, kisha strese kisha. Tash dy djem i kam.

Burri m'ka thanë, "Ja, po m'vjen shumë keq prej teje. N'vend me t'marrë për

djalë t'kom marr për veti. Sikur me evlad tem po m'duket po çka me bo". Thash, "Jo masi m'ka dhanë baba, çka me bo! O duftë qashtu m'u pajtu me ty". Me ortakën shumë mirë kom kalu. Ajo ka gatu për mu, e ka hjekë plehin për mu, ajo o kujdesë për mu sikur me e pasë unë nanë ata e jo ortake. Shumë, shumë, shumë u kujdesë ajo për mu. Edhe kom pasë raporte t'mira me ta shumë.

Tai vdiç burri. Edhe që o kanë i vjetër shumë jom kanë e knaqme. Ku i kom thanë... m'ka çu n'Brezovicë. Kena nejt, jena knaqë. Ortakja fëminë m'i ka qçyr n'shipi, unë me burrë kom shku atje. Jom kënaq. Kom shku n'Matarushka banjë, ky me shokë t'vet, ata me gra, ky me gru, shkojshim u knaqshim. Edhe dy vite ngjitë kemi shku n'Matarushka banjë. Masanej që m'u ka nda nana, m'ka ardhë nana, ma s'pari.

Ka ndëgju nana që jam martu. Se tezën e kom pasë t'martume për mixhë tem, tezën teme. E tani i shkojshin lajmet nanës, si për t'mirë si për t'keq. I ka tregu ajo masanej, mas pesë–gjashtë mujve m'ka ardhë nana. Që i kom bo pesë–gjashtë muaj martesë m'ka ardhë nana.

Kurrë se kam taku. Ajo ka shku te ata t'burrit, unë isha te t'mitë, ajo s'ëm ka gjetë e u kthy. Madnej burri me qoj te nana aty ku ish martu. E ja nisa me shku te nana. U knaqsha, kah nji javë shkojsha me nejt. Ajo nuk kish pas fëmi atje. I kish pas thanë atij burrit e kom lanë një çikë e s'du me ba ma fëmi. Fëmitë e atij burrit e kanë dashtë nanën. Edhe mu më pritshin si motër.

Fëmijtë e mi m'kanë dashtë, m'kanë përkrah fëmija. Shumë m'kanë dashtë. Po ma shumë ma kanë dashtë ortaken. Shumë. Se ajo tash i kish t'vet jashtë, kish pare e fëmija si klyshi e qashtu diqysh u... mas sajna. Ja dhajke, at'herë me dinar, ja dhajke pesë dinarë e dhetë dinarë a 20 dinarë a...

Djali e ka gjetë vetë nusen, i madhi. E ka gjetë vet. Qeshtu o kanë n'shkollë e nji shok i ka thanë, "Qeshtu e kam nji kojshike, hajde kqyre". E morëm. Kishim lek e kishim pasuni. Erregullumë nusen, me dalë... Dasëm e madhe.

E kom marr nanën teme me jetu me mu se s'ka pasë djali, burri i ka vdekë. E kështu që s'kish ku me nejt. Shpijken n'Vushtrrja prishën shkijet, e djali i tezës e merr e e çon te dajtë nanën teme. Po m'thot djali i madh "Shko nanë se gjyshja te dajtë e tu!". Shkumë e murrëm e e prunëm n'shipi. Tash une me nanën jetojmë me nji shpi qaty. Nuset jetojnë me nji shpi vetun, une jetoj me nanën teme n'tjetren shpi. Para luftës mu m'kujtohet se erdhën shkijet me e hallakatë burrin, me ja marrë armët. Na bastisën. Dy i kishmi me leje. Edhe i lypshin do armë. Burri s'ja dha. Me leje janë, pse me jau dhanë! Nuk ja dha.

Burri vdiç para lufte. Prej tenisoni, n'demonstrata e patën rrehë shkijet. Qat'here, tani u smu e villke gjak prej tyne. E masanej vdiç.

Djali i vogël shkoi ushtar. Ushtar i UÇK-së. Ushtar u kanë. Kur ka fillu lufta, tri ditë me nji ven s'na kanë lanë. Hajde qeknej, hajde qanej, hajde qeknej...

Jam kanë me nuse, me gra t'kojshive, me t'kunetve. Na ishim aty plot. Edhe, na ishim n'traktor me t'kunetve... tani na marrin traktorin n'kamë na, hajt ec. Edhe nusja e kish nji kufer, thash hajt t'ja marr qat kufer. O sa t'na qitshin deri qaty, ja shtishin flakën. I kallshin. Na grahi qashtu, ushtarë knej, ushtarë knej. Tenkat përmas na vishin. Na n'mes.

Na çunë me nji shkollë. Kur na çunë aty nji natë, pleq e plaka e fëmi i kapshin i gjyjshin n'oborr, neve na shtishin mrena, thika qekaq. Pleq e plaka jashtë. Edhe fëmitë. Çka ka mujt me ndodh? Ka mujt me ndodh qajo që osht ma e keqja. Dhunë seksuale. Qashtu ka qenë, qajo ma e keqja që o kanë.

N'10 ora kanë ardhë. Na vetë ishim mrena. Nuk kishim... a kah ora 10 janë hi. As s'kish drita, as kurrgjo. Terr, burg, s'shifshim kurrgjo. Edhe qashtu. Kah nji orë a dy ka zgjatë, janë dalë. Masi na ndajtën, e dishim se diçka ka me na ndodh. Na ndajtën, pleq, plaka e fëmijë i lanë jashtë. Kush ish ma e re... i shtyshin nuset e reja, e qashtu çika t'reja krejt.

Si n'mes. Si n'mes isha. Përafërsisht një ka qenë përmu. A nji orë, nji orë e gjysë, ma shumë s'ka zgjatë.

Ata menojsin që shkollën ka me bombardu NATO. Hishin shpejt. U ngutshin. Thojshin, "Shpejt e shpejt me e kry këtë punë e me dalë se do me bombardu." E kryne punë, tani deri nesër n'mengjes. Ma përplasën valla kryet. Hala m'dhem qysh na përplasën përmbanjë, qysh na krisi kryet. Na qaty i shihshim krejt. Bërtit, tranohu. Tash për shembull ata krejt njejtë ata laperash s'mujshe me i dallu. Njëjtë. Ju erdh lajmi qashtu, NATO-ja po don me e bombardu shkollën. Edhe ata kryen punë me ikë ma shpejt e me dalë. Përm neve s'ishin ngushtë, na lanë qaty. Edhe deri t'nestrir kena nejt qaty. Kah nantë a dhetë ora na kanë lishu prej atyhit.

Tanë natën tu e kajtë njana tjetrën, "Qysh na ndodhi!", "Çka u bo me nevel!", e qeshtu qiso fjalësh. Kish fjalë boll aty. Ajo ortakja o kanë jashtë te dera. Tha, "Krejt ju kom ni çka keni bo, çfarë piskame keni bo". Edhe ajo e ka ditë krejt çka u bo me neve. Tha, "Krejt ju kena ni, krejt, çfarë piskamash keni bo ju. Kha, unë kajsha, kha mozomakeq." E qeshtu.

E nisha vetën mozomakeq. Tani t'nestrir na Ishunë... Tani as kamtë s'ja kena pa. Na Ishunë kolonë. Nja dy net kena shku kena nejt n'njifar veni, njifar katuni. "Hajde shkojna te shpikal!" Kur shkumë atje te shpia, po gjunjë me pluma ata, se na shifshin. Ata n'kodër na shifshin. E tani hymë n'shpit t'kunatit atje. Kur jena hi n'shpit t'kunatit aty u tubumë. S'kish gja knej, shkretina. Krejt shpiat e kallta të krejtve. Veç mozomakeq. Mas nji kohe po vijnë po thojnë, "A o kush mrena? Le t'del se ma këtu se lajna kurrran. Krejt t'kallun janë" Edhe une me fol s'kom guxu kurrrë. S'kom fol me ta hiç, hiç, hiç. Hiç s'kom fol se thojsha se si t'hish n'fjalë me ta del fjalë. E me fol s'folsha. Shkova. Ata u tubunë aty edhe nji kolonë shumë e vogël u tubumë. Bukët i kisha n'furrë hanez, shkova i hjeka bukët. Aty i shtina bukët me nji thes edhe i qita n'shpinë. E do gra po m'thojnë, "Qyaja, çka po t'vynë ato bukë. Gjuj se kanë me na vra." Thash, "Të m'vrafshin, me bukë le të m'vrajnë". Edhe po nisëm qashtu. Po thojnë, "Hajde, jeni tubu krejt?" edhe po nisëm. Kish burra, kish miq, kish t'katunit.

Me nji vend po i nalin burrat. Po i nalin e ja u qitën duart qeshtu përmas. Edhe i vraqjtëna mashkujt. Qashtu, kah shkojshin kallshin shpija me armë. Si i gjujshin, i kallshin shpijat. Kta knej, kta anej... Na u çuditshim, me armë që kallet shipja. Unë s'di çka ishin ato. Armë me zjerrm. Si gjujshin, u kallshin shpijat. Çeremidet na rrokshin mi krye. Qashtu. Edhe hajde tash me ec. Burrat i vraqjtëna. Ja fillunë fëmija që i shifshin baballarët tu kajtë. Fëmija kajshin, thosha, "Jo, jo, si kanë vra" e na ishim ma përmas, e dikush ma përpara veç dikush se shihke. Ata që i vraqjtëna burrat ma nuk i pamë, veç na çunë dej me nji fshat. Ma nuk i pamë. Ikën, u kthynë, u zhdukën ata. Veç na çunë aty. Kur t'na çunë aty te ai fshat, tash dulën policët me uniforma, "Hajde se këtu doktorri ka me ju kontrollu". Po çfarë, s'kish kontrollë e s'kish kurrgjo. Veç me na shti n'shpit me na lanë qaty.

Neve na lanë n'oborr deri n'mbramje aty. Nuk na Ishojshin me ec kurrikah kolonën. Deri n'mramje ishim qaty. N'mramje na kanë shti, "Ti kha! Ti, kha! Ti,

kha!". Ishtishin nuset e reja, çikat e reja mrena. Edhe qashtu...

Ish aty, kish dhoma, tri katër dhoma ishin. Shpi dykatëshe. Edhe qashtu na shtishin krejtve. "Til! Til! Til!" krejt me qashtu. Maskë n'ftyrrë, policë. E sa ish me maskë se njifsha. Ama kur hini aty tjetërkush, ai polici me na njoft neve na ka njoftë shumë mirë. U kanë i katunit tonë. I komunës tonë ish ai edhe na ka njoftë neve. Edhe na shtini qaty. Kur na shtini qaty ja boni tjetrit, "Kape!", ai kap e ja hjek. "Ha, a po tutësh prej grave a?", tha, "Poçka kanë me bo?". Tha "A po tutësh prej tyne a?" M'fal n'shprehje, tha, "Këto gra shqiptare ishin t'mira me ta hangë." Edhe ma thashë, "Ti koke a? Ati te qaj që je ardhë nëpër katune e na ki marrë armët? Ti koke që erdhët këtu e na prutë a?" Tha, "Veç për inati t'burrit tand kom ardhë qetu." Edhe e di që qaj i pari o kanë. E mi shkynë teshat, përgjatë m'prejtën. Tu bërtitë e tu piskatë une isha. Bërtit, piskat... edhe tani tjerët. Erdhën tjerët, paramilitarë e qesi. Me flokët e gata, t'palajt, veshën e zi, se n'shpirt ish me rrajë. Shpirti me rraj ish... Çka kena hjek na, kuku. Tri ditë me nji vend s'na lajshin, na qanej, na qanej, na qanej. Veç ajo që ke dhunë seksuale ish kanë ma vdekje. Ma mirë se t'ish bo masakër, a t'na kishin pre krytë, a nji kamë, a nji dorë a, t'ishim met kretj invalida se çekjo që na ka ndodh neve. Shumë, shumë keq. Shumë. Njeri me burrë t'vet edhe diqysh...

Diku ma qashtu bërtit, piskat, bërtit, piskat edhe do shprica t'bardhë, kështu që, shprica a qysh i thojnë. Edhe ata ishin kanë me qasi na dhanë me na qetësu. Diçka bardhë kish pasë n'ta. Na jepshin qashtu me i pi edhe ma deri n'sabah na s'kena ditë kurrgjo. Ma hiç. N'sabah kur jom çu, gjaku, gjaku m'shkojke vi. Krejt me e pa barkin k'sajde, a ma kishin shpërthy me thikë a, krejt, krejt, krejt rend. Çka m'kanë bo s`di.

E zhveshme krejt, po. Ama gjaku qashtu s'mu nalke hiç, qashtu me gjak. Ish nji shoqe, mi dha do kule. E qashtu tu ecë e tu ecë, kur u nalshim t'nesrit, qì t'shkunë, kur u nalshin përrpara me e kqyr kolonën. Dikush famljën e vet e dikush... Dy herë m'ka ndodh, po, dy herë ka ndodh. Tash s'di ma', veq shpirti jem. Veç shpirti me rraj s'po dilke kollaj.

Kur u krylulta krejt e kuptumë se erdhën këta t'NATO-s.

Erdhën e na menojsnim që shkie. Erdhën edhe ata me tenka, erdhën me kamiona me flamura. Edhe tani ma u shlirumë. Ju kish ardhë lajmi burrav, "U shliru! U shliru! U shliru". Kta shkijet ikshin sa mujshin. Tu knu, tu ikë. Shkojshin qenat. Çoçjshin gishta, shajshin, bërtitshin. Qashtu kjo jetë.

Ish gëzim, gëzim e idhnik për mu ish boll. Për shembull, djali i vogël na kish pa që na kanë shti n'atë shpi e po thotë, "Pse pranojshe me hi qaty? Pse hishit?". Djali ushtar. Ushtarë me ushtarë na kanë pa. Na kanë përcjell nëpër male. Edhe, "Për çka ti ki pranu me hi n'atë shpi?" "O djalë, unë menjen e kisha që ko me u vra ose mu bo masakër krejt. Ose me ma hjek kamë a dorë a me m'lanë t'paaftë. Po ata s'ëm lanë t'paaftë por kishin qef me i kry dëshirat e veta, me na i bo qëto t'pahijeshme. Po na dhununë. Na keqtrajtunë."

Une shumë, shumë jom kanë me ta keq. Me qetë ushtarin. Shumë jom kanë keq. S'ëm ka përkrah hiç. Ama ky i madhi, masi e kish gruan edhe vet, ai ndryshe. Nusja qashtu u kanë. Ai s'kish ma çka me bo, çka me thanë. Edhe qeshtu.

U kanë me ushtarë. Gja s'ka guxu me bo. Janë met qaty n'mal tu kqyr. Se thojshin, "Na mujshim me i vra!" "Po, po, mujshit me i vra! Po s'keni mujt valla se këta armatim t'madh e ju me çka? Me nji armë n'dorë." Veç çka janë shku e jon

strehu nëpër male, kanë qyrr. Qeshtu.

Masi hyni NATO tani vazhdumë rrugën me shku n'shpi, qaty n'oborr me nejt. S'kishim çka me bo. Fshi varaki, na kish hi varaki përmi. Qaty rrishëm, skame, ishim diqysh...

Nji organizatë erdh e na pruni nji shator. I vogël ish boll po qaty. Fëmija bile thojshin le t'hynë mu strehu. Çka me bo. Se keq boll, kena hjek boll.

N'spital isha me nji shoqe gjakovare. Ajo e kish pasë çikën deputete. Edhe po m'thot ajo, pe viziton nanën e vet edhe thotë, "Qe bre loke, qekjo shoqe ish e Drenicës". Po i thotë çikës t'vet. Edhe po thotë, "Qysh keni kalu?" e po më vet krejt ajo.

Mu po m'shkojnë lot përfyre. Tha, "Le allahile, veç me kajt mos kaj!" Tha, "Po i di krejt. Aje lajmëru ku a naisen?" Thashë, "Për çka?" Qeshtu - qeshtu tha, "Qe e ki punën tha, kallxom ti mu shlirë e kom me shku." Thashë, "Vallahi po t'kallxoj si motrës teme, qeshtu na ka ndodh. Po m'u lajmëru kurru s'kom guxu, m'u lajmru. Ajo ma dha adresën përt te organizata. Mos t'ish kanë qekjo organizatë, m'duket s'isha sot. Une kom tentu m'u vjerrë. Kom tentu 100 forma me e mytë vetën. M'ka gjetë kunati tu u vjerrë. Po s'kom dashtë me jetu. Nji shoqe e jemja o mytë n'bunar. Qashtu me nji vend jena kanë. Ajo o mytë n'bunar. Qaq keq e shihshim vetën që ma u munojshim me e zhdukë vetën. Ma thojshim mos t'jetojna ma as nji minut. Po m'nxuni kunati. M'nxuni, me litar në dorë isha, me nji karrikë t'keqe. Thashë te qes me nji lis edhe e shtyj karrikën me kamë edhe kurtalisna. Po isha kanë me ymër edhe pshtova prap. Se unë isha ma e kënaqt' e mytnë sesa qeshtu që jom met gjallë e përgazep tash.

Mas lufte ma shumë t'këqija se t'mira. Se qeshtu, djali i vogël s'ëm përkrahke. Edhe sot kam problem me ta. O martu, ka familiqe edhe qashtu.

Ky djali tjetër e din edhe ai, e kupton edhe ai. Kurkush me dëshirë s'ka pas qef. E vetmja unë s'isha, po aty ishim... kish gra, kish shumë edhe vajza. Po aty. Ti prejshin gishtat. Nji vazje ja prejtën gishtat, 14 vjeçare ose 15, si kish ma shumë, ja prejtën gishtat. Ajo tu munu me e mbrojt vetën ja ka kap thikën, e ata tu e ngreh thikën, se nashta s'ja kishin pre, po tu ja ngreh thikën. Ajo çikë pa gishta, katër gishta. E ma se kom pa. Nuk e di a o shku a çka u bo me ta. Ma s'kom ditë kurrgjo.

Me ortakën kom pas mundësi me fol se ajo e ka ditë. E ka ditë ajo se na kanë shti mrena, na kanë mshel derën edhe na t'u bërtitë e t'u piskatë. Edhe nji motër e burrit edhe ajo m'ka ni. Tha "Bërtima që ju ka shku ju...", bile qetash nji ditë, "Britma që ju ka shku juve." Thashë, "Po na prejshin me thikë dojshin me na bo masakër." Po tybe e dike ajo shumë mirë. E ka ditë shumë mirë po s'kish... Erdh nejti e tha, "qeshtu ma boni". A thashë, "Jo kurrgjo veç..." S'kom pasë nevojë une me tregu përkurran. Gjithkush i ka ditë ato punët e veta, senet e veta. Gjithkush ka pasë atë stresin e vet, ato ndjenjat e veta. Kështu që... Krejt mu duke po vijnë mbrapa. Krejt dilishin para ftyre. Krejt mu paraftyrojshin. Krejt sikur n'kino qysh shkon m'dilishin si fotografi. Krejt. Unë gjumë n'sy s'shtisha. E n'organizatë që shkojsha, m'dhajshin hapa, m'dhajshin qetësim.

Me nanën si me nanë. Tanë natën rrisha çutë, lypke, "Çka ki që s'po flen? Çka ki loke kështu?" Tash çka me bo. U dufke nanës me i kallxu çka ka ndodh. Kur i kom kallxu ajo osht ra për toke, nana. I tregova. I ka ra t'fikët. "A loke, qysh s'ëm ki kallxu deri sot?" Thash, "A po t'kallxoj mirë a?" Ajo tani m'ka dalë mu. Tanë natën m'shifke që s'po flej kurrë. E dhezsha dritën, qaty rrisha. Nji tranzistor

qaty t'vogël e ngojsha, se ma ka pasë dhanë NATO-ja atë tranzistor. Po ma ka pa dhanë me e ngu. O kan shumë i mirë, veç e sillshe edhe kangë çfarë t'dushë. Kisha thanë me na përkrah dikush. Jena met qysh jena met. Me pas përkrahje prej dikuj, prej shoqnive ose prej t'mdhejve. Me na përkrah. Na jena met. I kishim lyp t'drejtat tona që na takojnë. Na tjetër sen s'kishim lyp. T'drejtat tona. Çka na ka ndodh, çka o kanë.

03 - H.A.:

UNË DUA TË DËGJOHEM
Libër kujtimi me rrëfimet e grave të mbijetuara
të torturës gjatë luftës së fundit në Kosovë

• RRËFIMI I NDARJES NGA KOLONA

H.A. nuk e ka lehtë të dalë në publik. Nuk e ka të lehtë sa herë që ndeshet me shikimet e njerëzve. Nuk e ka lehtë sidomos kur sheh njerëz të uniformuar. Atë, ende e mundon krimi i kryer mbi të. Një përdhunim që ka zgjatur me orë të tëra nga ushtarë e paramilitarë serbë. Pesë prej tyre i mban mend.

Dëshmitarja që vjen nga një fshat i Kosovës tregon mënyrën se si gratë u ndanë nga civilët e tjerë që po dëboheshin nga shtëpitë, dhe u mbajtën gjatë gjithë natës, duke u përdhunuar disa herë.

Nëna e tre fëmijëve brenda një interviste ka përsëritur tre herë të gjitha detajet e natës më të vështirë të jetës së saj, natë pas së cilës thotë se ende nuk e kuption se pse po vazhdon të jetojë.

Përveç dhunimit seksual, dëshmitarja është dhunuar edhe fizikisht. Në shumicën e kohës ka qenë e alivanosur.

Ajo tregon se sa herë ishte këndellur nuk i kishte ndihmuar askush. Britma ushtarësh dhe goditje të njëpasnjëshme ka përfjetuar sa herë që kishte bërë përpjekje të këndellet.

Nuk ka qenë e vetme. Dëshmitarja thotë se, e gjithë shtëpia ku është kryer krimi ka qenë e mbushur me gra të tjera, me të cilat pastaj është liruar në grup.

Tregimin e asaj nate kishte arritur ta mbante fshehtë... Burrit, që gjatë luftës kishte qenë nën uniformën e UÇK-së do t'i duheshin dy javë, që të hijqte dorë nga divorci...

“...na kanë çu aty, unë jom kanë pa vetëdije. Na kanë marrë, na kanë majtë ka dy ka tre, kanë bo çka kanë deshtë me neve...Kur m'ka ardhë vetëdija, kur kom kqyrë, pesë ishin kanë.”

• Rrëfimi në vetën e parë:
• **PESË JANË KANË...**
H.A.

Unë jam e nji fshati, e lindun me 1960-ën. Kam lind në nji familje mesatare. Shkollimi jonë dej n'klasë t'pestë. Martesa jeme o' kanë me msit. Burrin tri vjet përpara e kom pas, edhe jena martu. Ai mas martese ka shku n'Gjermani. Unë kom nejtë n'Kosovë... Po u kthy, s'ka mujtë me nejtë. Tani kur u kthy ai, veç filloj lufta. Unë e kam pas çikën bebe kur ka fillu lufta.

Kur ka nisë lufta e parë mrena jem kanë t'u hangër mëngjes. Edhe veç e kemi ni që kanë gjijtë. Nuk kom pasë... nuk kom ni shumë, kurgjo. Kur jemi dalë, kemi kqyrë, plot serbë ish mbushë fshati. Edhe na larguan prej shpijave. Dulëm me nji fshat tjetër, dy netë qashtu. E u kthyem apet n'fshat tonin ma. Tani ish gjithë qeshtu... me vujtje.

Unë çikën e kom pasë n'grykë, nji çantë n'shpinë me tesha t'çikës t'vogël. E të tjerët, pér xhepa na u vjerrshin fmia. Prej fshatit e n'fshat. Jo qaq larg, n'fillim t'luftej jo. N'ofenzivën e parë jo, nuk o' kanë qaq larg. Tani jemi kthy n'shpi, e

djegne shpija krejt, me temel. Edhe kem nejtë qashtu deri kur ka fillu ofenziva e dytë e luftës...

Kur nisi ofensiva e dytë, jemi shku me nji fshat tjetër apet. Kur jena shku n'fshatin tjetër, na kanë mbledhë tanve me nji arë. Janë ardhë forcat e armatosuna e na kanë mbledhë me nji arë, tanë n'vend. Na kanë qitë në nji arë. Kanë gjuitë n'drejtim tonin. Tani na kanë marrë kreatve edhe na kanë dëbu prej fshatit në nji fshat tjetër... Edhe na kanë pru n'drejtim t'qytetit. Kur fillumë me dalë prej atij fshati, na kanë nisë me na marrë neve grave forcat serbe. Me kerre, me motora rrugës, nja ka nja... na kanë marr na kanë shti n'kerre... Njihere ia kanë fillu nja ka nja na kanë marrë, tani t'u kalu n'tjetrin fshat, ka dy na kanë marrë. Do na çojshin, u kthejshin i merrshin apet t'tjerat... E kom pas çikën e vogël n'dorë kur më kanë ngrehë prej kolonës, ma kanë gju prej dore n'tokë... çikën. Unë kom tentu mos me shku me ta, e tani m'kanë kapë tre a katër, nja ma ka hi shkelëm, m'kanë kapë për krahve, m'kanë ngrehë zhag e m'kanë shti n'kerr. Tani na kanë pru këtu edhe na kanë shti me dy shpija. Tani natën na kanë marrë... na kanë marrë me kerr e na kanë çu n'tjetershpi.

E na kanë marrë, e na kanë maltretu, mu si m'kanë marrë jam kanë pa vetëdije. Sot si t'i shoh ushtrinë tonë, kerret e ushtrisë tonë, veç i kqyri. Krejt trupi, shpirti m'Ishon. Më duken se po m'hypin mbi kerret...

... Edhe na kanë çu aty, unë jom kanë pa vetëdije. Na kanë marrë, na kanë majtë ka dy ka tre, kanë bo çka kanë deshtë me neve...

Dy janë kanë, deri n'pesë. Kur m'ka ardhë vetëdija, kur kom kqyrë, pesë ishin kanë. Dy e di, mrena shpisë m'kanë shti, tani kur kom kqyrë, pesë ishin kanë. Nuk na ka ndihmu kërkush. Si i kom çelë sytë, i kom pa se pesë ishin kanë. Si i kom pa, veç kom piskitë. M'ka kapë për krahi m'ka thanë, "Çu se kurgjo nuk o ba! Çu!", m'ka kapë... Serbisht. Veç m'ka kapë për krahu edhe m'ka çu. I kom çelë sytë edhe i kom pa. Tani jom ulë e m'hishin krahëve me shkelëm. Une e ulun e ata m'pucatshin me shkelma edhe...

Bashkë me tjera na kanë marrë n'dhomë, nja ka nja na kanë lanë. Unë vetun jom kanë n'dhomë amo n'shipi ka pasë edhe femna tjera... E tani n'mëngjes na kanë Ishu vetë. Edhe kur na kanë Ishu, ushtarë ishin kanë... ata si na kanë Ishu ushtarë ishin kanë. E na i dhajshin, dikujt nji litër zejtin, dikujt i dhajshin kpuca, dikuj qeshtu diçka edhe jemi dalë, edhe tani kena nejtë edhe sa muj aty.

Veç jom mbështjellë. Nji xhemper e kom pasë me dy kqe, njifar jakne. Amo e kom pshtjellë, e kom lidhë me nji tojë xhemperin qeshtu edhe kom ecë. Se bluzat qa i kena pasë, krejt na i kanë pre, përvëç qai xhemper ish kanë. E kom veshë bythëprap atë blluzën si e kom pasë, n'anë t'shpinës e kom vesh...

Kur jom dalë prej shpije, na kanë Ishu thuje grup, edhe jena ardhë. Tani familja jonë t'u i kajtë, t'u menu se na kanë mbytë kreatve. S'kemi guxu kërkujt me i tregu. S'kena mujtë me folë me kérkan kurrë. Ju kemi thanë se na kanë rrehë, na kanë maltretu... Kam qenë qaq e maltretume sa nuk e kom njoftë fminë tem... Non stop mu kujtojke qysh ma gjuitën çikën n'tokë... E kena nejtë, aty jena bo bashkë dhe kena nejtë aty deri kur ka përfundu lufta.

Gjatë luftës burri u kanë n'mal. I veshun. Rrallë e shihshim. Veç kur na bijke bukë...

Fizikisht jom kanë shumë e lodhtë edhe pa vetëdije. Ka pasë moment kur kom mendu se çka me ka ndodhë... fmija prej dore m'ka ra... Për mu njiqind herë o kanë ma mirë me vdekë n'qat minutë se me m'u kthy apet e gjallë...

Burri në fillim e priti keq

Burrit i kom tregu mas... kur ka përfundu lufta, tjetër kush se din. Thashë i tregon dikush tjetër, e ma mirë t'i tregoj vet. Edhe përfundoi lufta, u bonëm apet bashkë, pa shpi, pa kurrgjo. Qysh mujtëm. Edhe o dashtë me i tregu. U ulëm e i thashë, kështu ashtu osht' puna. Ai tha, "Lehtë po thojnë bre, i kanë marrë do, e i kanë... qeshtu i kanë përdhunu do femna, i kanë marrë e i kanë malltretue".

Une kurrë pa mujtë me folë me to... Kur ka përfundu lufta me pyetke "Çka u bo?", "Çka ki?", "Pse po nihesh kaq keq?". Unë gjithë tu kajtë... "Po fmia kanë pshtu, vetë kena pshtu, e pse kështu kaq keq po nihesh?", m'thoijke "Pse?" Ithojsa, "Qysh mos me u mërzitë? A po e sheh që s'po kena shpi? Çka me ju bo fmijëve?" U munojsa diqysh, diçka me ja largu veç mos me dyshu n'mu. Edhe tani, kur po flet për dikan tjetër, tha qeshtu e qashtu, thash se e din edhe përmu, i tregon dikush. I thash, "Qe une, kështu, kështu osht' puna. Bash unë jam...." I thash, "po m'vjen keq, edhe unë vetë që jom. Ti qysh dush bonja, qe ku jom une vetë. M'u qashtu m'ka ndodhë". E na kanë sosë me cigare, e na kanë shkelë n'kamë me themrat e veta. I kom pasë njollat deri vonë. Tani n'kamë, se m'kanë pasë shkelë. I thash "unë vetëjom kanë".

Tha: "Çka?" Thash, "Une vetëjom kanë" Tha: "Menjiherë me u bo gati e me shku n'shpi tane! Ti përmu nuk je... T'kanë marrë shkijet n'dorë, kanë bo çka kanë deshtë me ty. Unë me kanë me ty, jo!" Thashë, "Mirë! Qysh t'duash bonja. Une t'kallxova, që unë s'di çka me bo tjetër. Me qef nuk jena shku. S'di çka me bo!" E t'u kajtë e t'u i piskitë. Mu m'u dhimshin fëmija. Nuk dijsha çka me bo..."

Edhe hajt qashtu kalunë nji javë ditë... Dy javë gati u bonën edhe veç e kuptoi, tha, "Uh m'fal, se unë tu kokna kanë gabim, se unë s'kom mujtë me t'mbrojtë e ti s'ki çka me bo".

Filluan me folë njerëzit

Edhe tani qashtu e kena vazhdu jetën... Tani çika e vogël u rrit.. S'di qysh edhe prej fjalëve, prej rr Ethanave në fshat të burrit, tani ma nuk mujtëm me nejtë aty. Fillunë me folë njerëzit. Edhe na e lamë fshatin tonë e dulëm në nji qytet tjetër. Kur dulëm atje, n'shpi t'huj. Tani (psherëtinë)...

N'përgjithësi, n'përgjithësi. Kanë fillu n'përgjithësi me folë. Burri më tha: "M'thojnë edhe mu, gruaja jote kështu e kështu. Ma mirë po e Ishojmë fshatin krejt. Edhe jemi dalë n'qytet aty n'shpi t'hujë kemi jetu, si ma zi.

Tani sot e asaj dite, shumë e randë, shumë... Sot thom, Zot, s'osht' me jetu për neve, me na pa dikush". Shumë keq, shumë randë e nij vetën. Ama, përveç burrit, këta nuk e dinë. Veç vetë si t'dal n'rrugë m'dukët se tanë po m'kqyrin.

Kisha mujtë femrave tjera që e kanë përfjetu me ju thanë, veç me pasë forcë e me mbijetu. Mos me pasë tanat për shembull stresin tem. E çka o kanë ma kryesorja, me i kapë ata si kanë bo kështu. Me i... me e marrë denimin e meritumë. Ama deri sot hala kërkush... s'e murrën dënimin se e meritojnë. Unë për veti, shumë e ni vetën llom, shumë keq. Shumë e pa vlerë, shumë randë e ndi vetën. Eci, dal, thom, "O Zot, pse po jetoj?" Nuk muj, nji kerr e shoh t'ushtrisë tonë, t'policisë tonë, m'duket se ata janë. Kështu që m'rrenqethet tanë trupi. Ma deri pa ardhë qetu me folë nji trohë, s'guxojsha hiç me dalë. Zor shumë (përshpëritë).

04 - H.H.:

UNË DUA TË DËGJOHEM
Libër kujtimi me rrëfimet e grave të mbijetuara
të torturës gjatë luftës së fundit në Kosovë

• SKLLAVJA E SEKSIT

Atë e kanë ndarë nga kolona, njëjtë sikur se edhe shumë gra të tjera. Paramilitarë serbë i kanë marrë femrat më të bukura dhe i kanë vendosur brenda shtëpive të braktisura. Dy muaj e gjysmë ajo kishte bashkëjetuar me një paramilitar. Nuk ia di emrin, por thotë se sot është në gjendje ta vizatojë. Në kohën sa nuk kishte qenë aty, paramilitari e kishte mbajtur të mbyllur në dhomë. Në dhomat tjera kishte gra të tjera që po mbaheshin ngjashëm. “Në fillim rezistojsha mandej u dorëzova krejt”, rrëfen dëshmitarja. Ajo tregon se si serbi i jepte edhe komplimente, derisa pinte qumështin që dilte nga gjinjtë e saj.

I kanë zgjedhë krejt gratë e mira,
krejt çikat e reja edhe i kanë çu me
ni fshat tjetër. I kanë marr edhe sot
e kësaj dite nuk dihen disa ku janë.
Disa kanë ikë, disa janë mytë,
disa janë hupë

Rrëfimi në vetën e parë:

• **JU SHQIPTARET JENI TË MIRA**

H.H

Unë jam prej një familje të varfne. E kom pasë babën edhe nanën, jemi konë edhe pesë fëmijë. Dy vllazën e tri motra, unë jam ma e vogla. Kur i kom pasë tri vjet t'plota m'ka dekë baba, nana m'ka rritë jetime. Na ka rritë nana me punë t'dorës edhe na ka rritë me shumë hjeka. Me vështirësi na ka shkollu deri në klasën e tetë.

Shkollën fillore e kam kry edhe kom mësu fort mirë. Fort kom mësu mirë, por për shkak se nana s'ka pasë ma shumë munësi me m'ndihmu. Edhe jom regjistru n'shkollë, e kom marr provimin edhe nuk kom mujtë me shku për shkak t'kushteve. Kur i kom bo plot 18 vjet, m'kanë feju e martu me nji burrë, të cilin nuk jom kanë dakort edhe vetë me e marrë për shkak se unë jam kanë shumë e re, ai i ka pasë plot 40 vjet.

Me vllazën e motra kom kalu mirë. Me vllaun e vogël kisha dëshirë me shku'shkollë... Dy vjet i kena pasë ndërmjet. Unë jom kanë ma e vogël, ai o kanë ma i madh. Vllavi i madh tani osht pak... qysh... s'po di qysh me t'thanë, për shkak at'here ju jepshin drejtë ma shumë djemve me i shkollu se çikat. Tani atij i ndihmojshin me veshëmbathje edhe pse o kanë ai ma i dobët e unë jom kanë ma e aftë e ma e zgjutë. Unë gjithë e kom pasë suksesin, pesëshe e katërsa, gjithë i kom pasë. Edhe pse ia merrsha midisat e fletoreve t'shoqeve. Ato shoqet taman thojshin, "Hajde, hajde t'i japum na e bone ti nji fletore, e shkruejti me neve e mëso ti me neve", se s'kom pasë as çantë, as fletore as... E jom kanë gjithë diqysh kryeulur për shkak t'skamjes. Edhe... Kom punu me nanën gjithë, e kom ndihmu nanën për çdo sen. Kena pasë tokë, lopë, qishtu gja, pula, a pare nuk kena pasë hiç. Tesha edhe pare kryesorja, vetëm nuk e kom lanë shkollën kurrgjo vetëm se jom fillu... deshë. S'kom pas qysh me shku. S'kom pas as çka me shti bre n'kamë. Dathë e deshë edhe jom shkollu, edhe e kom dhanë provimin edhe krejt edhe nuk kom mujtë me shku.

Nana o kanë qaq e zoja sa që sot e atë ditë përmendet për marifet, për t'mirë, për zojë. Vllaznit kanë qenë t'përdorshëm po disi si janë rritë jetima, si t'shelën, si kokëular, si t'struktur kemi qenë na t'gjithë. Se une me atë bukur që e kom pasë e më atë zgjuarsi që e kom pasë, unë kom mujtë sot me arritë edhe ma nalt se me kanë n'qeveri e me kanë, ku ta di une. Nana m'ka jetu... dy vjet masi m'ka martu. M'ka vdekë kur i kom bo 20 vjet, m'ka vdekë nana. Nana... ka ardhë dikush, t'ka pa familje e mirë, punëtore, e i ke nga nanës tane. Punojsha tani me nanën temë, gjithë e heshtur. I ndihmojsha me punë dore, i ndihmojsha me punë t'shpisë gjithë. Tani kush si thojke, ai i thojke "Ta marrë unë", edhe ai, "Ta marr unë". E pat edhe problem aty nana se shumë u ngatërrunë. Se thojshin "Hina na edhe e marumë mrena me zor se osht shumë e mirë, osht shumë e vlefshme". Tani nana e get kta 40 vjet edhe ky e kish pasë grunë, i kish vdekë gruaja edhe mu nuk më tregunë hiç. Në mbramje erdhën, bisedunë, "Ma mirë osht me u martu, ai ka pare, ai ka... t'man, ai...". Ma mushën menjen mu, unë isha e re. N'fund t'fundit ky burri jem tha, "Unë edhe e çoj n'punë, e shkolloj" e kështu, kështu, ma shkurt, m'fejunë. Tre mujë ditë, tani m'martunë. Ai 40 i kish. Unë i kisha 18. Kom pasë qeiz, kom pas shijana me vek, kom pas... edhe sot, me dashtë me ia menu, punojmë n'vek, tana veket i punoj.

Kanagjegji ka qenë nji natë. U tubojshin t'shtunën çikat. Këta qitshin shaminë kiske me kajë. Uh, uh, uh {pëershkuaran vajin me zë} me ba. Edhe vijshin, bojshin përhajr t'nesrit. Po, burri e pruni kanën, nana e maroi. Tani motra e madhe e majke kështu, e u dufke me u ngjit e me i lanë gishtat në stenë e me ja ngjyrosë krejt atyhit thojtë me kanë t'kuqe.

Detyrimisht nuk e ke pas me kajtë po u duhke me bo "Uh, uh, uh", po qe kur t'vijshin shoqet, e t'vike dikushi i tyi edhe kajshe me za.

Të diellen n'mëngjes tani t'ndreqke nji grue... ktyneherë s'ka pasë frizerka kështu e nji çikë e re, ose nji gru ma e moshume vike t'ndreqke pak, ta ngjitke duvakun, dimitë...

M'lindi tani mas nji viti m'lindi djali. M'lindi çika, djali edhe nji çikë. Të tretë, nja mas nja.

Me burrin shumë mirë. Më ka ardhë mirë që m'ka këshillu mirë. Burrin e kam t'mirë. Burrin e kam shumë t'mençëm. Edhe e kom pasë edhe për uratë shumë t'mençëm, shumë t'naltë, shumë t'zotin, shumë t'aftë edhe pse o' kanë i vjetër.

Nuk kom pasë kurgjo problem me ta për shembull...

Shumë mirë e kom kalu. Shumë mirë, sot vjehrra nanë m'daltë. E du vjehrrën shumë, e kom dashtë shumë kunatën, kom kalu shumë me ta. Sa që fëmija e kunatës, "Nanë" sot ma bojnë, apet, sa i kom ushqy si ata si t'mitë. Jon kanë shumë nji familje e ngushtë, e afërt, e dashtme. Me mu s'kanë pasë problem kurrë. Jom kanë e plotë, e kom ndëgju burrin se çka m'ka thanë.

Lindjet i kom pasë me kohë. Çikat i kom lindë të dyjat në shpi, e djalin e kom lindë n'spital. Djalin më kanë çu në spital për shkak t'sigurisë, se edhe djalin e kisha lindë n'shpi. E çikat i kom lindë n'shpi, n'mbramje. Gjithë ditën kom nejtë me dhimtë, i kom ndihmu burrit me maru beton me meshalicë. Madje, kur ka ardhë dhetë t'natës kom gatu për darkë, kallabllëk. Katër teplia i kena qitë se vishin edhe bija edhe ish familje e madhe. Edhe në magje, kur m'rrokshin dhimtë, u rroksha për magje. Rrisha, rrisha deri sa mu nalshin. Kur mu nalshin i t'hollojsha kuleqët e tap, e tap, e tap i bojsha teplijat. E kumullor kena qitë qat natë, s'e harroj kurrë. E ia kena shti petén e kumullorit, e kom la, e kom kallë shporetin me dru. Ma së zorti m'vike me i shkurtu drutë, i shkurtojsha drutë. E tani burri jem thojke, "S'po dijshe ti kurrë me sharritë drunin me sharrë" a din. Unë thojsha, "Une kurrë s'kom sharritë, s'di", e u mësova me pykë tani me çà drunin, lanën. E marojsha njihere pykën, e ia bojsha kështu me sakicë, tani i mshojsha pykës edhe u çajke druni, po! E i qita ato teplija, katër teplija, kur i bona edhe hangra darkë. Erdh vjehrra jeme tha, "Aiii sa hangre darkë ti, sa hangre, gjysë teplie e hangre. Kurrë s'ki me lindë sonte" Thashë, "Ani mirë" hiç s'i bona za. Jam kanë shumë e qetë, shumë durueshme edhe pse edhe sot jam qashtu. Kur ajo vjehrra shkoi n'sobë, kunata shkoi në sobë të vetë me ra me flejtë, vjehrra shkoj n'odë me e kqyrë televizorin, n'fund t'oborit, oda. Mue më rrokën dhimtë edhe e përgadita krejt, jom kanë e zoja. E bona zhletën, zhletën e re me ja pre kthizën, penin e kuq t'bebës. Peni o dashtë me kon i kuq. E përgadita edhe nji qebe te dera e dhomës. Edhe nji najllan e shtina nér qebe për shkak të sigurisë, u ula n'dy gujtë, i mshova barkit me dy duar ving edhe m'dulë. Kurrkush hiç aty. As edhe 20 minuta nuk ka ardhë kurrkush. Edhe jom avitë, e kom çelë në dy gujë mbi bebë, e kom çelë derën pak edhe kom thirr. Thirr, thirr, thirr, hiç. Njëmbëdhetë i natës. Thirr, thirr, thirr. Tani nji çikë e kunatit o kanë n'odë me vjehërr teme, e kur o ardhë tha, "Valla kish lind inxhja!" "Ku kish lindë more? Ajo tha se se s'kam me lindë sonte". Tani erdh burri, m'kqyrën, rashë edhe flejta, e mora bebën ngat. E vjehrra tha, "E çka me bo tashti?" Thashë, "Jo une e di çka me bo". M'ka mësu nana jeme, m'msojke, e mora ia lidha kthizën mirë me pe t'kuq, ia prejta edhe i mshova apet barkut. Beba qatu. Edhe m'ra ani mbi bebë. Ani i fmisë. Edhe thirra, e mora nji copë xhemperit edhe u vesha. I vesha brekët edhe e vesha nji copë t'xhemperit edhe e shtina këtu. Edhe u vesha, u pucita ding ding këtu e këtu, drejt u çova n'kamë. E mora bebën e lajta n'koritë. Nji koftorr e kom pasë, e e kom qitë nji kofe t'vogël n'koftor. E lajta bebën, e qita me flejtë edhe shkova e mora do tamël, u çova vetë. Tamli ish në kuzhinë. E i lajta durtë mirë e mirë, si sot m'u kujtohet. Edhe e mora e vlova tamlin mirë, e pita nji gotë tamël. Edhe u munova me i dhanë djalit gji por nuk ma merrik fill. At'here shkova e prita, prita deri n'sabah me i dhanë. Thojsha mos po m'vdes djali, nuk mujsha me flejtë. E ia lashë kogja gatë kthizën. Veç ngat ia lidha e knej ia lashë. E ia hjeka krejt gjakun e kthizës, ia pastrova mirë. Nanën e kom pasë shumë t'zgjutë, nanën e kom pasë shumë

t'aftë përfamilje. E rahatova, u çova n'mëngjes, i lajta sytë, i lajta durtë, i shtina kaftjallin, bukët, me e bo bukën. Ato vjehrra e kunata anej flejtjanë kanë. S'jonë qu hiç, ato qohen kah n'nantë, dhjetë, e ti bon çka t'dushë. Dy fëmijë i kom lindë në shpi, por për djälë m'kanë çu n'spital... Qysh po thom une, prej akshamit m'kanë çu n'spital se për shkak të gjinit. M'ka ardhë gji shumë. E djalit kom menoftë...

Qaq t'teprumë për shembull e kom pas kujdesin përfëmijë, unë nashti nuk kom pas çare, por fmija para meje nuk janë çu kurrë. Unë jam çu para fëmisë. Ja kom përgaditë çdo sen, veshjen, mbathjen edhe me pasë gjet fmija dikun, e kom la e kom kepë, e kom ndreqë sa qì kur o dalë ma ka bo, "A ma jep ta veshi?" dikush, atë teshë që e ka marrë n'kontinier, n'bërllog. E ia kom bo atë teshë e ka veshë. Bile m'kujtohet, drejtësia e Zotit, po e kallxoj, një kojshike e çikës ma t'madhës, e o shku ia ka lypë një xhemper e ka veshë. Ajo e kish vllavin n'Gjermani e ajo çika e veshi njihere, e kur u bo e dyta ditë erdh e ia murrë atë xhemper. Tani çika jeme gjithë shkojke me lopë. Ia Isojsha tri fëmive një lopë e shkojshin atje para dyerve t'atij kojshisë. E kur o ardhë Shën Gjergji, ajo i ka tubu teshat edhe e ka gju atë xhemperin që ia kish pasë veshë çika jeme. Po ia kish hangër mini dikun, e tani e ka pru çika n'shpi. E tha, "Oj nanë, kuku qytre xhemperin e mirë ia kishë grisë mini" Thashë, "A po a?" Tha "Pol!" E ia kom ulë n'sodë e prej marakit edhe n'shampon e laj, e laj, e një qind herë ia kom la, ia kom bo qysh me thanë, as e reja s'u kanë ma mirë. E ia kom marrë e ia kom kepë mirë, e kom ndreqë. E kur o ardhë dita me shku n'shkollë, t'hanën o' shku çika e veshne e matnë.

E kur o ardhë puna, ajo çika i ka thanë, "O sa t'mirë e paske qet xhemper?" Thotë, "Po valla e kam". Kjo a e din, gjithë kokëular se o kanë asi... Kur mas dytre dite po vjen ajo çika, "A ma jep qat xhemper se po du me shku me një dasëm?". Çikës teme po ia lypë qat xhemperin.

Kjo çika jeme si ka thanë se e ka marr n'bërllog hiç, por e ka ble, e ka ble xhemperin. E katër vjet e ka veshë kjo çika atë xhemper, e o shku n'shkollë edhe e ka kry shkollen me atë xhemper t'grisun. E nuk o ditë se o kanë i grisun se ia kom ndreqë mirë, e ia kom ngjitet një copë aty, kishe se e ka një lule këtu. Ia kom hjekë një vinjakut edhe ia kom ngjitet këtu.

Me bashkëshortin tre fëmi i kemi rritë edhe pse jo fort kushtet e mirë, jena ballafaqu me to. Por një kohë filloj njifar keqësimi i situatës. Një periudhë e para luftës... ish shumë e zorshme. Vetëm rrijshim tu i ndëgju se çka po bohet atje, çka po flitet. Përpara o kanë shumë vështirë që ka qenë shkitë në Kosovë. Na kemi jetu me ta edhe kemi përjetu një tmerr prej tyne. Ma vonë tani, kemi qenë nëpër shkolla, fillojnë shkollat që të helmohen nxansat... Edhe fillunë djemtë e ri që t'i marrin ku t'i gjajshin, diçka për një fjalë ose për një t'shkrume n'dërrasë t'zezë nxansat i majshin, i rrehshin, i malltretojshin. Nuk guxojshim me dalë në rrugë t'lirë, çdo sen e kena pasë t'kufizune prej tyne, prej shkijve. Edhe ditë pas dite, në vitet e '90-ta, veç filloj... Rrugëtimi ishte gjithë me malltretime rrugës. Edhe ditën e Bajramit ma kanë malltretu burrin. Tu shku n'xhami i kanë dalë përpëra. N'vetit '90-ta, herët ka fillu lufta. I ka thanë, "Nëse doni me shku n'xhami, bini çdo njani ka dhetë euro". E këta me traktor kanë shku, janë zhdrypë prej traktori edhe i kanë lanë njani përtjetrin ka dhetë euro krejt, e jau kanë marrë dy-tre qind euro, janë shku e kanë falë Bajramin edhe janë kthy. Këta edhe kur janë kthy, apet i kanë nalë e i kanë plaçkitë rrugës.

Atë ditë që ka krisë lufta, nisën të shtënat u kallke flakë. Atje në fshatin tem gjujshin po... Gjithësecili i frigumë, te shoqi shkojshim, kqyrshim, ngojshim. Kur u errsu nata, kanë fillu me gjujtë n'fshatra, gjujshin, i kallshin, hijshin i kallshin shpijat, i kallshin gjajat edhe filluan t'mysin njerëzit. U njike, u myt filani, u myt filani edhe na e parapamë, për me dalë prej shpijave. Vendosëm me burrin edhe fmitë edhe krejt fshati u organizumë edhe thamë po dalëm me nji mal, po dalim me nji tunel diku.

Dy ofenziva. Dy here jena dalë prej shpijave, dy here jena kthy dimrit. Tani '99 pranverë për t'dytën herë jena dalë. Edhe kemi përfjetu nji tmerr. Kemi shku n'fshat, aty n'fshat na ka ardhë policia e na kanë marrë. Jena kanë afër 1500 gra a ma shumë. Vetëm gra edhe pleqë edhe fmi që jem kanë.

I kanë zgjedhë krejt gratë e mira, krejt çikat e reja edhe i kanë çu me ni fshat tjetër. I kanë marr edhe sot e kësaj dite nuk dihen disa ku janë. Disa kanë ikë, disa janë mytë, disa janë hupë...

N'kolonë jena kanë. Veç t'ka marrë, kap për krahi edhe t'ka shti mrena. Tjetren, tjetren, tjetren... se rrëth shpijave... Me kerre, me gjipa ishin policia. Edhe unë jom kanë ndër ato gratë edhe kom përfjetu 22 ditë, kom nejtë me nji dhomë e mbyllne. 22 ditë kom nejtë me nji dhomë. M'dajtën. M'dajtën prej familjës edhe m'kanë marrë edhe kom përfjetu nji tmerr. E kom hangër deri mishin tem, se kom nejtë mshelë pa dyer e pa dritare. Me i pa me sy i njoh, a emrat jo se janë rujtë prej neve, nuk ua kam ditë. Edhe vetëm n'mbramje ka ardhë deri n'mëngjes ka nejtë. N'mëngjes ka dalë apet deri n'mbramje ka ardhë, 22 ditë. Janë kanë me shirita t'kuq t'lidhun në krah, kapuçat t'zi kanë pasë në kry. Tesha t'zeza kanë pasë.

Alltija kanë pasë, automat t'shkurtë kanë pasë. Sot e përfjetoj, muj me e vizatu njerin.

Njeri i nejtë edhe nuk o dalë kurrë. Gjithë qai i nejti o ardhë, i nejti o dalë. Ka qenë shumë vështirë. S'muj me paramendu. Vdekja nuk osht kurrgja. Kurrgjo s'osht' vdekja. Për shembull, e ke pa dekën me sy e s'ke mujtë me vdekë. Aty edhe veten nuk ke mujtë me e mytë. Kom tentu edhe s'kom mujtë me e mytë vetën se për shkak të shumë tmerreve që na kanë bo. Deshë krejt, cullak, m'ka mshu n'krejt trupin, m'ka mshu krejt... krejt, krejt vred. O bo dy vjet s'u bo trupi prej dhamve, prej lëndimeve t'marra. N'fillim kom rezistu boll, masanej ma jom dorëzu. Kom marrë, m'kanë dhanë infuziona, m'jepke bukë me hangër... Ai, shkavi vetë. N'aksham e bike njerin, ma bike infuzionin. S'folke me mu, as që folshin serbisht. I kom kuptu krejt.

Shpi ka qenë. Odë ka qenë. Odë e burrave. Ka pasë gra tjera në dhoma tjera. Plot. Krejt oborret plot, u njike piskama. Gjithë natën, gjithë ditën. Ka pasë çika t'reja, ka pasë gra t'moshume, ka pasë... tmerr o kanë. Të izolume midis mali jena kanë. Se veç Zoti na ka nisë s'ka pasë kush që munët... Je dorëzu deri sa ka ardhë vakti për me na liru. Ata nuk na kanë tregu neve. Na kanë lanë mshelë aty edhe veç kanë ecë tenkat. Na nuk e kena ditë hiç, veç u shukatë. U shukatë para sabahit, u shukatë. U nal, as ushtima as kurrgjo. E kom çelë kadal dritaren edhe kom kcy prej dritares. Edhe kom dalë edhe kom ec, kom ec, kom shku, por nuk pata fuqi me ec edhe jom ra n'arë edhe kom nejtë. Janë ardhë dy vetë. Ata i njoh, ata njerëz. I falënderoj shumë edhe kanë thanë... "Çka ki, a je e plagostë?" Thashë, "Po, jam smutë, e plagostë". "Kush t'ka pru këtu?" Thashë, "Jam smutë, veç do ujë a ki me ma japë?" Kanë shku kanë marr ujë ata n'fshat

aty dikun edhe ma kanë dhanë do ujë edhe lajmërunë, "Kush je, tek je ti?", tan kohën kah po enen. Thanë, "U bajtën ato tenka qanena edhe na ecëm knena". E morrën nji kali edhe nji kerr edhe m'kanë qitë n'kerr n'kali para durve. M'kanë qitë edhe m'kan cu te nji shpi. Aty janë munoftë me m'dhanë me hangër, m'i kanë la sytë, m'kanë nimu. Aty ishin kanë dy gra, at'here m'kanë vetë kush, tek. Mas nji kohe e ka marrë burri e ka lajmu burrin, e ka mushë traktorin edhe e o ardhë e m'ka marrë n'traktor t'shtritë.

Kanë ardhë nji shoqatë italiane t'nesrit n'mëngjes edhe m'ka kqyrë aty. Tha, "Kjo nuk bon me jetu këtu, duhet me e çu jashtë diku se ja ka nisë me e hangër gjakun e vetë, me e pi". E ka tejkalu ma, veç skeleti, insani dhe mish... mish hiç. "E ka hangër mishin e vetë, ma s'ka kjo". Tani burri i kish gjetë fminë, i kish marrë fëminë. Djalin e kom pasë t'plagostë n'kam prej copës t'granatës. E i kish pasë marrë burri fmitë e e kanë ditë që unë jam e mytne, e hupne, e vrame. E tani kur kom ardhë, tani kanë arritë fémija. Por tani as me e çu dorën përpjetë, as hiç. E shumë jom ligë, e qaty m'ka dhanë ndihmë ajo shoqata. Kanë thanë me çu n'spital e n'spital kom nejtë katër ditë, a pesë. M'kanë dhanë infuzione kurrë pa ndërpri. N'spital t'Pejës. M'ka ndihmu spitali mirë. Kom marr pak veten, u çojsha vetë u ulsha. Edhe ma kanë asishë trupin, ma kanë dezinfektu se krejt kështu... tani krejt m'kanë fërku fund e kry, me kamë e me trup e me krejt. Tani mas nji kohe e kom pasë nji operacion n'anë t'fmisë për shkak të infekcionit t'madh. E kom gjysën e anit t'fémisë e kam t'hjekët. Qajo m'ka diktu tani gjithë kom pas traumë shumë. N'errësirë s'guxojsha me dalë, traumë. Me nejtë mbi shporet s'mujsha me bo bukë. Tani m'kanë ndihmu fmija, m'kanë dhanë me hangër, me pi. Kom nejt një katër vjet. Tani tu e marr vetën, tu e marrë vetën. Kom deshtë s'di sa herë me e furë vetën. Kom tentu me e mytë veten dy-tri herë. Kom pi njihere domestos e m'kanë ndalu fmija edhe nuk kom pi shumë, se thojsha veç gjallë mos t'jam hiç ma. Tani m'kanë çu n'spital. Kom nejtë nji muaj e ma shumë. Sot e atë ditë kam probleme me lukth.

Atje ka pas shumë gra po skemi mujt me folë. Se në dhoma vetë. I ndrrrojshin bravat. E ndrrrojshin e çelësin kap e shtike n'xhep, "Rri ti aty", thojke. I nejti person çdo ditë. Secili ka pas punë veç me nja. E zgjidhke ma t'mirën, ma t'zojën t'cilen ish, masanej s'e Ishojke. Ai tjetri e merrke tjetrën, e ai tjjetri tjetrën... kish boll. E bike bukën n'sabah, t'jepke me hangër... Gullash, bukë. I qitsha do krypë kështu se s'fleshja kurrë. E te kalova gjumin, kurrë, kurrë, kurrë. Edhe sot kam problem gjithë me gjumë. E qitsha do krypë edhe kështu e ngjyjsha, e lypsha, tani e pijsha ka nji gotë ujë për shkak me flejtë. S'mujsha me flejtë. Dhunë edhe ditën vike edhe n'mbramje deri n'mëngjes. Mos të provoftë Zoti kanë me çka na ka provu neve. T'dhunojke me zor deri sa t'lodhke sa s'mujshe mu çu n'kamë tua... Spo di çka me thanë. Zgjatke 20 minuta, 30 minuta, qysh asish. Apet, apet, apet. Bojke vaki deri n'mëngjes katër here, tri here deri sa... Ditën dilke, tani çka po di unë kah shkojshin, apet vishin.

Qashtu 30 vjeçar, qashtu n'moshë. Veç fjalë t'mira gjithë folke. Thojke, "Ju shqiptaret jeni t'mira, jeni t'ambla, jeni qashtu. E keni tamlin e gjinit t'amël". E unë e kom pas djalin n'gji. M'i thithke gjitë... Na kena përjetu nji tmerr. Unë nuk e di çka jonë t'u bo, a qysh jom t'u e përjetu kta, qysh mujnë me nejtë aty n'karrikë çka kem përjetu na. Qysh mun ai me nejtë n'karrikë. Qysh mun me nejt ai me u errësu akshami pa nji ndihmë për neve. Unë sot bukë noshta s'kam n'shpi për iftar me hangër. E qysh mun me përjetu ai këtë tmerr që e kom përjetu une e ai

rrin n'karrikë e e merr 2000 euro rrrogën.

Mas lufte ka qenë një jetë shumë e randë. Kom trokit n'derë t'çdokujna. S'kom gjetë kurrëfarë mundësie përveç n'KRCT. Ju kom lutë t'gjithëve, çdo shoqatë, çdokun kam lyp ndihmë, i kom tregu t'vertetat t'gjitha. Kam edhe dëshmitarë, e kam burrin dëshmitar, i kam edhe shoqet dëshmitare që i'a tregonjë qeto... nashti edhe unë jam e ngarkume shumë e nuk i di krejt. Ka si shoqja jeme që i'a tregon edhe ma kthjellët qeto çka kena përjetu e çka kom përjetu unë.

Burrit, i kam tregu vonë, ma vonë. A burri m'ka pa mu kur m'kanë marrë. Ai o kanë n'mal, m'ka kqyrë. Ka thanë, "Unë t'përkrahi ty se edhe unë nuk kom mujtë me t'nihu kurgjo. T'kom pa edhe qysh t'ka marrë edhe saje ballafaqu ti me ta edhe nuk t'kom ndihmu ty kurgjo edhe duhet me t'përkrahë ty n'çdo aspekt". Edhe m'përkrah deri sot.

Kom fillu me tregu. Kom fol me shoqe, tanë kom fol me shoqatën. Deri sa s'kom tregu hiç, jom kanë shumë ma keq. Nja katër vjet s'kam tregu. As nuk kom folë me bashkëshortin. E dijke bashkëshorti, por nuk mujsha me ia spjegu. E kom nejtë shumë, s'kom folë me kérkan hiç. Gjithë tanë thojshin, "Kjo osht e smutë". M'u m'brejke qajo se unë nuk isha e smutë. Unë e kuptojsa por m'brejke qajo mu gjithë më ka prekë. Por s'kom pasë çka me bo, ajo o ba pa dëshirën teme.

05 - H.K.:

UNË DUA TË DËGJOHEM
Libër kujtimi me rrëfimet e grave të mbijetuara
të torturës gjatë luftës së fundit në Kosovë

•DHUNIMI I GJITHË LAGJES

Bashkë me fëmijët dhe familjarët e tjerë kishin dalë nga fshati me idenë se do të gjenin një vend të sigurt. Për muaj të tërë do të endeshin nga një fshat në një fshat tjeter. Çdoherë e më vështirë po bëhej për këtë nënë dhe fëmijët e saj sado që koha po kalonte.

Nën urdhrat e paramilitarëve serbë, ajo dhe gjashtë familje të tjera vendosen në disa shtëpi të braktisura në një qytet të Kosovës. Të gjithë ishin fëmijë e gra. Për disa muaj janë dhunuar sistematikisht. Nuk u kursyen as fëmijët. Ajo është e bindur se ka arritur të abortojë me barna popullorë shtatë javë pas dhunimit të parë.

“Ata t'tretë rrishin n'derë e nja po hin mrena. E tu m'kap mu, tu munu me m'kap përqafe. E kom shty e... tu e hjek atë kondaktin të m'ka shty. M'ka nxanë përpjetë përtej tavolinës. O Zot, m'çkoqi krejt. Vdiqa prej dhimte.”

Rrëfimi në vetën e parë:
ABORTOVA SHTATZËNINË
• **QË E KISHA PREJ TYNE**

H.K.

Jam 69'sh e lindur. Edhe vajzërinë e kam pas tragjike. S'kemi pasë. Skamje, gazep. Jemi rritë n'kushte shumë t'randa. Baba i papunë, kallaballëk fmi. Kemi hjekë boll. Kem përjetu boll. Bone hesap, që ka pasë ditë e qitke nana një bukënore. Nana s'hajke hiç. Ja niske kajke. Unë isha ma e madhe prej tanë fmive. E pajsha nanët tu kajtë, e thojsha, "as une s'du me hangër". Pasha Zotin. Me talla jemi nxeh. Qaq jetën e kemi pas t'rändë. Tanë, me motra me vllazni kena m'su. Tashti, qato që kemi hjek, e me qato kushte kaq t'rana, krejt janë profesora, krejt janë që punojnë, krejt janë që janë shkollu, doktorra, krejt ajo familje e jemja, fije e për pe. Tanë janë shkollu. Krejt. Po veç vllaznia, na motrat nuk e kemi pas shansën me shku në shkollë. Jom martu në moshën 17 vjeçare. Me msit.

K'ta t'burrit ishin kanë t'pasun. Edhe, hajt tani erdh koha... u qeizojshim at'here, nashta t'kujtohet me grep e me kamza, ma prunën aty e m'njimojshin shoqet. T'shtunën herët n'mengjes, kurrë se harroj, dola bajagi me kajtë. Jo me kajtë, por gjak prej syve kam pas qitë. Prej dhimbjes për nanën. Hajde more Zot. Erdh e diella. Me shku nuse... Kanë ardhë me m'marrë me dy parë tupana. Qaq që kanë pasë e qaq dasëm e madhe. Po baba jem u ngushtojke se nuk kish... Prej t'ejtes deri n'tejten o kanë dasmjë.

Nuk e kam pa burrin deri n'at natë t'dillën që hike dhandri. Atë natë që jom shku, jo se kam pa burrin kurrkun. Veç deri sa që o hi dhandër. Burri kështu mirë boll. Valla s'më ka bërtit kurrë, as s'më ka thanë fjalë t'keqe kurrë, as s'më ka thanë "bone kta", "bone ata", a me thanë "Hajde se je ardhë prej familje t'varfun"... Kurrë n'jetë. Mirë kem kalu. M'kanë deshtë te tanë.

Unë fminë e kam lind, se s'ëm ka falë Zoti deri mas 10 vjete. 10 vjet s'kam pas hiç.

Çika ka ardhë ma s'pari, masanena ma fali Zoti djalin, tani tjetrën çikë. Qata tre fmi n'jetën teme veç.

Para luftës, deri sa s'ka kris lufta, përrpara luftës sa jemi kanë... lumturi. Mi fali Zoti fëmijët... Çika në klasë të parë. Me burrë mirë. As kurrë n'jetë s'kena pasë probleme as sen. M'ka respektu boll edhe e kom respektu jashtë mase.

Ja nisën me mbledh armë. Babës tem ia kanë marrë llovaqkën edhe i kanë ra shuplaka qaty para neve.

U bojka shtatë ora, ja nisi ora policore, nuk guxojshim me dalë deri n'shtatë t'mëngjesit. Bojke vakija pak para shtatve o kanë.

Edhe tani, hajt, hajt qaty. Edhe kur filloj lufta ish prilli.

Isha tu gatu e isha n'magje, qysh o kanë rendi te kunata, ka nja e gatuojshim. U ardh nji kojshi e po i thotë vjehrrit "ku jon djemtë, ku janë gratë, djemtë!?", ish qartë njeri. Tha, "Qe ksjade, dikush n'arë e dikush." "O tubë boni se kuku për ne lufta ja nisi, marumë!" "Çka je tu thanë?" "Pasha Zotin po edhe mi kallxu krejt mahallës", që mu tubu, lufta ja nisi. Qysh luftë! U tranumë tanë. Far luftë.

"O ikni se s'dijmë çka ka me pasë!" Ku me ikë? Ku me shku?".

Ja nisën po vijnë pej neve. U përhapën, serbët, shkijet. A po do autoblinda, a po do kerre, a po do shteti n'dorë edhe sen s'kishim mo, si populli jonë.

Edhe çohëm, çka me bo. Ja nisën plumat, ja nisën gazep, ja nisën malit përpjetë...

E çka me bo, t'i kapim na fmitë, te lamë qysh o kanë me shpi e me krejt, e shkojna me ni katun tjetër.

Qysh thojnë, prej qeti katuni tonë, pak ma nalt, nji katun tjetër. Lufta ma su nal kurrë.

Po çka me dalë edhe me pa, ishin pa stacionu aty policia e pru ushtri e krejt. Kur po e shohim krejt zi, kuku çka me bo. Nejtëm atë natë qysh nejtëm, natën e gatë t'cumë.

Ia nisën gjuijshin përpjetë, gjuijshin mi shpija. Aman jarabi, o Zot, o Zot.

E kena pas nji podrum. N'ta u tubumë krejt mahalla, qaty erdhën te na. Tanë qaty.

Edhe aty nejtëm vallahi nja tri ditë. N'qat podrum aty kush t'mujke tinxa mu çu noj bukë a çka me gatu se mas tri dite na hinën, na qitën prej shpijave. Burrat jo, ata dulën ma herët n'mal. S'ishin. Veç gratë. Burrat s'kanë guxu me nejt me neve. Qat ditë që jon ardhë e ja kanë nisë krismat ata janë dalë. Burrat ma s'ka

pas shansë mu kthy n'shpi. Ju çojshim ka një trohë bukë, e dishim ku janë, ashtu si tinza.

"Hajde tash ecni, ikni prej ktuhit, shkoni kah t'doni."

S'kena ditë ku me shku. Kah me ja majtë, kah me shku. Jena shku, jena nisë për një katun ngat. O Zot, qat natë që shkumë mu rrxu djali, djali i hasretit. Se kem qaty n'katun, veç dola me e marrë një kofe ujë n'oborr thash t'ja çoj fmive mrena... E kom lanë djalin në ballkon, e t'ka krisë granata, djali prej tute, kcen more bijë prej një katni n'tokë e bjen n'bllok. E te çkynë me kry, me vetull...

Thash "vdiq". E kom marrë, e kena shti mrena qashtu, i vdekun, e krejt t'i plasi gjaku. Edhe e çumë te një mjek në një katun tjetër me traktor. E ka marrë, e ka kep, ja ka mshel varrën me zavoj e me krejt e faleminers prej tij, ku janë e ku s'janë. E ma ka marrë djalin tem n'dorë edhe jena kthy apet aty. Ata krejt t'u menu që u vdek djali. Po, qysh jo, u qetsu, qysh thojnë, ju kthy shpirti. T'hinën aty, na hiqën prej shpijke tanve.

Edhe t'na tubunë me një fushë. Krejt. Tri ditë e tri netë kshtu n'hapësirë e diell qaty. Na tubunë krejtve aty. Na nxuni nata, ish ftoftë. O Zot, ftohtë e gazep nëpër shi qashtu, fmija gullumuq pa hangër, pa pi, piskatshin. Dikush kish marrë saça, pak miell, dikush provojke me gatu n'atë fushë. Na gjujshin me granata. Njëherë e mytën një burrë, tani një gru. Britma, fmi, piskama, tmerri që o kanë. E qata me e përjetu, o Zot i zanës. Granatat, përmë kry. Janë hi i kanë marrë krejt djemtë e ri. I ka zgedh veç që ja ka vra synin. Ka pas 11 vjeç e kanë marrë, e përpjetë. I kanë marrë e i kanë hjek krejt prej neve.

Mas tre dite i Ishunë burrat e jemi hyp prap në traktora edhe ia kemi msy qytetit.

Me një fushë na kanë dalë shumë ushtarë. Krejt të zi me maska. Aty na kanë dalë përpara krejt me automata. Krejt zi. Për Zote, na kanë sha, na kanë malltretu, na kanë thanë gjithçka. Kesheshin, bojshin hajgare, thojshin fjalë t'ndyta, zi e ma zin qat fushën qaty. Na secili vaj e britma.

Na thanë me u kthy, ecëm edhe një dy orë edhe shkum me një fushë ku kish pas shumë popullatë.

Dhjetë ditë qaty kemi nejt. Mandej erdhën edhe na i kallën traktorat, thanë ecni rreshit në kambë.

Me ni kolicë t'punëtorëve që bajnë mallter e bajsha çikën. Po nuk shkojke rrota prej lloçit. Shi i madh.

E qoj Zoti shi e lloç. O gazep i Zotit. Çika shatë javësh. I humbi vetëdija. Kuku, çka me bo, tek me bo. Allah, do me m'vdekë çika. E kom qitë çikën e kom lanë te ura aty. E kom Ishu. Thashë Zot, thashë "Allah. Luftë se mos t'ëm shtift Zoti n'gjyna, boj çka boj, se veç me dhanë shpirtin qaty."

U ndajta me çikën e vogël se aq u lodha aq m'lë shpirti, evlad, a kish gjë ma vshtirë, jom mshtet te perëndia, i kom mshel sytë edhe e kom lëshu çikën n'tokë. E kom lanë.

Secili, qysh thojnë, s'dike kush çka bon. Prej traume, prej gazepi, prej... Tu na dhanë zor. Si kem ec pak ka nisë beba që e lash me kajtë. U kthy çika e madhe 6 vjeç, ka shku e ka kap për toje të lulakut edhe nisi me e ngreh. Thashë, "O leje." Tha, "O mam bre nuk e la!" Thashë, "Sa t'kapërcej ty edhe djalin se kthena edhe e marr."

E mora një qebe me një traktor e shkyva edhe e lidha për midisi, edhe e lidha çikën përbeli. Për trupi tem. Edhe kemi ec kurë pa nalë.

Mas tre dite na lanë me hy me një katun. U vendosëm në një shkollë, si me na pas dhanë dynjanë na u dokt.

Na thanë që duhet me u largu edhe prej aty. Vendosëm me u nda, kujna kah i'a merrke menja. Nja 60 veta ecëm bashkë. E kalumë qytetin edhe shkumë kah një fshat. Edhe kur na kanë dalë, na kanë nalë aty krejtve. "Hajde tashti, ja keni me qitë pare e dukat ja kena me ju pre krejtve që jeni!" O Zot. I kishin tubue, i vrajshin para neve kuaj e lopë, e çka zatetshin, e qejë e krejt, sa mujshin, para neve aty. U largumë pak, çika këtu plus fëmija n'kolicë. Po qysh ma kapi nja me shami djalin prej kolice edhe e mshteti përpara n'kamë t'veta edhe e qiti përpara, e nxirri thikën prej pantollave edhe ia shtini djalit n'fyt. Edhe po thotë, "Ja pare, dukat, ja fmija shkoi". Thashë, "O a ki Zot, mo se e kam t'hasretit, mas 10 vjetve qet fmi e kam."

Si m'ka pa tu kajtë nji tjetër ma hini kondak t'automatit mrapa shpine. "O kuku aman, veç mos ma prekni qet djalë. Mytnëm mu edhe mytni çikat. Mytëm qysh jom, veç qet djalë mos ma myt."

Kisha nji zingjir, dy unaza n'gisht. U guta, i hjeka shpejt e ja dhash. Ja dhash krejt çka pata. E hjeka me vath e me krejt, "Qe!", thash. Qashtu ja bona, thash, "Kqyr sen ma s'kam. Merrma shpirtin veç ky djalë le t'pshton. Mos ma myt." Na hallakatën me çanta me krejt. Ma Ishunë djalin. Veç si ma Ishunë, ma shtyjti e t'bjen pér asfallti kshtu, i dha n'shpinë zor, e ma rraxoi djalin, e t'ju mushën me hunë, me buzë krejt gjak.

Kta i kanë pasë unifromat... kshtu, ngjyrën e kanë pasë t'verdhë, shumë... ma shumë ka pas ngjyrë t'verdhë edhe qetu njëfarë si ma sari si ma mbylltë. Edhe shamiat e zeza.

Po nuk na Ishojshin, na mbajshin qaty. Tanë ditën aty, o qa s'na thojshin. Turlifar flliqnie. "Tash kena me ja çky na atë senin", tash kena me ju bo kshtu, tash kena me ju bo ashtu. Kesheshin, pishin raki, bojshin hajgare. Na kanë majtë tanë ditën. Diku pak para se m'u terrue na kanë thanë: Hajde me shku... Edhe na kanë qu në qytet na kanë thanë gjani ka ni shpi. E kemi pas një çekë të re me vetii. 17 vjet. S'ka pas femër ma e bukur. Na thanë "Që largohet kjo çika, kena me ju mytë!". Ajo ka flejt me neve atë natë në një shpi që hinëm në qytet. Po ashtu sikur me hi, ku me ditë çka veç hinëm qaty. Ma vonë s'po di çka do me bo. Hynëm aty, nejti ajo aty. Na vishin atë natë, na kanë rue atë natë nonstop. Rrishin n'oborr tu u sillë e nëpër lagje. Çutë tanë, qashtu britmë e piskamë. T'nestrith... Si sonte thanë, "Kqyrne! Qaj numër që jeni me metë këtu. Me bo nja ma shumë apo ma pak, kena me ju mytë tetanë. Na thamë, "Jo, qetu jena na rob't e tonë." Çka me ju bo. E pamë çka po dojnë me i ba çikës së re edhe vendosëm ajo me ikë.

Ata e kishin mbajtë n'mend. E lypën. Na ka nisë gazepi atë ditë.

Prilli nuk o kanë. Kur jena shku aty o kanë fundi i majit. Tri javë ktu, tri javë i bonëm atje.

Ikën krejt, mbeta në atë shpi veç unë me fmijë e me plakën.

Kur erdhën te unë qeta paramilitarët, tha "Hajde, ku janë t'tjerët?". Thashë, "kanë ikë, çka di unë" "Qysh kanë ikë? Tash kena me e pre plakën, e me fmijë e me krejt. Thashë "unë s'jom ardhë me kurrkan. Preni, ma t'premë zbohem na. Ma t'zi s'bohëm ma ktu." Disha serbishten edhe e kom ditë se e kisha nji hallë n'Prizren. Edhe at'herë... noshta që jena kanë n'shkollë. Mësojshim ka nji orë serbisht, si tash anglisht, por serbisht. Thash, "Që e gjani dikan, qe ku m'keni.

Mytemni. So këtu kurrkush. Veç na metëm, boni çka doni, s'kam ku iki, s'kam ku shkoj, kush çka t'munet. Edhe prej atë dite ja kanë nisë këta me ardhë. E thirrshin një n'emër, o kanë njifar si ma plaku, Bozha. Ai o kanë paramilitar me një grup t'vetin. Ai ja nisi po vjen, jo veç te unë por hike shpi për shpi. Ja nisi po vjen çdo ditë. Çdo ditë vijke, n'oborr hike, piskamë e poterë edhe lypke kafe, lypke çaj. "Hajt tash çu me qit pite!", "Çu fljal!". I përbjelsha n'Zot i thojsha. E ky, m'fal n'sprehje, "Ty ta qifsha Zotin. Çfarë Zot? S'ka këtu Zot." O thojsha, "Mo bre se s'kam." Nuk kam, nuk kam. U çue, tani kur vike tani n'shpi, e bike kafën me veti, "Hajde me ma qitë!" Çka me bo? E marrsha qata, as dru, as shporet, as gja, hiç. I gjeta do qira mas shpije. Bindu që jom detyru n'qiri edhe n'flakë me e vlu kafën. M'mytke me krejt. Veç plaka me mu e me fmijë. Lypke pite. Ku me e marrë, ku me gatu ku me e marrë, kah me e marrë. U tutsha prej tyne. Edhe hajt qashtu. Një koijskhe u kanë fort gru e mirë po del një ditë n'gardh e po m'sheh "O kuku me këta fëmijë t'vogël. Po a ki nojsen oj qyqe, a noj sen mbi tokë." Mi pat pru 25 killa miell, e dy litra zejtin, do makarona, do shpageta m'i dha. M'fali ajo.

Tu m'hinë natën e parë, kurrë se harroj. Tanë ditën njifar Boba... se a e din kështu, atij i lexojke sheja. Mu m'interesojke sheja. Aty i lexojke "Milicija". Ushtri e milici, k'si paramilitarë... ushtria e rregullt se kanë prek kurrkan. Kurrë n'jetë kurrkan se kanë prek.

Dej n'atë vakt mirë me ta. Po mas tri nete ja kanë nisë me ardhë. O kanë njifarë Boba. Bobë emrin ai. Ai o kanë milic. Tanë ditën e lume u enke kah shpija ku rrisha unë me plakën e me fëmijë.

I pat thanë plaka, "O loke çka po enesh ti ksajde?", ja boni se dike shqip. "Hallë, unë jam që e vëzhgoj terrenin. Rrini pa marak", ja boni asaj. Se e vëzhgojke terrenin, milic. O qat ditë kur u terru, ka ra terri i takës. Kur erdhën n'derë, katër. Bam, bam, bam. S'kisha as çelës as gja, qashtu me toja tu e mshel derën. Me do baskija. Mi këputën tojat e mrena t'hinën aty. T'ma ka ngjit njani, ja nisi "Srce moja." po ma bon mu. Kuku për mu çka m'gjet. Ajo piskatke plaka. Fëmija. Djali i vogël. Veç dy dhoma i kena pas edhe një si korridor qatë. Nji tavolinë e bukës o kanë aty. Edhe po ma bon mu, "Srce moja.", t'ja nisi jurish prej meje. Ata t'tretë rrishin n'derë e një po hin mrena. Po se ja dishin renin. E tu m'kap mu, tu munu me m'kap përqafe. E kom shty e... tu e hjek atë kondaktin të m'ka shty. M'ka nxanë përpjetë përtëj tavolinës. O Zot, m'çkoqi krejt. Vdiqa prej dhimte. M'nxu mi tavolinë. O munu me m'kap... tu m'kap me gjoks, me dhamë. E munu mu mbrojtë. O refuzo, për besë e kaj. E kajke çika, kajke ajo plaka. Boll u munojsha. Nuk mujta mu shty. Për herën e parë. E kryti atë punë e s'disha ku jam. A po tranona edhe m'hupi vetëdija që m'rrxoj edhe u zuna.

Nuk e di ma natën e parë çka ndodhi. M'u trulllu krytë ma nuk disha ku jam hiç. Nuk e dishim... as s'kishim sahat me kqyrë as nuk e dishim kur janë ndalë, a sa sahati o kanë, veç kur e kom pa veten kur jom çu. Krejt deshë isha kanë, fije përfije. Me dhamë, me ftirë, me fyt me gjoks, me krejt kërsh. Hi drejt, hi te ajo plaka, piskama e saj ish kanë ngat meje. "O kuku për mu çka na gjet!", tha. Ma s'na u ka nda gazepi. Tani vike qaj... do hajt, mas dy nete, apet vishin. T'njëjt. Nëpër terr vishin. Tani, i kisha menstruacionet, m'fal n'sprehje, i kryva... Mas dhunimit i kapërceva shtatë javë. Nuk m'erdhën hiç. Ja nisi po m'vjen tug. Ja nisa, po lodhna, ja nisa me ni erna. Haj mori Zot, kaj, brit e piskat, nuk na u çkoqshin.

Edhe e pashë që jam metë shtatzanë. E llogaritsha e se e disha kur i kisha pas

menstruacionet dhe me fmi që i kom pas, e disha n'shenja t'tyne, e disha. Dhunimi i parë që e kisha prej tyne, u përshtatke krejt n'shatzani. E disha shtatzaninë që e kisha t'tyne.

Shkoj me një shpi në kojshi, aty kërkush që kishin ikë, e gjaj e ta marr një sahan të zojgj e te pi qata. Edhe ja ka nisë me m'ardhë tug prej tina, m'munoj diçka. Mu fry barku mu. Desh kupa prej tina. U fryva, u bona bredh, a po kupi qaty. S'mujsha me e qitë kamën n'tokë. E pashë që s'jam mirë. Edhe e pashë që mu ligën dy kamë edhe veç po du me vdekë qaty n'qatë shpi. Hajt, thash, t'mos shkoj edhe pak, që vdes mos të m'shohin fmija edhe plaka. E jom çu jom shkue. E pashë që so reni hiç. Edhe u liga komplet. Tu shku veç m'shkojke barku qeshtu. U bona qe qekaq. Kur shkova aty, qashtu zhag i kapërceva ato, hi n'kapexhik e hi n'shpi. M'ka pa ajo. Veç m'shkojke barku kështu. Kur ja ka nisë me piskatë plaka, "Çka ke bo oj qyqe! Çka ki kështu?" Sen s'kam.",thashë. "Çka ke bo? A po don me mi lanë tre fmi jetima n'dorë teme qaty. Çka ko me ju bo!" Thash, qeshtu – qeshtu po i kallxoj. Po qysh se ke nata, atë natë të lume desh diqa.

M'rrokën dhimtë tanë natën e gatë. E pina masdite ata, kan n'dy a tre, e hiç, e gja s'ëm gjet, e fryju, e plas e kurgjo...

Tash nata po vjen, britmë e piskamë, s'kisha ku shkoj e çka me bo. Kur u bo pesë, e di pak para se me lind dielli, mu kanë lëshu menstruacionet edhe m'ka plasë gjakderdhja.

Për Zotën ja ka nisë gjakderdhja. Su bo as 20 minuta, copat e mëdhaja që m'kanë dalë.

T'njëtët persona na kanë ardhë ditë e për ditë. Kanë kërkue, na kanë pas pru shpirtin n'fyt. A po do çaj, a po do kafe, a po do...

Dhunë edhe seksuale kena pas nonstop. Nuk kom mujt me pritë... nuk kom mujt me i nalë. Nuk kom mujt se me forcën teme i kom shty boll. Ama na kanë pas qaty qe jena kanë, qata famile qaty që ka pasë dej pesë gjashtë shpi. Na kanë rreh bolli. Na kanë maltretu boll. Jo veç mu po krejt atë lagje. Qashtu gjithë nonstop i kena pasë nëpër kamë. Si ma shkurt, na kanë bo shërbysesë të tyne.

Qeky Bozha me shokët e vet. Me shtagë n'dorë, po m'duket po i shoh, ja çojke fustatnin çikës gjashtë vjet deri qetu, brekët. E rrrojke qikën gjashtë vjeç. Piskatke plaka, "Mo bre mo se fëmi. Po a ki Zot bre!" Keshke, pijke, shkumojke. E veç që lypi, "Hajde tash çu me qitë pite!" Thash, "S'kam, mytëm se s'kam. Vramë!" E rrroj çikën, çika si fmija, sot e atë ditë kurrë n'jetë se harroj... shtagën n'dorë veç ja shtini çikës nërmjet kamve... britmë e saj e piskama e saj, na tu piskatë... Sot çikën e kam me trauma. E ka mbulu gjakderdhja fëminë, sa troha. Ku me e falë tani? A ka Zot? A ka drejtësi? A ka kush n'botë që del me thanë që... e çka do me thanë tash. Ja bre me thanë si mu EULEXI që m'ka thirrë, "A po don me e hjekë deklaratën?". Po qysh e hjeki unë atë deklaratë bre?! Po sot me ma pru Zoti bre. A ka bre Zot? A ka bre njihërë n'jetë, që thojnë që ka, ku n'botë që na del, me i kap e me i njekë, e me i nxanë... O nuk e harroj! N'jetë se harroj se na ka pi gjakun me pamuk. E çka ma. A ka drejtësi n'botë prej nojkujna n'dyje?!"... Çika sot e mban mend, çika jeme gjashtë vjet.

Beso Zotit, shkollë tani masi o kry lufta o hi, kurrë ai fmi mirë so kanë. Gjithë me nervozë, gjithë me traumë.

Burri pak e din, jo krejt. Plaka ka vdekë. Burri qysh m'ka deshtë, nuk m'don qaq. Tash ma ndryshe. Ai se ka ditë a jemi gjallë a dekun dej sa u kry lufta. Unë si kom

kallxu. Se m'vike marre. M'vike rand, m'vike vështirë. Për mrena gjashtë muaj, se kurrë s'na janë hjekë prej derës t'shpisë. Burrin e kuptoj, normal. Ai për shembull edhe si gru edhe si motër edhe si gjithçka, m'ka konsideru... diqysh m'ka avytë ngat e m'ka deshtë shumë. Shumë, tepër ma. Haj Zoti na ruajt. Unë t'kallxova, janë çu tetanë, "Fmi s'munët me gjet, e martoju!". Veç me i'a përmend njerit u tranu krejt. Tepër ma. Eiiiii. Shumë m'ka deshtë, tepër. Tashti jam shumë e ftofne, jashtë mase. Edhe ai, m'fal n'shprehje, kështu për shembull si burrë e gru, bohet nji muaj, qaty jena, bohën pesë, gjashtë javë, marrëdhënie me burrë. Se as nuk muj me i thanë, me ma jep botën, se jam e ftofne shumë, po as ai nuk m'thotë, e as s'ju afrona e as s'mu afrohet. E gjithkun jena t'largunë. T'largunë jena.

Vajza e madhe gjithë m'thotë, "Kuku mami!", veç qeta e thotë, "Kuku mami çka ka bo lufta. A e din bre mami?!" veç kaq edhe manena e ndali. Unë s'kam qejf me e shti me i hi atyne seneve. Ja dal, ja largohna, ja boj diçka te hjeki se ata e përmend gjithë. N'shkollë kur o shku, o hi menjihërë mas lufte. Kurrë ajo si fëmijë nuk ka keshë. Kurrë ajo si fëmî nuk ka kajtë.

06 - HËNA:

UNË DUA TË DËGJOHEM

Libër kujtimi me rrëfimet e grave të mbijetuara
të torturës gjatë luftës së fundit në Kosovë

• KURRË DITË S`KAM PA

Ajo nuk kishte fëmijëri të mirë. Një dashuri e dështuar në rini dhe një martesë në kushte të varfërisë ekstreme, por edhe mungesës së dashurisë nga burri. Nuk kishte arritur ta gëzonte as lindjen e fëmijës që do ta humbiste si foshnje. Sikur përtë mos i mjaftuar këto, ajo ka qenë dy herë viktimë e dhunës seksuale. Një herë gjatë luftës dhe një herë tjetër shumë kohë para se të niste lufta.

N'qat shpi më koritën katër vetë,
me ren. Tani, na rrehën na sakatunë
edhe na pshurrën, çudi more! Edhe
na pshurrën... Teshat tona s'i gjojshim
hiç. Na bonën zi e terr! S'di ma anej
ku me kallxu, po ma i fortë se insani
s'kish kërkush.

Rrëfimi në vetën e parë:

• **HAJ MEDET HAJ** **HËNA**

Fmininë e kena pasë shumë t'shtirë. Edhe baba jem ish konë rritë jetim. Nuk maj n'mend kurgjo t'mirë në fmini.

Shumë m'ka pëlqy me shku n'shkollë. Po nuk na lejke babgjyshi, se na thojke duhet me shku me i rujtë gjatë. Shumë, shumë, gjithë m'ka pëlqye profesioni përmjeke, gjithë kom pas qejf. Haj medet haj, po s'kishim kushte.

M'kujtohet pak diçka qat'here që u rritëm, pak diçka maj n'mend deri në 18 vjet. Qat'here punojshim... Qat kohë ma s'shumti që kishim qef, punojshim punë dore. Vlijshim te dajtë, i kena pasë dajtë n'shehër, n'qytet jonë konë, punojshim. Te dajtë ishin edhe çikat e tezës. I dojsha. Ishim shoqe shumë. Njona tha, "A pe merr qet djalë?", ish kanë i mirë... ish kanë i mirë boll.

Mu më pëlqej po s'guxojsha me thanë se na qitshin faqen e zezë. Ai djali

n'Austri ish kanë. Po thashë une a din çikë e shpisë, masi n'shkollë s'jom, tybe s'ëm merr ky mue. Asaj çikës i thashë, "Tybe ky s'ëm merr mue, veç po mashtrohna e bona gaz". Une e pashë prej s'largti, po at'here s'folëm. At'here s'folshim, kurrë s'e harroj sa t'jom gjallë, kurrë... Ai ish konë i mirë, sjejllja e tijna. Edhe u pamë, a din dajtë e tezet i kishim ngat, kur tha, "Veç me folë".

Po folim tha, "Kysmet po fejohemi, që s'fejohemi pa t'ikë s'kom me lanë", O konë vjeshta qaty para se mi mbush 15 vjet. Erdhëm tani kha n'katun te shpija, ai qashtu... e pajsha kanihere, m'pajke. Hajt do vjet shkuen, i kishim do punë, do skamje, do telashe, hjeka, po apet a pe din nuk e marrke vesh kërkush. Hjeka, boll isha mërzitë për shkollë që na ndërprei po u tutsha, thojsha ka me m'lanë, se e sheh që prej meje s'ka interes kurgjo, thojsha ku me ditë. E lokja e dajve thojke, "N'odë duhet me u rujtë se mos po thotë kush naisen".

Kur vij, kha n'katun, nuk po di une gja hiç po thojnë, "Ni djalë i mirë, duhet me fejue n'katun". Edhe pa ditë gja une hiç, m'fejojnë.

Jo për këtë djalin po për një tjetër. Për ni fjalë goje m'shkoi jeta. M'shkoi jeta poshtë, e ai u bo dhe. Po at'here u kon nrysh, e mytshin njerin. Me nalë robin, u mytë njeri. Vëllaznitë i kisha t'rrijë, ku me i qitë me i mytë. Vllaun e madh e kisha n'shkollë t'mesme. Valla s'po shkoj, po s'di pse s'iksha qat'here. Pse u munojsha, kaj e kaj, mërzitu, s'po shkoj... po shkoj. Do i kom harru do hjeka, do s'harrohen kurrë për jetë.

Për ni fjalë goje.. Kiske nejta nja ni vjet qashtu e fejume, a me shku a mos me shkue. Une atë djalë s'e kisha pa që shkojsha nuse për to.

Ai bajegi ish kanë njeri i sokaqeve. Nanën e kish pasë smutë, babë s'kish pasë edhe dy vllazën. Veç dy soba i ka pasë, fukare sa t'thuesh, po nana thojke, "Veç që osht me burrë t'vetë, e ka burrin n'punë, nuk ia lypë ni trohë bukë kërkujna..."

Kur shkova u çuditshin ata, hina n'atë oborr, ish kanë ajo gruja e smutë, ni gru e mixhës. Oh Zot i madh... me iu përshkru, film, nuk di. I kom pi kokrrat edhe jom shtrëngue. Me ju përshkru film, nuk di qysh. Qysh ish kanë ajo smutë, ajo vjehrra... fukare. E smutë psiçikisht. Dy djemtë e shnoshë prej menje ishin kanë. Por ai nuk ish kanë taman ai djali, burri që m'kanë çue për to. Dy soba i kish pasë, njo ejemja, ni kuzhinë, haj medet po fukare, po keq.

Te shpija, babës e nanës qaty kajsha e u mërzitsha boll. S'ish ai njeri, veç rrijke me gra t'hallkut, s'ish njeri, far majmuni, fukare, bukë me hangër s'kish. Hajt qashtu tu e shty, mas dy vjete meta shtatzanë me ma t'parin fmi. Rrëzohna n'oborr sa jam shtatzane... Ish dëmtue beba, edhe shkoj te mjeku... n'Prishtinë. "Valla s'bon pa u pastrue". E m'pastrojnë, kur m'pastrojnë thojnë.... mas gjashtë mujve mos gjoj mo fmi

Tani menihere e kom gjetë çikën, Ishim fukare, haj medet s'kiske çka han, as s'kish çka pin, u untojsha, u eçtojsha. Hajt Zot çka kom hjekë, me jau la teshat, e ata t'smutë, t'gubaftë, t'flliqtë. M'rrrokën kiske do dhimtë, po s'i kisha unë dhimtë se kisha hi në t'nantin mujë, njo tri ditë a katër.

Edhe te një doktoresha privat n'Prishtinë, po m'kqyrë, kur thotë, "Shko n'spital, ka t'përzimë shkije e do shqiptarë, jonë mjetet krejt se s'guxoj me t'nalë".

Hymë n'spital n'Prishtinë, çka me hi... çka me hi, n'pranim ma s'pari do motra ishin kanë shkina, ni doktor ish kanë shka aty, ni tavolinë që e bijnë me na kqyrë gratë. P'i frynë sytë ai doktori shka, doktoricat shkina, qeshtu na i çkyejshin kaaap {imiton zhurmën e shçyerjes} e na kapshin, na çkyjshin blluzat. Thashë, "Pse s'po folni ju shqip?". Kjo ka ndodhë në vitin '92.

E t'na qesin najllonin me i veshë t'spitalit. E t'na qet ni tavolinë, doktori me na kqyrë. E t'na i prekë barkat, e tu m'nrydhë... a plasa, plasa. E kesh e kesh, e a plasa, plasa.

Kurrë s'e harroj hjetë, na shtinë n'lift. Hypën n'shkallë me kravatë t'bardhë, ish kanë i madh, m'kanë kapë n'lift. Edhe dy motra, po m'i deshin teshat, po m'felliqin deri sa shkumë naltë. Ish kanë i madh me kravatë t'bardhë... Po, m'kanë dhunue. Po n'lift, n'qet liftine spitalit tonë që osht' n'Prishtinë.

Qat'here që jonë kanë shkijet, e kishin pa marrë krejt. Edhe shkojmë na, na hipim naltë, hijmë në ni sobë. Po vijnë njo tre, do tjerë, po vjen ni si milic me automatin e pshtetë, unë isha, ma ka bo, "Çu ti! Çka ki ktu?" Unë at'here vec u qartsha me dhimtë, knej e anej... dhimtë, luj njo, luj njo, me qato dhimtë. Qashtu na kanë koritë, qashtu na kanë rrehë. Pse... e çka, tybe nuk di, vec mos na ngushto Zot. Për lift, edhe na që ishim n'ato sobat, a din që dojshin me i gjetë fëminë. Pritshin me i hekë qaty. Edhe hijmë na, m'koriti, m'felliçi njo, ma dha ineksinë. "Çohu" tha, "atje ku ke". Qashtu m'hipën mu edhe mes dy syve t'mi e din krejt dyjeja. Qai... që u konë me kravatë t'bardhë n'lift, po tani tjerët jonë ardhë renë, njo katër. Ata masanej. Po, edhe ni milic o ardhë me tesha... kështu si aftomat.

M'ka ra t'ligjtë tani edhe jom gjue n'tokë, tani aty edhe prej dhimte, edhe prej tute. Tani ka dhonë Zoti do tjera motra qaty.

M'dhununë mirë, m'kqyrën, m'dhununë, ma dhanë ineksinë, ni gjilponë qitu n'kukë. Ma dhanë qat ineksi, e m'rrokin dhimtë. E gjoj. E një kur ka kajtë çika. Mo kurrë nuk di gja, m'ka ra t'fiktë prej s'lodhni, m'u Ishu gjakderdhja, katër ditë tani m'kanë majtë qejtë e poshtër n'atë sallë. Po s'ëm kanë mytë bile krejt. Tani e di qaty jonë tutë ma s'shumti, kur m'kanë dhonë gjak. Ni doktor o ardhë me mjekërr, i zi, qaty i kom thonë, "Çka po m'ban?", tha: "Gjak, gjak". Edhe qaty m'ka dhonë gjak, kom nejtë nja katër ditë a tri. Qysh po rrjinë sot... që thojnë n'shok dhomë. Ratë, e m'çitshin zall diçka, m'lidhshin, pa hangër, pa pi, vec qaty kom nejtë. Hjeka e tutë, s'di qysh po foli sot e qysh jom.

E kom lindë çikën, mo tani çikën s'e kom pa, kom nejtë qaty, kom nejtë, natën ma kanë pru. Me ni kerr i prujsin bebat. Jo sikur sot që p'i lejshin te kryet, kur i ka gjetë kunata jeme dy djemë t'vocërr, te kryet po ua u lejshin. Tu i ngarku fmitë n'atë far kerrin e madh, e... bum bum (imiton zhurmën v.j.) ma rrëzon çikën. Kështu hopa i merrke dy beba. Marrezoi çikën...

Çika e la gjinin s'thithi nja dy netë që nejta qaty. Ma rrëzoit çikën nér sy, po s'guxojshe me thanë kurgjo. Qaty bile me lajmru dikon, po ishin shkije at'herë, s'kishe ku, s'kishe ku.

Krejt shkije, kun shqiptarë s'kom pa.

Çikën e mora qashtu t'rrëzume, na Ishunë për shpi dikur. Çika, vec krahu iu kish pa nxi. Edhe pak huna e sari. E la gjinin s'un thithi, "O valla çika smutë". "Mirë, mirë shkon i shpi, n'gjendje t'rregullt osht".

Erdha te shpija. Tjetër atmosferë po t'u doke me fmi. Jeta dupllo po t'kushtojke, ndaq t'osht' çikë, ndaq t'osht' djalë. Shumë, shumë, shumë n'kët' dyje ma shumë s'kisha dashtë vec me dekë, mos me jetue mo. Vjen nana me m'pa me vllaun e vogël. Une isha ratë, çika ish e lodhët nuk thithke hiç. Qashtu t'u hjekë, po hiçke fmia i vogël. U gjëzu nana, tonë u gjëzu, "Ama te laj çikën". Erdh edhe ni gru e kojshive kishe me m'pa, "Ça po ta merr menja bre? E lodhët koka çika. Po loçka jeme, ishalla je shnoshë vetë, këta jonë t'rijë, se kogja e

lodhët koka çika". Edhe unë kujtojsha që p'i men, s'dijsha vallahin. Kur po thotë nana, "Po çka ka oj nanë çika e zezë n'krah kështu?" thashë, "Oj nanë qështu po osht vallahin, veç zaher që e rrëzunë, po i men. Po, po i men". N'dorë e pata, hiçke, hiçke me dekë... m'diq. Erdh nana me m'pa. Paj njeti n'këtë dyje, kurrë se ka harrue as nana. Kurrë nuk e kom pa t'u keshë. Qaty e ka fitu sheqerin. E dille o kanë ajo ditë që o hie n'dhe, kurrë s'e harroj ftyrën e çikës...

Qysh more asi gjinë ishin konë pa men, mjekë. Unë ato kurrë s'e harroj, as s'ka pasë ligj as shtet. Kurrë, kurrë se ashtu s'u duftë me ia bo kërkuj. Po ata vijshin edhe nëpër shpija na rrehshin, na kputshin.

Burri tybe... burri tha, mas gjashtë dite, tha, "Hajde n'sobë". Met pa duhan kur m'coi n'sobë, m'deshi, çka me pa trupin, tha, "Çka je bo kështu? Kush t'ka hongër me dhomë kështu?".

Vallahi i kallxova, do-do se krejt mozallah kush guxon. "Kush t'ka hongër n'dhomë? Pse kështu?" Veç masanej m'rrehke. Burri, edhe kurrë mo s'ma dajti dajakin. Po s'kom guxue me kallxu.

Nuk guxojsa, me i kallxu krejt çka ka ndodh. Thojsa po m'lëshon. I thash "Na rrehën, qaty do gra, na deshën teshat e veç na rrehën".

Na kanë rrehë. Se që na kanë koritë t'u gjetë fëmi, tybe n'guxofta, veç që na kanë rrehë. Pasha Zotin s'guxojsa, nashti u konë ma mirë me i kallxu, po jo. Ai u konë njeri i poshtër, s'ke guxu. Përveç na kanë rrehë vallahi, se s'guxofta, thashë a din m'lëshon. Po... haj medet haj. Po ai m'rrehke masanena, s'ma dajke kurrë. "Pse diç çika?" "Çikën e rrëzunë" "Ku ke ti?" "Une kesh qaty, na prunën me na dhonë çikën n'krevet, se une n'kamë s'jom konë, tybe n'te kom rrëzu unë". Edhe hajt, hajt qashtu, pasha Zotin deri qaty mo erdhën prej shpije krejt çka patën. Mas tre vjete ika prej tij, jom dalë, thashë, "Unë mo s'guxoj me shku te ky".

Pesë vjet t'zeza ditë n'ditë. Thashë unë mo nuk guxoj me nejtë se le uni që po des se s'po kem, po marova prej t'rrehnit t'tij.

Kjo me çikën më ka ndodh qaty 92-tën. Mas tre vjete ika prej atij burri.

Tani nana e baba m'lypshin mem martu diku tjetër. Po fëmi t'vogël thojsa s'muj me i kqyrë. Ma gjojnë apet qit vend, burrin kujam tash.

Kur um lypi ky burri, me msit, thojnë nihere "I ka veç tre fëmi", kur vij, i gjoj gjashtë fëmi. Ky u kanë i ri, i zoti, p'i pëlqejet këtij burrit. Une e re jom konë. Ky ish konë i vjetër, do fëmi, namin e zi.

Ika pas nja 50 vjet, Une 27.

Mirë isha me këtë burrin. Ky as nuk ish konë i udhve t'kqija, as qen as kurgjo hiç. Dhomët m'u prishën, m'u nxinë, m'i hujdisi do dhomë, do tani m'u thynë n'lufte kur na rrehën, që na gjuen. M'i hujdisi dhomtë edhe m'veshi. U bana shumë mirë po a din, e pafat.

Vjehrrën e kom pasë, edhe fëmitë e burrit. Djali i burrit, njoni ish konë n'Gjermoni, njoni aty. Ia morrën inat burrit pse më kqyrke edhe u kujdeske përmu.

Po me burrin shumë mirë. Ky s'ëm bërtitke, nxehtë e kisha, me hangër bukë e m'blejti tresha, s'ëm bërtitke. Edhe mire, i çela sytë. U ktheva, u hujdisa, s'ëm njofke kërkush. Kur u dhezë lufta!

E t'u dhezë tani lufta. E dalim tani prej shpije, mo me 24 kur i ra NATO-ja n'mars, a me të 28-tin, qeshtu po m'doket, po m'përzihet. Dulëm prej shpije. Kurrë mo ditën tem s'e pashë. Mora teposhtëze. E kena pasë ble at'here ni kerr

t'mirë. E burrin... shkijet ku ia pajshin atë kerr, u konë nifar FIJAT tip, shumë i mirë. E marrin e rrehin nihere burrin, e ia marrin kerrin e një thojke, "Merre", një thojke, "Hajde zovatëm prej punktit" ku u konë "dej te komuna". Edhe e rrehin, e sakatojnë veç apet ia kishin dhonë kerrin, po s'kish çka i vyen kerri, po nom, nom bani ma mirë diçka.

Kur shkumë me ni katun desh na mytën me granata. U shtremë n'atë far shpije, krejt.

Mandej shkumë në një katun ngat. Rrishim me një fushë. Rrijshim me ren n'kerr, veç kena nirthëtë deri qaty.

Krejt tani jashtë kena nejtë. Ni kolibë dikush e bijke me do dru, o çka kena hjekë, çka kemi nirthëtë qaty. Tonë robtë qaty flejshim.

Shkojmë me ni katun tjetër e bujmë në ni pleme te sana. Del ni grue, zoja e shpisë e thotë, "Vallahi s'kena ven ku me ju shti, sfyngjera kem" na i dha do qebe, në ni pleme me sanë. E na dha do bukë, "Bre vllaznia e mi, s'kom ku me ju shti, bukë po ju dhojmë". Akshami, vijshin granatat, kuku nanë o nanë. U ba... qat'here ia nisëm e murrëm te poshtëzen ka pak, ka pak, hajt, hajt, ecëm.

E thojnë, "Mule, hipni n'traktor". Qato igball e kena pasë, në ni traktor jena hipë. Fëmia e vogël, nusja, burri ka ecë n'kamë. Aty dulëm, u dhezë lufta, një bile e vranë qaty menihere, ish kanë ushtar, i veshun. Ato e gjunjë me snajperkë e vraqnjë. E hajt, hajt gjithë ditën na, e gjithë natën tu ecë. Hypëm tani te ni traktor, herë zhdrypshim se nuk ngrihshin ata far traktora, kur erdhëm tani n'sabah drejt n'qytet. O qaty pak pa hi do i dajtën qaty, po hijmë ma heret n'gjashtë.

E hijmë n'qytet. Aty e pamë një shpi prej ku ishin dalë nejrëzit, e hyjmë mrena. Qat natë bujtëm, hajt e hamë do bukë. Akshami tani kur erdh, para akshamit jon konë edhe nihere kqyrën do si tesha t'zeza ishin kanë, tybe si ushtri. "Sajeni, ku jeni?" qashtu, shkuen. Eh mirë, shkuen, u krye, na kujtoftëm që shkuen. Kur tani po vijnë apet mas njizet minutave. E t'na kapin, une jom kanë te sodoperi tu e la ni tavë.

E t'i dajnë burrin e do djemë t'rijë, kështu do soba a din, do far shpijash e t'i marrin t'i ngujojnë. Po s'dita, kiske e mytën burrin. E t'i kishin rrehë, e kanë marrë dukat, e marrin pare. Rrehë, mytë, ata fëmia e vogël, brit e brit tu u çmendë. E na kapin qeshtu për dore. Qaty me burra, ata tu i shkelë, tu i shkelë tetonë tu i pucavë. E t'na kapin na çuen aty me ni shpi ma larg. Ish kanë ni shpi e madhe kah dy-tre kat. Ni i shkretë sahati nihere ec e eci deri n'dy t'natës.

N'atë sobë, ish kanë ni çikë e re. Si i ka çepu nihere shkelëm, e ka gjue. Ki pasë gjak, ki pasë flokë t'ngrehta, ki pasë gra, ishin kanë t'myta si flejtun rrijshin përmys, nuk livritën kurrë. Çkamos ki pasë, tesha t'grave, a brekë a gjak a kreveta që kena pa. Tre kat ish kanë, do u dirgjshin, tu u rrehë, tu qitë tesha, flokë, sene... çka t'kujtohesh n'atë shpi që kena pa, deri n'sabah. N'sabah perenia, na kanë deshë e na rrehën, na qitën n'korridor.

N'qat shpi më koritën katër vetë, me ren. Tani, na rrehën na sakatunë edhe na pshurrën, çudi more! Edhe na pshurrën... Teshat tonë s'li gjojshim hiç. S'mujshe ti me gjetë aty teshë tane. Na rrehën, na sosën e na pshurrën. Na bonën zi e terr! S'di ma anej ku me kallxu, po ma i fortë se insani s'kish kërkush. Qaty valla jem lodhë, veç s'di qysh jem ardhë. Na rrehën mirë, na mytën, na sakatunë. Nja dy veta kenë qaty, nuk di qysh jem ikë. Do duqa i kom veshë, edhe jena dalë. Nuk kish pasë shkije n'qat far vakti kah n'shtatë që jena dalë prej asaj shpije. Kur

erdhëm këtu ku kem, burri i rrehtë, veç gjak.

E vijmë aty t'rrehta, t' llomita, vijke tu m'u ajë ftyra, qitu hala m'dhem ftyra sot. E ni dhom ma thyen, se a din kur na rrehshin, na gjujshin. E dora, qikjo, qysh um ka pritë, veç qitu, m'u ajë qikjo. E qito ma shtrënguen, tybe nuk di ma zi. Veç s'di qysh jom sot, qysh po rrnoj sot. Edhe na rrehën e na shajtën, e na pshurrën, ma s'mrami, çka ni t'zezë na banë. Kur erdha, hina aty, burrin u gëzova qaty e pashë, bujtëm edhe qat natë n'Prishtinë. Deri n'sabah bujtëm, tu keshë burri, "Aje gjallë?", thashë, "Po, po, gjallë jam". Ajo kunata për kunat na bojke, "Po ti s'vyn gja mo, që e kanë marrë shkijet" keshke ojo u ngryske. I thojke qaty do grave çà ishin. Kunata, kunata u thojke grave. Rijmë qaty na edhe qat natë, bujmë. T'nesërmit po vijmë, po thojnë me ec.

Mo u kry ajo. U kthymë në katun tonin. Burri u nda n'qytet. U ardhë n'kamë... Na gjithë ditën udhtumë, erdhëm deri n'aksham prej 12-ve deri n'aksham jena ardhë prej qyteti.

Trupi m'shkojke krejt rekë, e smutë, e lodhtë, e rrehtë, komtë s'um majshin... haj medet haj, e mërzitë, e tutë. I pajshim shkijet që erdhën. Rrugës na nalën e te rrehin shoferin. E t'ia marrin paret dej edhe sahatin e dorës. E te rrehin e t'ia shtijnë krytë ktu përlastik a e din përmas që ishin me t'mbluet ata llastikat. E i qitën bajagi do plaka kështu përpara ja nisën ata keshin, do ushtarë t'ri ishin kanë, e do t'zi ishin konë me shirita n'dorë n'qat ven qaty.

Edhe thojshin, "Shih qysh i kanë qitë plakat knena. Qitni këto plaka n'tokë". E ti zhdrypin plakat n'tokë, për ni dorë i kapshin. E t'na zhdrypin krejtve t'na rrehin qaty mirë. Qaty na rrehën, na plaçkitën, çka patëm do sene, do cikrrime, na bastisën. E kom pasë ni unazë.

Na i murren një dy unaza, ni zingjir e pata n'xhep n'ostar t'palltës. Po s'na rajke n'menë për ato, veç çà me bo veç me pshtu. Po, po veç me pshtu, diçka murën. Plakat i kanë qitë knena prej dere renë. E tani nom na dha Zoti... e thanë, "Ecni!" E rrehën atë shoferin me neve. Një dy-tri orë qaty t'rrehtë e t'pérplastë metëm. Neve na lanë. Erdh nji tjetër traktor, i hallakatshin edhe ata, i kontrollojshin. Na erdhëm, hypëm n'traktor erdhëm diqysh. Eh, nuk na kanë lonë me hi n'shpija tona qysh jena konë të lodhët. Shkojmë me ni katun tjeter, bujmë n'oborr t'shkollës. E shkumë e gjetëm një shpi ku ishin ikë njerëzit, që i kishin kthye.

Hijmë na aty n'atë shpinë, dhezim zjermin e bojmë diçka. Pak valla, miell, se s'kish pasë kurgjo, as tmarumë, as sodë për bukë. E dha Zoti erdhën ata të zotët e shpisë. Edhe Bajramin e pritëm qaty... Jonë konë 100 refugjatë. E kanë pre ni dash, e na e bon kishe Bajramin.

Burri s'disha hiç ku osht, me djalë t'madh ish, me re, as kunati, ishin nda. Ata rrehë, këputë i kishin pasë nguju në nifar si shpellë. Edhe rrimë na. E vijshin ushtria asajde, "Sa vetëjini, kush jini?"

Kur dha Zoti kanë bombardue qaty e i kanë çu do tenka, menihere. Qaty nom pshtumë, edhe mirë.

U kthym nëpër shpija. Gjak, tesha t'grave. A kishin pre, a kishin koritë a, a kishin bo, ni Zot e din. Plot valla qiso t'zeza që s'kanë skej valla me vjet, edhe u kthyem qashtu qysh u kthyem, une e smutë, me hajt, hajt, hajt... Mas ni muj dite, mas një tri javë dite shkova tanë n'spital se mu nalën a din... tanë teshat (menstruaciont v.j.). U bonë një dy muj. Haj medet haj, u bonë gati tre.

U kryen, u kryen bombardimet, hini NATO-ja. U kthyem te shpija, haj medet,

haj. Isha smutë fort. Kiske po thojnë me shku te mjeku. E vi n'Prishtinë...hi kha. M'nalin n'spital, n'gjinekologji, n'patologji në nifar veni. Po m'thojnë...une isha smutë. Këta mjeket po m'thojnë që... n'Prishtinë... shtatzanë nuk je. E thashë mirë masi shtatzanë s'jam metë, so gajle, gjithë ai dhunim që ma bonën, shtatzanë s'jam. Mirë, i marrë do ilaçe thashë tash m'men, po s'ëm mejke hiç. Psiçikisht, fizikisht e lindhne, dhimtë, tugu... tugu, dhimtë haj medet, tu u kujtue, s'mujsha me i largue hiç. E moj, a diça, diça...

Mo s'di as mu gjëzu, e nëjetë nuk gjohna kurrë une.

Vallahi gjithë i kujtoj. Pasha Zotin shpesh boll. Po vallahi si para sa vjete që u konë lufta, sikur sot po m'doket. Veç a din tash i pi kokrrat me rregull. Trajtohem. Se kam tuten qe s'kam ilaçe. Tutën nuk e kom.

Burri kanihere më nimon kanihere jo. Po i shkoj nerva. Gjithë ditën po shan e po bërtet, po thotë, "Qysh m'rë mu ky fat i zi kështu? E ku qëlloi gruaja jeme, pse veç na ashtu e pse s'shkojshum jashtë? Vyti kur shkoi OSBE-ja me shku edhe na e..." Turli t'zezë valla, turli hijekë, pi vjen edhe inati. Veç me m'bo gaz, qajo kunatë m'bani, ma qiti faqen e zezë nëpër sebepe. E u duftë me rrehë, po badihava, e rreha e sosa po kurgjo. Hupi mo kontrolla. E qashtu motra jeme t'zitë e territ, jo valla mo kurrë mirë s'jom konë.

Po tutem se punën tonë moti s'pe ban llaf kërkush, pej që shkoi Atifetja. Edhe po tutem masi s'kena kallxue, po bohëm horë, s'po na paguhet kurgjo. Kajhere qata na jem tu u tutë, veç televizorin e kqyrim, e ngojmë, droj po bohem horë. Pasha Zotin nuk di, këta ushtria po shkojnë hyxhym ministries p'l bojne yrysh. Ashtu keq po bojnë që pi thejnë venin tonë veç, nashta ishalla diçka del se drejt s'kena kallxu, jena bo gaz krejt. Shumë kadal.

Shumë i kisha porositë që të punojnë mirë e ti respektojnë ligjet, rregullat, se nuk osht lojë veç puna jonë, veç puna e femrave nuk osh' çkado se pa kon femrat në rregull me i maru rininë, fminë e shnoshë. Kosova s'ka çka na vyen neve. S'ka çka na vyen neve Kosova. Kush ka bo punë deri qitu për neve Zoti e rujtë e i nimoftë e gjëzoftë kit popull, krejt mjekët e Kosovës kah jonë udhëheqësia, punëtorët, fémitë, shkollat Zot.

07 - LOLA:

UNË DUA TË DËGJOHEM
Libër kujtimi me rrëfimet e grave të mbijetuara
të torturës gjatë luftës së fundit në Kosovë

• LUFTA I PRISHI KREJT

Ajo kishte jetë të lumtur. Ishte martuar me dashuri. Kishin dhe një vajzë. Gjithçka ishte perfekte deri në ditën kur hynë ata. Atë ditë do t'ia vrissnin burrin dhe vajzën e vogël. Do të përjetonte dhunën seksuale, po jo vetëm atë...

“E vrajtën burrin. Tani t'u e gju burrin e vrajtën edhe çikën. Mu m'murrën m'ngrehën zhag për flokësh... M'ngrehën, m'morën dhe m'çunë n'stacion t'policisë. Edhe aty ka fillu njifar çmendurie e tyne... mas katër orëve më lëshunë.”

Rrëfimi në vetën e parë:
• **UNË, NANA, MOTRA, KUNATA....**
LOLA

Na kemi qenë shumë fëmijë. Edhe jemi prej një familjes t'shkollume. Jemi tanë t'shkollumë. Meqenëse lufta na ka lanë pak si mbrapa, na ka hupë edhe dijen edhe shkollën, veç apet mirë jena. Na n'fëmijëri kemi pasë kushte të mira se babën e kena pas punëtor. I kena pas kushtet e mira, kena pas shkollën e mirë, kena pas prindërit e mirë, na kanë kuptu edhe meqenëse jemi kanë kallaballék. Kur i kom bo 18 vjet, m'ka ofru martesë nji mashkull. E kom njoftë edhe përpara, jemi kanë n'shkollë bashkë. Jemi kanë n'shkollën fillore bashkë edhe hajt shoq mas shoqit i kanë thanë vllaut, “Lolën dojna me e feju, Lolën e jujë!” Edhe qysh o kanë zakoni ktyneherë me msit edhe pse jemi kanë t'shkollumë, me msit. Tani u martova.

Gjashtë muaj kemi nejtë t'fejumë, menjihere jemi martu. Edhe kemi pasë nji jetë shumë t'mirë, shumë t'bukure kemi pasë.

Kemi pasë dasmorë shumë edhe i kemi pasë afër shpijat. Sa shkojshim te dasmja, sa vishim prej kanagjegjit.

Tani mas tre muajve qashtu, mbeta shatëzanë. U gjëzunë krejt. Edhe me kalimin e kohës qeshtu, linda vajzë. Çfarë gjëzimi u bo se ata s'kishin pasë asnji

fëmi nji kohë t'gjatë. Çfarë gëzimi, çfarë dreke...

Ti merre me mend, n'atë kohë me tupan m'kanë ardhë te spitali, u gëzunë krejt familja. Si kah ana jonë, si kah ana e burrit. U gëzunë, por ra lufta, na prishi gëzimin, na prishi jetën. M'i prishi krejt gjanat që i kom pasë n'jetë. Ma murrë ma t'dashtun që e pata, ma murrë çikën që e dashta... M'i murrë tanat.

Jemi kanë n'shipi t'u hangër darkë. S'kemi ditë gja veç kur thanë, "Hinën te kojshia policia. Hinën po i marrin tre qëjanë t'shkollumë".

S'kemi ditë gja veç kur janë hi te na. E vajtëni burrin. Tani t'u e gju burrin e vajtëni edhe çikën. Mu m'murrën m'ngrehën zhag pér flokësh... I kom pas flokët e gjata at'here. M'ngrehën, m'morën dhe m'çunë n'stacion t'policisë.

Edhe aty ka fillu njifar çmendurie e tyne. Edhe mas nji kohe tani, u çumë, mas katër orëve më lëshunë. Edhe ika, po tash kah me ja majtë, kah me shku. A e ki pa njerin si te nana që e gjanë mirë kërkun se gjan. Edhe fillova, ma, shkova te nana. Kur shkova krejt bijat ishin kanë aty. Tha, "Çka u bo? Çka je ti kështu e stresume?" Une njihërë nuk dojsha me kallxu çka u bo. Tha, "Çka krisi mori n'mahallën e juaj aty", qeshtu. Thashë, "Hiç kurrgjo!" N'atë moment m'ka ra t'ligët. U çu vllavi e ma hjeqi t'ligët. Une tu ju kallxu kadale, kadale, kadale (psherëtinë). E s'kemi ditë gja veç kur janë ardhë këtu te vllavi. Janë hi aty te vllavi, e na kanë marrë me bija. Nanën e kanë rrehë. Nanën para syve i kanë bo ç'mos para syve t'vllavit, para syve t'tonë. Na thojshin, "Lutko moja" [Kukulla ime] "Kena me ia bo edhe juve qeshtu" n'serbisht. Na kanë ngarku n'kamion edhe na kanë çu tani... na kanë bajtë, herë anej e herë knej. Me kunatë, me halla, me teze, me çka jemi kanë aty, na kanë qitë n'kamion. Edhe na kanë çue... n'njifar vendi...

Na kanë marrë tani na kanë ngarku n'kamion. Kishin pasë aty nji shkollë, nji vend, ajo u duke m'u kanë si shkollë, por si stacion i policisë. Herë i thojshin kështu e herë ashtu. Kur na kanë marrë me rend. S'di sa veta jena kanë, si sot mu kujtohet, nji kallaballëk gra. Kur na kanë marrë me rend, tap, e tap, e tap... rend. Kush nuk dojke, e merrshin thikën e iu vërsulshin me thikë. Krejt trupin e kam thika, krejt trupin ma që s'mujsha me i përballu kurrgjafit. Kur menojsa çka kanë bo n'shipi e çka kanë bo n'stacion t'policisë, e kur i pajsha motrat, e kunatën, e tezen, e çikat e villaznive, o thojsha, "Kanë me na mytë, ma mirë vajëmni se që po na bani qito". Aty, njani hike e tjetri dilke, njani hike e tjetri dilke... qeshtu. Edhe na kanë ngarku n'kamion, na kanë lidhë kambë e durë qashtu t'përgjakta, se krejt trupi gjak m'ka çelë. Hike ai, hike si i çmendur. Krejt, njani Jovan, i thojke tjetrit Jovan, e tjetrit Jovan...

Krejt me qat emër t'njëjtë. Kur jemi dalë prej atyshit, na kanë lidhë kambë edhe durë, na kanë qitë n'kamion, ka dy veta na kanë shti. Se na s'patëm ma takatë. Jena kanë pas ra në 70 killa.

Edhe na kanë hypë n'kamion me na çu pér Zveçan. I thojnë njani tjetrit po thotë, "Kah? Kah?", po thotë, "Pér Zveçan!" Edhe une veç kom qayrë qeshtu, e kom pa nji shishe. Qitshin ujë, qitshin raki, edhe mo tash s'di çka jonë kanë do far shprica... tash une po di çka jon kanë ato... Po at'here nuk kemi ditë.

Po, po thotë, "Po ju dhajmë me ju forcu se jeni pa hangër, pa pi" na kurrë hiç, hiç, hiç. Veç do ujë që na jepshin. Edhe kur e kishin bo atë punën e vet, na qitshin ujë n'gojë që na bike t'ligët t'u na maltretu. Edhe p'e nij, p'i thotë, tha, "N'qet kamion qekaq veta", "N'qet kamion qekaq veta". Kur kta na i qitën para meje, une n'fund. Une isha n'fund me motër, me kunatë, me dy çikat e tezës edhe

kisha nji shishe qaty. Shishe gastare, e rakisë ish kanë. Thashë, "Qysh me ia bo me e thy qit shishe?" Tha, "Shuj mos e rrokat, se po na bojnë apet qysh na kanë bo ma herët!". Thashë, "A e din qysh kom me rrakat, kur t'ja nisë kamioni me ecë, ata s'e dijnë çka po bohet përmas. Unë ko me e thy qit shishel!" Edhe i kom mshu me kambë. Mshoji me kambë, mshoji me kambë, mshoji me kambë, dikur zaher kur do Zoti me t'nihmu, njifar stami ata nxunën, unë i mshova shishës shumë edhe e çava shishën. E kom kapë kadale, kadale me kambë, kom afro te dora edha ia kom bo vetit ving, e ving, e ving... qe këtu ku i kam t'preme duart. Ving, e ving, e ving... shenjat e duarve... ia preva vetit duart. E ia preva vetit duart. E t'ia prejta tanave duart, kambët. Kambët e mijë i harrova! Kambët e mijë i harrova, thashë, "Kceni o gra!" "Jo s'guxojna, na shohin" Thashë, "A po doni me kcy e para? Mu m'vrafshin me automat, e nëse nuk më vrasin, ju tani kceni mas meje". Une kom kcy prej kamionit n'tokë edhe kom kqyrë a po kcejnë tjerat. Ja kom bo motrës edhe kunatës. Kanë kcy nja 100 metra larg, ajo 10 metra ajo... Edhe jom shku zhag. I kom kqyrë ku janë, i lypsha ku janë. Deri kush e din ku jom shku t'u i lypë tjerat, a ka ma tjera.

Kur thash, "Hajde palohem qaty te kqyrim çka po bohet!" Ishim në njifar katuni, s'di qysh i thojshin atij katuni, rrugës për Zveçan. Kur po nalem, qaty ishin kanë do vorre. Edhe shih po nalëm qaty te vorret, "Ishalla more Zot, Zot na ndihmoftë." S'kemi ditë gja veç kur o ardhë nji magjup me kerr me kali. Edhe thashë, "A bon...?" "Çka u bo kështu me juve? Çka keni kështu?" Thash, "Na ka gjuitë NATO." Tha, "jo, NATO hala s'ia ka nisë me gjuitë." Thashë, "Erdhën NATO, na kanë çu na kanë pru qekah na kanë lanë". Kur ka marrë magjupi, "Hajdeni këtul!", tha, "Çka je ti?" "Unë turqelike", i folsha tani ktyne turqisht, a din, mos me e marrë vesh ai kush jena. Edhe kur kena ra na qytetit tonë jena çkep tani kush kah ka mujtë se e kena pasë nji postbllok aty, edhe jena mshefë.

Jena shku drejt te shpija zhag. Kur jom shku ma se kom ditë vetën ku jam, hiç, hiç, hiç. A e ki pa, kur lodhet njeri, e tani kur ç'lodhësh, tani t'rrokin ato simptomet. Veç kure kom pa vetën n'neuropsikiatri.

Edhe e kom pa veten qaty edhe ma s'kom ditë gja as për vlla as për motër, as për kanë mbi këtë tokë.

Kena hjekë, kena hjekë, boll kena hjekë, tash hala me neve s'u bo kurrgjo. Jo ky po thotë kështu, jo ai tjetri po thotë kështu, jo ai tjetri po thotë ashtu... Po ishalla more Zot tash e mas po bohet mirë. Une e kom thanë qysh n'kohën e UNMIK-ut kur o kanë, për këto gra edhe këto nana, meqenësejeta jem ka maru... Fëmi jo, kurrgjojo, kom fol edhe përfëmijë të tyne, kom folë edhe përburrat e tyne, kom folë edhe përmotrat e tyne edhe përkrejt. Kom thanë, "Ishalla more Zot vjen nji ditë e mirë për neve". Por nihere, dy herë, s'ka kurrgjo.

Edhe presidentja na ka ndihmu, na ka rehabilitu. Boll që kur e pajshim ata, kishim mbledhje ose nji diçka, kur e pajshim ata që na mbështet m'u duke që, a din se shpirti i çikës, shpirti burrit pushon. Thojsha, "More Zot qysh dul dikush me na mbështet neve".

A e din qì n'fillim une vet, n'fillim kur jom dalë i kom kallxu dy – tri vetave qeshtu, qeshtu. Ma bojshin me gisht, "Kqyre kjo". Tash krejt na kanë mbështetë. Krejt tu na mbështetë. Kom unë edhe hala-hala sene t'tjera por tash m'kaloi edhe epilepsia. E s'muj me i qitë krejt, krejt, krejt nuk muj se s'un shkoj te shpija. Epilepsia, kambët, duart, n'tana anët. E tash po m'dukët që ma mirë jena, po na përkrahin. Na e kena marrë vetën pak a shumë, se nuk po shkojkejeta gjithë

tu kajtë.

Motra me vdiq prej mërzie. Edhe ajo njëjtë si unë. Do vjet mas lufte vdiq. Kur i kanë bo mjekët operacion kanë thanë "çka kena gjetë na n'bark t'sajna, n'mitër t'sajna, menja s'ta... Çka s'kish pasë. E s'guxojshin me kallxu edhe me thanë qeshtu qeshtu shkijet ja kanë bo, se at'herë s'bojke me folë. Por, "s'pe dina prej çkafit, s'e dina prej çkafit!"... E ka lanë çikën, 12 vjet tash i ka bo çika. Lu ka rritë çika duarve t'huja. E qetash ishalla more Zot shteti jonë p'i çelë sytë e po bon për këto gra diçka se jena lodhë ma.

Mas lufte, mas dy vjete mas lufte, po i bjen qashtu 2002, 2003, qashtu mos t'gabofsha se tash me data s'jom fort, veç dy vjet mas luftës, ja nisi barku, e barku po dhemb e, e dhemb. As n'tokë as n'qjell, "O çka u bo me mu, o çka u bo me mu?" E m'çon vllavi te mjeku. Kur m'çon tha, "jo kjo koka katastrofë n'mitër. Po kjo paska mish t'egërl!" Tha, "E qysh?" Tha, "Ja osht me barrë t'verame ja i ka ndodh diçka katastrofë". Po ata s'e dishin fort se çka m'ka ndodhë mu. Kur jom hi e kom bo operacion, pasna pasë tumor mrena n'mitër edhe do far miomash po i thojshin atyne. Edhe kur m'kanë bo operacion, mas 24 orëve kur m'ka dalë kllapa, e ke ardhë doktori para meje. E ka marrë nji fletë letër, e po m'vetë mu, "Ku je kanë?" "Çka u bo? Qysh...?" Haaj mozomakeq qysh m'i kallxu ktina.

"Ti ki pas dhunë katastrofë diçka tu kanë bo ato sene. A t'ka bo vaktia që je kanë shtatzane e je vra?" "O doktor leji këto sene se s'po du me t'kallxu çka ka ndodh. Se me t'kallxu unë ty, ti çohesh e i kallxon atij tjetrit, atij tjetrit, atij tjetrit". Më njofti doktori, ma njofti burrin edhe tha po ma merr mendja çka paska ndodh.

Jena lodhë mos vet, se qe 17 vjet a 18 vjet p'i bojna. Ti merre me mend, nuk e kom ditë as datën as ditën. Kur m'vetke dikush datëlindjen.

Edhe nja, m'kanë marrë m'kanë qitë, masi që ma kanë vra burrin, m'kanë qitë në njifar karrike elektrike. Ma kanë hupë krejt memorjen që e kom pasë, kujtesën, shkollën, shkrimin, leximin. Unë deri qetash vonë s'kom ditë me e dhanë nji nënshkrim. "Qysh nuk e din ti? A e din kush je kanë ti?"

Katër orë n'polici. Njifar karrige, ma lidhën barkun. Thojke, "Gjaje ku asht Adem Demaçıl!" "Po çka kam t'boj une me Adem Demaçin, çka kam t'baj une me..." Thojke, "A e din që ka UÇK diku?" Thojsha, "Une s'e di, qet emër prej juve e mësova" Edhe përnime nuk e kom ditë, seriozisht. Na n'qytet që jemi kanë s'jemi marrë ... edhe s'kemi guxu na me folë diçka. Se e kom pasë burrin e shkollumë, vetë e shkollume, s'mujshim na me u mirrë me këto. Jo thojke UÇK, jo filani jo ku. Po thojke, "Kush osht Mziu?" Thojsha, "Kush osht more Mziu (zmija srbi.)?" edhe mziu serbisht, gjarpni. Edhe këtu n'fyt, ka naltë, "Hajde kallxo kush o ky, kush o ai". Une s'e dijsha asnji emër nuk e kom ditë, seriozisht, se kush janë, por qetash pe di. Domethanë krejt për Thaçin, Adem Demaçin mu m'maltretojshin. Se vllaznit une i kom pasë t'vogël. Ata s'e kanë ditë as çka osht kjo e as çka osht ajo. Sot vuajnë për mu thojnë, "Kuku çka ka hjekë". A e dini se për pesë-gjashtë muaj une s'e kom ditë as e kujt jam. Kur m'ka pyet dikush n'neuropsikiatri, "E kujna je?", "E kahit je?", s'e kom ditë. Shtatë muaj ka zgjatë qekjo. Doktorët ma kanë pru vetëdijën tu m'folë, tu m'dhanë terapi. Unë kom pasë terapia t'forta se krejt e drogume, krejt jom kanë, n'durë, n'tana anët. Bile tash qysh m'thojke doktori, "Isha kanë e ç'pume edhe n'lukth me shprica", sipas fjalëve t'tyne. Po unë presidentës edhe Ferides kurrë nuk ia harroj. Ma kanë gjetë vendin e punës, ma kanë gjetë bile me u shkollu, me dalë, me ikë, me

ardhë.

Antarët e familjës sot kanë dhimtë për mu, sot kanë dhimtë për mue. E dinë cka me ka ndodhë. Jo veç antarët e familjës, por edhe kojshia, rrathi, mu m'respektojnë, mu n'nerojnë. Nuk e kanë ditë bash fell, fell qysh o kanë, por për shkak t'burrit që ma kanë vra burrin edhe çikën, edhe sot e atë ditë unë jom metë pa fëmi, e jom metë pa kërkani hiç, ata m'mbështetin. Ata nuk e kanë ditë për shembull n'biografinë teme çka ka ndodhë, qysh o kanë, çka o kanë. Tek qetash m'kanë pa anej e knej, tek qetash po thojnë, "Ti e ki edhe nji histori t'msheatë". Po këta, a din qysh, na deri t'jemi ardhë qetu s'kemi guxu me folë kërkun. Po këtu na kanë thanë se jesin mshefta, nuk t'përmendin, nuk asishne edhe e kemi pasë besimin edhe na kanë dhanë besimin edhe jemi shprehë. Kemi marrë terapi, e kemi bo neja, kemi keshë, kemi folë.

A e dini që unë kur jom ardhë këtu, m'u dukshin qatalisa qatje që janë ushtarë. I thojsha kunatës, "O Zot hekëm prej ktushit dej t'hiqën ushtarët!" "Jo mori ushtarë, çka jë t'u thanë? Policë, jo!" Thojsha, "Qeta policë" "Jooo!"

A besoni që t'u i kqyrë ia ngjitsha edhe kapelën, ashtu i fokusojsha. Isha t'u dalë me këto shoqet. "S'po dal prej ktyshit me ata" "Pse?" Thojsha, "Kqyri ku janë ata." Lisat m'u dukshin që janë ata. Kemi dalë, i kemi prekë, "Qe kurgjo, lis osht ky". Përnjihërë tanë m'ka rrokë ajo kriza, ajo mërzija, ajo nervoza. Çohna natën e veç sillna nëpër sobë. Më se shumti m'rrokë ditëlindjen kur e ka çika... (qan). E lypi nëpër sobë...

Këta të shpisë ia nisin me m'fol. Më thonë që nuk jam as e mrama as e para. Kujtoje atë nanën n'Gjakovë, kujtoje nanën gjakovare që sa i ka pasë e o metë vetun. Ti te qajo duhesh me i çu mend që, a po e sheh edhe ajo mend osht. Po ti duhesh me dalë, e me shku, e me ardhë e kënaqu me to, ti kënaqu me neve. Na jena nji familje, hala nuk e kena lëshu qysh jena kanë përpara. Për shembull vllavì jem kurrë djalin e vetë se qet n'prehëni pa ardhë te une.

Një ditë pi thotë vllau nanës. "Du me e nda grunë!" Tha, "Jo, jo! E çka po kallxon se çka t'kanë bo n'burg t'Sfërkovnicës ty? E çka na ki kallxu ti neve? Kur je ardh a e din qysh je kanë përmbrapa? Prej zorrës t'trashë që t'kanë dhunu shkijet?", vllavit tem i tha nana.

"Edhe ktyne, edhe këto me zor."

Tha vllau "Nuk po muj ma nanë mu përbajtë kur po m'bjen n'men se ma ka pasë shkavi gruan. Unë nuk po muj me e përballu".

"Djali jem, duhet me e përballu! Kqyri motrat edhe grunë. E me ta kallxu edhe nji punë!" Tha, "Çka?" Tha, "S'ta kallxoj kurrë përjetë".

At'herë vëllau e kuptoi që edhe nana u kanë e dhunume. Edhe u çu, ia nisi po kanë e na kapi tanave n'grykë. E tha nana, "nuk bon! Qysh t'u kish dukë ty me ta lanë motrën burri".

Tani burri i kësaj motrës tjetër e la motrën mas do kohe. Katër fëmi, e sot e asaj dite so kërkun (qan).

Çka na kanë bo ata neve edhe ishalla Zoti ia u kthen atyne. Edhe, para do dite hypa n'autobus me shku me një qytet tjetër.

Edhe pe shoh nji serbe, u ungjë aty, e kish veshë uniformën e policisë t'Kosovës. Edhe thashë, "O more Zot, ama Zot forcën e mos te boj qetu hallakamë". Tu ra shahadet, e tu ra shahadet, ma hjeki Zoti, e ma kujtoj. Thashë, "Kqyre kjo, na kanë pre, na kanë gri. Çikat tonë jesin me shkollë, pa punë, pa kurrgjo." Ajo folke sa mujke serbisht. Mu ka sjellë njihere n'mend. Nji gru e ka hetu, "Zojë a po t'vjen

munim a?" Thashë, "Po valla!" "A t'i thom shoferit ta çelë dritaren?" "Jo!", thashë, "Thuj shoferit, nale krejt", se thashë mo s'po muj pa folë kështu ma mirë po zhdrypi. Qe zhdrypa menjihere por m'diktoi ajo që diçka pata unë. E qeshtu, u nal ajo gru me mu, që sot me e pa, nuk e njoh, ajo tjetra që tha "Ta çeli dritaren se s'je mirë".

U nal me mu, "Hajde hypim n'tjetrin e shkojna dyjat bashkë se ti nuk je mirë. A je bo operacion a çka ki?" Thashë, "Po, nuk jam mirë" "More a je shtatëzane?" Thashë, "Qashtu diçka", se si e frytë pak. Tha, "Jo valla ko me nejt me ty se... Çka pate allahile çka pate?" Thashë, "Kurgjo!" Tha, "Vallahi pate, qajo gruja që folke serbisht, qajo policja, ty t'verajti diçka" "Eh mori bijë me t'kallxu diçka" Tha, "Çka?" Thashë, "Guhën e tyne hiç sun po bohna me ta" Tha, "Pse?" Thashë, "Ma kanë vra burrin e çikën para syve, ma kurrë n'jetë s'ia u fali, kurrë. Veç ku t'jom kom me kallxu e kom me folë e kom me ju thanë edhe tjera grave çunu e folni për veti se çka na kanë bo ata neve". Po edhe çudi e madhe është që mas sa vjetve asnjë mos me u nxanë.

Edhe menjiherë mas lufte, menjiherë, n'kohën e UNMIK-ut m'kapi çka, çka, qysh, i kom kallxu kështu-kështu krejt i kom kallxu, krejt, jo veç për veti por për tetanat çka ju ka ndodhë. Deri vonë, a din, se tash m'u kanë hupë edhe ftyrat se gjinja kanë ndryshu. Jon kanë ma t'reja e tash t'moshume. E tash veç kur po m'lajmrohen vetë kështu shoq mas shoqi. E qeshtu...

Me gratë tjera që na ka ndodh bashkë shpesh e diskutojna. Edhe kur e diskutojmë, e hjekim fëminë prej atyshit, mos me e marrë vesh fëmija. Qeshtu, qeshtu.

Dhjetë herë kom tentu me e mytë vetën. A e din qysh i kallxojke Zoti nanës?! Vijke, "A je këtu?" "Po!" "Ma herët ku ke, a ke te bunari?" Dhjetë herë jom munu me ra n'bunar, por Zoti i ka kallxu nanës tem. "Mos ke ti te bunari ma herët?" "Jo!". A shkojsha te bunari me ra, thojsja se çka mu m'vynjeta me jetu. Kur e nisha zanin e nanës u kthejsha, "O çka s'je ti" U çu vllavi, e msheli atë bunar. Dilsha natën e kajsha të bunari. Pikshin lotët atje poshtë. Thojsja po e laj bunarin me lotë e neser kom me ardhë m'u gjuitë n'bunar. Po zani i nanës m'nalke.

Tani ia nisën me m'kontrollu. S'di sa m'kanë lidhë mos m'u çu natën, mos me dalë natën. Une veç u çojsha, e kqyrsha vetën, "Kush m'ka lidhë!..."

E tash po m'dhimën, çikat e motrës e t'vllaznive. Kur e shoh gjeneratën e çikës. Tash e t'ish kanë, kish nejtë me mue kish... Po çka me bo. Nji gru ma bojke, "Zoti ka thanë qashtu" Thashë, "Nuk ka thanë Zoti po shkavi ka thanë. Se Zoti ma ka falë me jetu me ta, e shkavi ma ka marrë"... Apetjeta po dufke mu vazhdu qeshtu.

Duhet krejt me dalë me folë me e ngritë zanin për vetëveten. Qysh na qe 16 vjet tu ju thanë, "Dilni folni, dilni folni, për jetën e jujë, për senin që ja kanë bo! Pse me ua lanë atyne".

08 - MERITA:

UNË DUA TË DËGJOHEM

Libër kujtimi me rrëfimet e grave të mbijetuara
të torturës gjatë luftës së fundit në Kosovë

• NUK MË MORI NË GJERMANI

Asaj i ishte ndërprerë ëndrra e shkollimit. Me t'u martuar do ta kupotnte se njeriu me të cilin do ta kalonte jetën ishte alkoolist. Ai do të ikte pastaj në Gjermani përtat lënë të vetme me pesë fëmijët në varfëri të skajshme. Kjo grua ka ecur nga fshati në fshat. Nga familja në familje. Ka përjetuar dhunën seksuale dhe ka parë fëmijët teksa qanin duke kërkuar normalitet.

“... m'kanë shti n'ahër, e ia kanë nisë... M'kanë thanë, “Dishu”. Serbisht. Po serbishten e marr vesh. E lutsha sa mujsha serbisht e shqip. Se çka kom... e qysh kom folë, nuk di se... “Hajde, dishu, dishu!” Kurrë n'jetë s'e harroj atë moment. Kurrë n'jetë s'ëm heket prej menve.”

Rrëfimi në vetën e parë:
• **MU FIKSU AHURI ME LOPËN EDHE VIÇIN MERITA**

S'di, s'kujtoj diçka shumë t'mirë prej fëmijërisë... Andrra jeme... u ndërpre hala pa fillu. Dy motra i kam t'diplomume para meje që kanë qenë. Une n'kohën kur unë kom dashtë me e vazhdu shkollën, at'herë osht prishë situata te na, shkojshin nëpër shpija private kështu që une u detyrova patjetër me e ndërpre shkollën edhe pse shkolla ka qenë gjithë andrra jeme për me rrri diçka. Sot, çka t'ëm m'bjen n'dorë, a gazetë, a libër, pa e shfletu pak s'po muj me nejt. Jom martu n'moshë shumë t're, 18 vjeçare. E kryta shkollën, sikur at'herë.

Nana jeme, "S'ki çka me prit çika jeme. N'shkollë s'je, ma mirë merre nji burrë. Vazhdo jetën. Zoti i ka lanë për t'gjitha edhe ti." E kështu u martova. U takova, dolëm mu njoftu. S'kemi kalu shumë, se s'kom zgjedh vetë.

Qysh fillon nji jetë n'martesë o kanë ferr për mu. Dita e parë e martesës, burri jem alkoolist. Edhe sot osht. Rrisha me shpresë që po përmirësohet. Veç vike n'orë t'vona, vike i dehun, na shkaktojke probleme mu, prindëve t'vetë, familjës t'vet... krejt ish... me kurrrkan s'bojke, me kurrrkan s'kish raporte t'mira. Edhe n'fillim deshta me lanë. Thashë t'nalna e t'rri n'shpi se e pashë se s'ka me ta. Po nana, "Hajt nashta si t'lind naj fëmi përmirësohet, afrohet, se sosht i familjës t'keqe, sosht i keq." edhe vazhdova. Lindi fëmija i parë... Mas nji vjete. Nji vjet e nji muaj. N'gusht i kom bo nji vjet që jom martu. Djali, fëmija i parë. N'fillim pak e pashë që o gëzue, mu doqt që po afrohet ngat neve, po përmirësohet, porjo.

Me dy pleq, vjehrra e vjehrra pa punë, kunata pa punë, nji kunat punojke mësues, po a me e majt famlijen e vet a me m'majt mu? Le ti djali... Qaty ka nihmu n'fillim. Ma katastrofë jeta për mu. S'kisha me çka me ushqy, prej mërzisë, prej maltretimeve s'kisha as gjii. Djali kajke tanë natën. S'kish çka me hangër. E u detyrova mas tre muajve që lindi djali, u nala prap.

U ktheva te familja jem. Thash se s'muj ma me shku se s'ka. S'muj me jetu. S'shihsha kurrëfarë ardhmërie. Thjesht u bllokova, nuk... veç u kujtojsha, veç kajsha. Qysh kesh, shumë shpejt ndryshoijeta jeme. Shumë mirë kesh vajzë e qetë, familje t'mirë, aty shumë zhurëm. Katastrofë. Edhe u nala, tri javë nejta.

Erdh baba me m'marrë. U gëzova shumë kur e pashë. Tu kajtë unë dola, "Hë? Çka kë?". Thashë, "Valla babë. Për çka je ardhë?" Tha jom ardhë me t'pa edhe me t'marrë se ko me shku përrrugë.", se punojke baba jem e shkojke n'Beograd, larg. Edhe tha, "Dej t'kthena une pata qef me t'marrë. Po kena qef djalin.", që lindi djali e e dojshin djalin shumë. Edhe vjehrra jeme e shkreta e dike, a din, e dike ma që e ka tepru ajo. "Hajt bre çika jeme, qe unë pi laj, mos i ço queshtu." "Qe queshtu ko mi çu." Edhe unë u koçita, i shtina n'kese, me babën tem n'kerr edhe n'shpi. Tani udhës bisedojskim me babën, thashë, "S'muj ma bab! S'po di ma. S'po kam kurrëfarë zgjedhje, kurrëfarë shprese aty s'kam. Ti vetë e pe situatën. Burri s'vjen ka nji javë, as s'di ku asht. S'di çka i jep djalit." Tha, "Ani çika jeme, nalu. Leje krejt. Çka ki mi bo. Leje krejt."

Ata të burrit me qunë fjalë që djalin s'ta lojna. Gjithë ditën e kalojsha diqysh e natën, tanë natën qirin me lot e lajsha. Ku me e lanë, zhurëm, kush e kqyr?! Ma shumë mu dhimke ai se vetja.

Mu duke që sa herë po m'kqyrë po m'lutet. S'muj me ja kthy shpinën. Tri javë nejta te baba (qan). At'herë erdh kunati i madh. Ka vdekë. Ka qenë shumë njeri i mirë, ka qenë njeri i shkollumë, njeri i kuptueshëm. Si prind e kom dashtë. Hala sot mërzitna që ka vdek ai. Edhe tha, "Hajde bre se e di që ta ka tepru n'tana mënyrat. Po mos e le djalin se gjynah. Kena mu mundu. Ti po e din që po i flas boll. Boll po m'vjen keq prej teje por çka me i bo". Me dëshimtarë e kështu me do nipa edhe shkova. Qatë ditë që shkova, apet ia nisi qashtu, hajd e hajd. Apet jeta veç ma e vështirë e kurrgjo tjetër.

Ai veç tu shku tu u bo ma agresiv, pike nonstop. Boll u munojsha me e kuptu edhe me i fol kanjihere. I thojsja, "Kqyre djalin!" "Çka s'po t'pëlqen te une e te ti?" "Kurrgjo." Thjesht, ai m'kish marrë veç për shërbtore. Me e ditë dikush që asht i martumë, me i figuru une si gru edhe qaq.

Tani mas djalit, mas nji vjet e gjysë, meta prap shtatëzanë. Deshta me shku me

hek fëminë. Masi shkova atje, shkova te "Nanë Tereza" pa pare. Shkova me e hjekë apet nji grue, "Qysh bre motra jeme po e hjek. Pse po e hjek? Djalin e paske. Qe une sa vjet kontrollona s'kam fëmi. Qysh me e hjek fëminë? A e din që je e re, ki mu pendu ma vonë." Qajo fjalë ma mushi menjën edhe une u ktheva. Thash, "Shnosh, le t'del ku del..."

Atij si interesojke absolut as çka po ndodh as hiç. Vike vonë, vike flejke i pitë, dalke, vjellke n'sobë. U dufke mu çu me e fshi. Shkojke n'mëngjes herët, shpejt e shpejt dalke, tu mushke menja ku me ditë çka pe han këtu, çka pe pengon n'shipi. Une qashtu rrisha tu u përballë me fëmi, me punë t'shpisë, me... katastrofë. Edhe ma masi lindi fëmija i dytë, vendosa ma, le t'ndodh çka t'ndodh, ko mu bo kurban i qetyne fëmive. Ma mrapa s'ka. M'lindi fëmija i tretë, i katërt, i pesti edhe ma veç çka shkojke tu u vështirsujeta jeme. Ai veq tu u bo tepër agresiv. Masi na lindi fëmija i tretë, e dajtën me nji dhomë. Odë ka qenë. Na ndajtën mu me fëminë me shpresë që ky ka me punue. Kur te sheh që s'ka kush e bjen edhe ky ka me punu. Atë e gjajshin nji mënyrë me e stimulu këta me punu. Prind'it e vllaznia. Familjën e ka shumë t'mirë. Njerëz t'shkollumë. Veç t'kofsh n'familje i veçantë përt'keq. Edhe u mundojshin këta n'çdo mënyrë me e stimulu me punu.

Edhe na ndajtën. Kur na ndajtën me nji dhomë, ujë mrena jo, me koritë pastrojshim. Katastrofë.

Pa banjo. Pa, hiç, hiç... Shpesh ndodhke, rashëm n'mramje pa bukë. U çojshim, gjithë natën s'ëm merrke gjumi. Thojsja, "Çkaju boj n'mëngjes!" Hiç, hiç. Me bo mu anku, "T'pëlqeftë qetu mirë, mos t'pëlqeftë leni fëmitë, shko!" Kujna me ia lanë fëmitë? "Lene unë i kqyri." Thash, "Pse s'po i kqyr qetashti? Çka me u largu unë prej fëmive?" Thjesht, prej momentit që unë jom martu, as s'ka dashtë bashkëpunim me mu. Sot 30 vjet gati martesë i kam, hala kurorë s'kam.

Thojsje "Po shkoj n'Gjermani, po vnoj kurorë. Indreqi letrat e vi t'marr." Tani unë shpresë, e re, menojsa që përnime çka po thotë edhe po ndodh. Thjesht, s'ndodhi kurrrë kurrgjë.

Fëmijtë janë rritë qeshtu nëpër zhurëm, nëpër... O Zot kurrrë s'kemi flejt t'qetë. N'qat ditë që ai u vonoje, që u bojke ora pesë – gjashtë e nuk vike, na e dishim që ky ka shku me pi. Kur vike na prishke gjumin, na qitke jashtë. Kajshin fëmija. Vishin kojshia...

Fëmijëve menxi që ja sigurojsha librat. Po gjithmonë ju kom fol edhe ju kom tregu që une e kom pasë andërr edhe kom qef me ndihmën tem ju me u shkollu. Edhe falë zotit veç fëmija s'ëm kanë zhgënji n'jetë. Janë shkollu, janë shumë fëmi t'mirë, janë shumë t'edukumë që krejt na i kanë lakmi.

Me 24 mars. Na u gjëzumë, mendumë që o bo mirë. Erdhën NATO e kanë me e ndal luftët e me bo mirë, e veç filloj luftë edhe ma e madhe. E kemi pas një postbllok të policisë ngat. Aty çdo natë që kanë gjuitë. Çdo natë. S'kemi mujtë me flejt prej tyne. Asnjë moment. Çdo moment, veshë kemi flejt, veshë jemi çu. Veç thojsim se kur po na mysin sot, kur po na mysin nesër. Burri u kanë n'Gjermani edhe tha që ka me m'marrë, "Po t'marr. Ndreqi dokumentat!" Po ku mujsha, s'mujsha me i ndreq dokumentat se s'jom kanë as kurorë, as s'kom pasë letërnjoftim as t'vajzërisë as kurrgjo hiç, absolut.

Edhe n'prill, fillunë me e largu fshatin krejt. E pamë që po largohën, hajde dulëm edhe na. Unë hypa n'traktor t'nji kojshisë. Tani edhe vjehrrën e murrëm. Qysh n'moment ai me dalë edhe s'ka ma, ma s'kishim... ushqimin, gjithë kush

pak ushqim me marrë me veti për shkak t'fmine t'paketume gjithë. Qato që i kishim i morrëm. Shkumë. U nalëm me një fshat te do t'njofshëm.

O kan prill kur ja nisën, e kishin pasë djeg një fshat afër e kishin masakru. Kishin mytë njerëz. U duke veç tymi. Përafërsisht e di që kah po vjen, po se çka po ndodh se ka ditë kurrkush. Veç Zoti e ka ditë çka o tu ndodh.

Edhe, i thashë atij kunatit, i çova fjalë sa u enshim, "hajde çom veç dej te baba", "e bohna bashkë. Noshta m'o fron dikush ose e marr dikan e dal me tren, shkoj."

Se dalshin me tren, treni i madh, krejt njerëzit. Tha, "Ani po vi me ty." Ai e kish marrë një njeri me kali me kerr edhe na murratje.

Ai njeri na çoj deri në hymje te qytetit. Aty na la se tha nuk guxoj ma anej. Edhe na, menjë janë, që jo me kamë s'na nal kurrkush edhe po dojna me shku trup. Kur kanë nga ushtarët. Kanë qenë t'vesht me uniforma, na kanë thanë "Stoj" serbisht edhe jemi nalë qaty. Ata janë nalë prej s'lartgji, 200 metra po, tu nga. Edhe na jemi nalë qaty ku jena nalë edhe na lypën letërnjoftimin. As une letërnjoftim e as kunati. Edhe na majtën pak qaty, fëmija kajshin e u tutshin, nxehëtë, katastrofë. O ishim ecju për ujë, a s'kishim ujë as... Edhe thanë, "Nisu!" Na shajke, "Shkon i N'shipni"... "Aty n'Shqipni. Këtu Sérbi" Po edhe kunatin e kish pas ni njani kish thanë, "Qite qatje mos t'na bohet qekut gjak." Mos i myt qekut. Unë se kom ni qat fjalë. Fëmija ecshin edhe ecshim na. Veç na rrugëve. Kurrikush. At'herë s'ka pasë lëvizje. Veç shkijet çka u enshin se n'asfallt s'ka pasë kurrëfar lëvizje tjetërkun.

Tu ec po e shohim një lokal pak ma larg plot shkije. Me hini menjë që e vrajnë kunatin e më dhunojnë mu edhe i thash që hajde hijmë në mal se jemi tu shku ne goj të ukit.

Aty asht një hapsinë kogja si e madhe me mal. Lisa ka. Kemi ec nëpër qat mal edhe e kemi zatet një njeri të mirë serb. Aq mirë na ka pritë. Ka nga e e ka kap çikën, unë e kisha djalin e vogël n'grykë. Ai e ka kap çikën edhe më tha thuju fëmive mos me u tut. Edhe një harrova me e cek, një moment që se harroj kurrë n'jet teme që m'ka dhimtë zemra. Tu ec kemi kalu kah një shkollë, e u gëzunë fëmija, ja nisën tu na lutë me hy mrena. Thojsin nashta ka fëmijë këtu.

M'ka djeg zemra. I kish marrë malli për shkollë. I kish marrë malli me shku në shkollë normal. Kurrë se harroj. Sa herë ta kaloj atë shkollë, sytë me lot mu mushen.

Edhe na ka ndihmu ai serbi shumë. Ftyrë pozitive. Qaq fjalë t'mirë foli që m'duket na largoi atë frikën. Edhe na ka përcjell, çikën n'grykë edhe nëpër fshat. Nëpër fshat tu knu shkijet. Dej te fëmija kishin pasë veshë kësi jeleka t'ushtirisë, a armë. A more që u bojshin si t'qartun. Kur ka ardhë një njeri që me sulmu kunatin tem, t'kanë bërtitë fëmija e mi, t'kanë bërtitë tanë. Ai njeri e la, qaj ushtari na përcjelli. Ky që na përcjellke i bërtiti "Largohu! Une i kam këta n'dorë." Edhe aty kur kemi hi n'fshat, një shkinë, një plakë. Ja lypëm do ujë. Edhe kemi mbri te baba jem.

E shkunëm e pashë nanën, vllaun, u gëzova. Kish pas bukë. Ju dha fëmijve, u kënaqën tu hangër. Edhe hangrën, pitën. Kur erdh një kusher i jemi tha që plani o me flejt në shpi të atina ma mrena katuni se shpija e babës tem nuk ishim t'sigurt.

Po sma njike çka po bajnë. Kur i pashë babën, nanën e vllaun mu duk që dyjaja jeme.

Edhe jemi shku atë natë. Kemi bujtë qashtu t'nestrif, deri t'dillën. T'dillën o kanë

i 18-ti. Erdhën nji komandnat i policisë serbe. Edhe e thirri një kusherit tonin i thotë fleni në shpija se nuk ju nguc kush.

Edhe baba tha, "Hajde po shkojna se qeshtu na thanë." Tani tu gëzumë, o gëzimi jem. Thojsa se flejt n'shpi t'babës se kallabllak, e u ngushtojsa, e thojsa une ju bona barrë me pesë fëmi. Bujtëm atë natë... nejse veshë flejshim na gjithë. Kurrë s'jemi deshë. Kena flejt gjithë me jakne, me. Sa herë prilli e marsi, herë majke ftuft e herë shi. Edhe para mëngjesit kur po i nina krismat. Fëmija flejshin e une çutë n'dhomë t'gjumit se s'flejsha gati tanë natën pi tutës. Kur po hin nana jeme, tha, "Çika jeme, merri fëmitë se ja kanë nisë me i kallë shpijat. Krejt mahalla dolëm më një fushë u grumbullumë. Erdhën e ja nisën mi nda meshkujt. Me gisht ua bajke. Nji kusherit që e mytën atë ditë, ai e pat djalin n'dorë. E njiherë, masi u çu, u ul apet me djalë. E ti bërtiti, "A thash une mu çu?" U çu apet e i kqyri fëmitë. O kur e kanë marrë vllaun tem... O Zot i gëzumë. Edhe babën tem e kishin pasë marrë hala pa u ulë aty, pa shku. Po na se kemi pa. Babën se pasha unë. Kur e kanë marrë vllaun, veç na kqyrke... uh Zot i gëzumë. N'atë moment e kqyrsha nanën, e kqyrsha vllaun, m'kallke zemra për krejt. Ai veç kqyrke e i kqyrke fëminë. E mu duke që dojke me m'thanë diçka me sy... E kqyrsha nanën, ma djegke zemrën nana. Kurrë nji pikë lotë se ka qitë, veç o pi, veç kqyrke. Thanë, "Ju nisnul!" "Ku pi çoni kta?" Thanë "I kthejna apet. Hajde jul!" Na shajtën. Flakë shkojshin shpijat, u kallshin, kërsima... edhe u nisëm na me shku. Kur u nisëm me shku, thamë, "O i lëshunë burrat!" E tu gëzova, u gëzova. Se i pashë do burra që i murrën, po 40 vjet e te poshtë i kishin majtë. Babën se pajsha ma. Edhe nja nji orë me thanë, a gjysë ore, nuk e di edhe na kthynën apet n'fshat. Kur u kthynëm, "Hajde po ju kthejna apet". Erdhëm. Une jom kanë me nji traktor qaty t'kojshive. Kur u kthynëm, çka me pa. Tu kajtë gjinja sa mujshin se e kishin marrë vesh çka ka ndodh. I kanë çu n'shpi t'nji kusherinit tem n'oborr e qaty katër veta i kishin pasë masakru. Po e shoh babën tem. Kajke qa se kom pa njeri n'jetë teme tu kajtë. Thash, "Babe, ka o vllaun?" "Jo çika jeme, vllaun ta kanë mytë..." "Kuku qyqe, çka po flet o bac?" "Po çika jem." Fëmija e mi veç kajshin si fëmi. Thojsa "Jo mamit, se se kanë mytë dajën. Rrini qektu ngat Nanës" Thash, "Mos u largoni!" se u tutsha po mu shmangën, se me tu shmang nji fëmi ma se gjajshe. Veç çu, "hajde dilni ma", e secili veç qysh t'mujshe me ik. Thash, "Mos gaboni mu largul!" Gjithmonë janë kanë fëmi të ndëgjueshëm. Çkaju kam thanë, gjithmonë m'kanë ngu. Qatu ku i lajsha si zogj rrishin.

U nisa për të shpia ku thoshin që i ka mytë. Ka dalë një kushëri po më thotë ku po shkon, i thash me e pa vllaun, më tha jo bre bac nuk ka ktu. Vet i pshtolla keto xhenaze. Vllaun yt nuk asht.

U ktheva të fëmija, kur kanë ardhë prapë shkijet... Kuku. O si t'qartun. O Zot i gëzum bre, çfarë tmerri. E na kanë rretheku krejtve.

Edhe na thanë me ec. "Asnjo ktu, kjo o Serbi" na shajke sa mujke... Edhe po nisem, na çunë deri te pazari. Kur jem hi që u sistemojshim nëpër traktora, e thanë, "A ka këtu burra?" Ma s'pari kur jena nisë. Thash, "Jo" se dijsha serbisht, "Ne, video samo u žene". Na merrshin dukata e çka kishum, ni grusë t'kojshive ia kishin pasë shky veshin t'u ia marrë dukatin, vathet.

Edhe masi mrrinëm atje na thanë hajde apet me u kthy. Edhe erdhëm apet n'fshat tonin. Flakë krejt u kallshin. Krejt flakë, n'tana anët i kishin qitë kerret n'udhe, ia u kishin shti flakën. U ndava me familjen teme. Baba me la te një

familje rome, kojshi. Më kanë pritë qysh asht ma s'miri. Kurr nuk ua harroj. Ua kam lanë amanet edhe fëmijëve që herë do kur asaj familje me i dalë hakesh. Erdh një kushëri edhe me tha nëse mujmë me shku me këtë gruen e asaj shpisë ku nejsha me i mjel lopët edhe më ju qu tamël atje në mal ku ishin civilia se nuk kanë pas çka me hangër.

S'kom flejtë gjithë natën, qaty m'u fiksu n'kry lopa me viçin, une e disha ku osht ahri i ktyne kushërive. Se na marrshim tamël edhe te ata. Zahere e kisha pasë taksirat, edhe m'ngrehke ai ven. Gjithë natën, lopa e viçi që bërtitën, se viçi ish met mrena e lopa jashtë. A lopa jashtë, e mrena viçi nuk e di, veç njana. Nuk muj me ditë tash sigurt, po me siguri viçi u kanë lidhë mrena, e lopën e kanë qitë me hangër diçka, po ma merr menjë mu. Edhe, gjithë natën, m'u doke që po ia u çeli ahrin lopës e pe boj bashkë me viç, e u qetësojsha. Qashtu m'u qetësu shpirti pak, m'a çojke andërr Zoti ato që u bonë bashkë lopa me viçin. Edhe kur u bo sabah, une i vesha kulet e asaj grusë, shallin e asaj grusë edhe me menim që si ta vnoj shallin, kta s'e dijnë që jam shqiptare... Edhe morra me shku. Ajo gruja e shpisë i shtini bukët edhe tha po vi me ty.

"Po shkojna p'i mjelim lopët, e tan i pjekum bukët edhe ia çojna tanëve t'nxeha e bukët. Diçka bile, qysh mujna me i afru". Edhe u nisëm me shku, une lopë s'kom mjelë përpara se s'kom ditë.

"Une po hi, p'i mjeli, ti shko mledhi do vo kah pulat" më tha. Unë i lashë votë, e kom kapërcy sokakun me shku me bo lopën bashkë me viçin se m'u fiksu n'kry, se m'bërtitke sa mujke. Edhe t'nesërmit, edhe hiç... edhe e kom kapërcy. Ajo shumë u mat, veç ballë për ballë. Veç e kapërceva sokakun, edhe thash t'ia çeli ahrin, t'ia çeli kapigjikin. Khu kur e kom çelë kapigjikin, çka me pa, dy veta. T'kanë ardhë n'drejtim temin, o tybejstikfar, o Zot, o Zot, o Zot, ka m'ndodhi thash. Kur hina, kur t'kanë nga n'drejtim temin, e t'ëm kanë kapë, oh tybejstifika, as s'dijsa hiç, hiç meta e pitë. E m'kanë kapë m'kanë çu n'ahër. Njani e di që ka pasë uniformë... Njeri ma t'frikshëm, njeri ma t'flliçtë, njeri ma t'keq, veç ku... S'ka pasë njeri ma t'keq se ai, s'ka pasë njeri me erë ma t'flliçtë se ai. I vijke era alkohol, i vijke era njersë... njeri i tmerrshëm. S'po di qysh me pershkru, qysh... Pak i plotë, i zi, i papastër. Ky tjetri u kanë, e kom ni tu i folë rusisht, 90 përqind ma merr menjë që u kanë rus. U kanë i bardhë, i plotë, edhe ai flokët çel. Edhe m'kanë shti n'ahër, e ia kanë nisë... M'kanë thanë, "Dishu". Serbisht. Po serbishten e marr vesh, se kom msu serbisht. E lutsha sa mujsha serbisht e shqip. Se çka kom... e qysh kom folë, nuk di se... "Hojde, dishu, dishu!" Oh Allah i gjëzumë n'jetë teme, qe 17 vjet po bahan, për 18. Kurrë n'jetë s'e harroj atë moment. Kurrë n'jetë s'ëm heket prej menve. S'kom moment që s'e kujtoj. Gjithçka çka e shoh keq, e barazoj me qat personin e keq.

Edhe nejse ka fillu me m'dhunu e i ka thonë atij, "Thirre edhe atë tjetrin e dishu", a din. Edhe, ky m'ka dhunu knej e përmbrapa... Jom gërditë, kom vjellë edhe i kom largu. M'kanë mshu, ia kanë nisë me m'rrehë. Mo s'kom ditë, m'kish pasë ra t'fiktë, çka ka ndodhë me mu nuk e di. Kur jom çu, i kom pa apet ata dy njerëz, edhe nafaka jem që me pshtu, i thirri dikush. 90 përqind u kanë radiolidhje si toki-volki që u kanë. Edhe i ka thirrë dikush edhe i thojke diçka, "Brzo, brzo" atyne. Tha, "Çu ti", m'ka mshu shkelëm, hala m'dhem ktu, gjithmonë ana e majtë shumë m'dhem. Shumë e kom vend, pikë t'dobët e kom n'trup. M'ka mshu kaq shumë se çizme ka pasë. Se jonë kanë t'forta. Edhe qaq ma kanë mshu, sa mu veshë edhe me ardhë. Thashë, "A me shku une?" Tha, "Jo, jo, çfarë

t'shkumi ti, me neve ki me ardhë". Oh kuku, oh kuku kur ka thanë, "Ti me neve", Oh Allah kom thanë nihere, ti e din pse erdha une ktu. Erdha për me bashku viçin e lopën. Oh Allah, mos m'ndaj prej fëmive.

Thashë, une e gjallë jo, e dektë, ma mirë bile t'ëm mytin t'u ikë, pse me m'mytë kadal-kadale.

E u vesha se m'thanë, "Vishu" edhe e vesha, e qita shallën e krejt. Une thashë, "Po une kom fëmi, a din, kom me shku i kom pesë fëmi" tha, "Hajt se edhe me neve gjon fëmi, ti a nuk e pave, sa t'dushë fëmi". Edhe t'kom qitë e t'kom bo, osht nifar sokaku noshta t'bjen najhere, osht diqysh thom, edhe Allahi e ka lonë atë kthesë ato, si sokak i ngushtë si... Se ahri aty te dera e mshefet e do stuba janë ma... super përmi. Veç kom bo njo-dy e thashë, nashtë ma mirë le t'ëm mysin, po bile mo n'dorë t'tyne edhe nihere mos t'përjetoj çka përjetova. Ai ka thanë, "Stoji si" unë kom ikë, edhe e kom kqyrë nihere a po m'vijnë përmas. Ai rusi ish kanë tu e largu armën edhe tu i thanë ec. Zhiko e thirrke këta. Këtë emër e mbaj mend.

Edhe kur kom dalë atje, kom nga shpejt e shpejt. Nuk e di, veç s'besoj që ka zgjatë ma shumë se ni orë. Mu m'u ka dukë si me shekuj. Një orë ndodhi dhunimi.

U takova me këtë kojshinë që shkumë më grunë e tina me i mjel loptë, "A i mledhe votë, ku ke ti?" Se oborri i tijna i madh, e lopë e ahra e oda e shpija, s'di sa shpija me ni oborr. "Jo, jo, s'di ku ka vo e kurgjo" thash, "E di që kofet me tamëljonë konë përparrë tyne. Tu nga si e qartne, jo tu ecë po tu nga. O mu flliç trupi, o thojsha me mujtë me konë n'ahra e myti veten, e pastroj e heki atë far... prej trupi. Mu doke që çkas m'ka shti n'trup ai njeri. Kur jom shku, fëminë s'ëm vijke me i përqafë, thojsha nal mamit se i kom mjelë lopët. Nuk guxojsa me i përqafë fëminë me atë... erën me atë... Ata nuk dishin kurgja. Jom pastru. Kur jom pastru mu ka dokë dyjaja e jeme, i afrojsha fëmitë i qafsha.

Edhe tu i ngu lajmet, këta kojshia rome nuk i ngojshin po për hatër tem i Ishojshin. Edhe tu i ngu lajmet, kuptova që vëllau im kish shpëtu". Oh Allah, qysh thojnë ni dritë n'tunell u dhez. Oh Zot kena bërtitë krejt, "Daja gjallë!".

Tani prej atij momenti smu nejke vetë. Thash del ku te del po shkoj në mal te baba e nana. Këta më majtën boll.

Asaj familje kurrë s'kam me ia harru. Me vizitu nihere i kom vizitu menihere mas luftës tinëza. Edhe nihere i kom pa n'market, çika jem o kanë tu punu edhe une kom shku me ble harç e kom zatetë atë gruen, e ia kom ble do sene. E kom nejtë qaty, e kena pi kafe bashkë, po me tutë që po thojnë ata "Pse po rrin me rom?, a po kupton, mas luftës. Oh Zot çfarë familje e mirë, çfarë t'kulturumë ata fëmi. Kuku Zot i gzungë, ia kom lakmi asaj, çfarë kulture, çfarë edukate kanë pasë fëmia e saj, shembullore. Edhe jom shku prej atij momentit t'nesrit, jom shku atje i kom marrë teshat, jom shku kom nejtë mo bashkë me t'mitë.

Edhe u kry lufta, me 10 qershor. Burrit i kishin thanë që na kanë mytë. Mu më fëmi edhe babën e krejt familjen. Se e kanë përzi emnin e babës tem me emnin e një tjetri në katun te na. Ata krejt i kanë mytë. Ai ma ish tranu. Po une ma tu kajtë në telefon i kallxova që gjallë jam edhe fëmija mirë.

Edhe ia fillova jetës, n'fund të '99-tës, burri u kthy prej Gjermanisë. I thojsha, "Rri, merrna edhe neve" a din. Pare ka pasë, pak kish pasë do pare, thash, "Merrna edhe neve se s'ka mirë ktu jo". E u kthy ktu, u gzunëm kur erdh, qai gjim

u kanë për neve kur erdh, i pruni fëmive veshëmbathje, ushqim. I pruni edhe do pare, shumë mirë... U çojsha natën e kqyrsha, qysh koka përmirsu. M'u doke dyjaja e jemja, thojsha që a din po shkon kah pozitiviteti jeta jem. Fëmia m'pshtunë, familja po, thojsha nashtë edhe pse kem skamje e krejt... po e njisha nifar gjimi n'shpi tem. Qaty i kom pasë njo dy-tre mujë t'mira a din. As nuk dalke me pi as, pak tani kur ia nisi me shoqni, vijshin e thirrshin natën shoqnia.

Ia nisi n'fillim menihere mas ni muji, dy. Po tani kadal dale tu i hargju paret... Mendej nisa vetë me punu. I pata nja ni vjet e gjysë të mira. Po sa herë asht' prilli më rrok ligështimi. M'kujtohet dhunimi. E njisha veten t'dobët pse s'po muj, pse s'pe ngriti zanin. Kanihere thojsha, nashtë le t'thotë burri çka t'don, po tani thojsha fëmia tani t'shoqnisë, shokët e shoqet, thojsha po ia u hupi fëmive atë far autoriteti. Nashti edhe fëmia kanë me pritë keq, ku me ditë qysh reagojnë. I kqyrsha fëminë edhe u kujtojsha çka munen me thonë, apet e mbyllsha kit derë. E njisha veten që s'po kam une fuqi me bo diçka për veti. Pse mos me kallxu çka ka ndodhë? Pse me majtë msheftë?

Tash kur i shoh fëminë e mi që jonë t'edukumë, dijnë, janë t'mençëm, janë t'zgjutë, janë... E kom marrë gati n'atë kulmin në çka kom dashtë, po jo, hala. E kom maru shpinë edhe pse kom kredi e borkhe, po, kur p'i çeli sytë, pe di që osht punajeme edhe e fëmive t'mi.

Po um munojshin kujtimet... U tubu, u tubu, m'u duke që ni vullkan e kom diçka mrena që s'pe qes. Shkrujsha si shkruj vjersha, shkrujsha, i shkyjsha thojsha po ma sheh burri, fëmija a.

N'andërr, ata njerëz m'dulën me maska thojshin, "Ti s'na njeh neve" edhe çka m'bren ma s'shumti se thojnë, "Kurgjo s'ta kena ba ty, çka i kena ba shoqes tande". Nuk di kush osht ajo shoqe. S'kom une shoqe, s'di nashti osht, po unë nuk di se nuk ia kom kallxu kërkujna.

Unë edhe nashti s'jetoj gjatë, po ato çka kanë përjetu që jonë kanë ma t'reja. Kisha pasë qef ato me pasë përkrahjen, s'po di qysh me t'thanë. O me mujtë me bo diçka, boj për shoqet, sikur mu çka m'ka ndodhë, me iu ndihmu qatyne grave. Me mujtë me pasë diçka fuqi, ku me ditë çka boj pér ato gra, gjithçka kisha bo.

09 - TH.M.:

UNË DUA TË DËGJOHEM
Libër kujtimi me rrëfimet e grave të mbijetuara
të torturës gjatë luftës së fundit në Kosovë

• NUK DESHA ME HY TE AI LOKALI

Njërin nga dy qëllimet në jetë i kishte arritur. Nuk kishte mundur të shkollohej, éndërr nga e cila ende nuk ka arritur të heqë dorë, por ishte martuar në qytet, gjë që kishte qenë qëllim në vete.

Pojetonte e lumtur deri kur ndodhi lufta.

Në përpjekje për të siguruar ushqim, ajo kishte dalë në rrugët e njërit prej qyteteve të Kosovës. Është rrëmbyer dhe mbajtur me orë të tëra në një kafene nga paramilitarët serbë.

“... ata folshin serbisht, unë s'i kuptojsha, po ata a din, folshin serbisht. E unë s'kom dashtë me hy brenda te lokalit. Ata me zor m'kanë marrë. Edhe a din tu m'rrehë. E tani e kanë nxjerrë thikën m'kanë pre n'kamë, e kom ni shejë. Mu m'ka ra t'fiktë. Ata tani ia kanë nisë n'lomal me m'zhveshë. T'pijavitë me automata e jonë kanë...”

Rrëfimi në vetën e parë:
• **SHYQYR QË SHPËTOVA GJALLË**
TH.M.

Jom ni person pak i hareshëm, po kanihere jom edhe pak nervoz, e di veten. Po kur jam nervoz, nuk muj me e tejkalu ato pa u qetësu ose pa përdorë naj medikament për me pushu pak, me flejtë pak, me dalë jashtë. E tjera herë, jom e qetë kështu, po e njij veten, gjithë here e njij veten që s'kom mujtë me ba ato që duhet me e ba. Ish dashtë a din me kanë dikushi, po tash, koha ka shku s'ka metë kurgjo, s'paku njeri kish mujtë me e ba një zgjidhje, ni rrugë t'veten. Mos me kanë e varun prej kurrkujt. As prej burrit, as prej kurrkujt.
S'kom dashtë me kon e varne prej kurrkujt hiç. Kom dashtë me kon vetja gjithë.

Edhe si fëmi jom kanë qashtu. Si fëmi jom kanë fëmi i zgjutë. Ma e veçantë, diqysh i kom ba senet diqysh ma t'veçanta.

Edhe e kom dashtë shumë librin, ma shumë e kom dashtë librin se sa naj teshë me ma ble dikush. Me ma ble mu ni libër, une jom gjëzu ma shumë se për ni teshë që ma ka ble... ajo tesha osht çky. Vjerrsha kom mësu shumë.

Edhe e kom pa andërr shkollën gjithë. Edhe kur flejsha n'gjumë edhe te burri, andërr e pajsha që po du me vazhdu shkollën. Shkoj n'shkollë edhe o kanë shumë interesant. Po qysh u kanë at'herë veç deri tetë vjet i kom kry.

Kur me thanë që s'kam me vazhdu ma shkollën e kom ni veten shumë keq, a din, veten. Po ata, nihere menojska apet, e kisha ni shpresë, unë apet e lejsha veten me shpresë. "Hajt noshta shkojmë n'shehër e noshta m'çojnë n'shkollë".

Noshta ka njérëz që e hupin shpresën menihere. Unë nuk e hupi shpresën, apet e la ni derë t'hapun që muj me ba diçka edhe mas ni kohe.

Me babën jom shku gjithë. Ku kom shku, veç me babën. Krejt punët e meshkujve i kom ditë ma mirë se t'femnave. Kom punu, me bajtë metra, shlepera, krejt qato i kom bajtë si mashkull. Kom vozitë. Edhe krejt thojshin, "A osht djalë a çikë?!" Se s'mujshin me ditë a jom djalë a çikë. Edhe unë tani a din, diqysh i nimojska me vullnet, kisha vullnet. Ato punët tjera t'mashkullit që nuk t'lodhin. Punët e femrave, tonë ditën i ban, edhe kur t'kqyrsh knej, apet njëjtë bahan, apet vazhdimisht i ki qaty me pluhna, me fshi me krejt. Ato kurrë nuk përfundojnë. E t'mashkullit e bon, po dihet se çka po ban.

Si vajzë e rritur kur jom kanë kemi ardhë n'qytet. N'qytet nejsha veç n'shipi. Shkojshim me çikat e dajës, t'hallës, u bojshim tubë natën. E bojshim ni muzikë, ni lojë, at'here mo s'ki menuë ma shumë, kiske qe veç me u aktivizu me naj shoqe, me u knaqë, me lujtë. Edhe atë kohë, ajo kurrë s'ëm shlyhet si jetë e përgjithshme e mirë, a din me shoqe.

Mu m'doket që a'ëherë u kanë ma mirë se e re. Edhe tashti t'rijtë i përjetojnë si na. Na menojmë që o kanë at'here ma mirë, edhe tash osht edhe ma mirë se at'here.

Po, secili e din gjeneratën e vet, e i pëlqen, po tash o metë me thanë, "At'here ma mirë".

So kanë at'here ma mirë, kur t'i kqyrë do fakte, hiç, çfarë ma miri (qeshet?!). As s'ke pas rrymë nëpër katune, katastrofë o kanë, katastrofë o kanë. Gjynah o kanë me i pa njérëzit, si parahistorikë jonë kanë, po çfarë miri.

At'here s'i kanë trajtu njérëzit, ma shumë i kanë trajtu... i kanë dashtë kafshët sesa njérëzit, s'i kanë interesu për fëmi. Fëmi kanë pas plot, s'i kanë interesu as qysh as tek a... Noshta o smu, dej ka ba me dekë e ai s'e ka çu as te mjekë.

"Hajt se çohet", bile as s'kanë menu për ta, veç kur e ka pa që s'po çohet hiç, s'po ha tri ditë, qat'here ka thanë ta çoj te mjekë. Nime senet noshta jonë kanë origjinale. Po edhe nuk kanë pasë me hangër.

Ata kanë pas qata tamël, e kanë ba lang, s'kanë ba kësi të trashë si djath, po e kanë ba si ujë e krypë i kanë qitë edhe e kanë ngjy. Se me pas djath jon knaqë, po as si djath s'kanë pasë. Mishin që e kanë pre t'gjallin, këto i kanë rujtë për mysafirë. Veç ku kanë nejtë me javë qytetarët aty, ata kanë punu për ta. Ata apet s'kanë pasë, çkajonë metë prej tyne i kanë hangër.

Edhe babgjyshi jonë, na ishum t'vogël, na e vetshum babgjyshin tonë, "Qysh o kanë at'here koha?" E babgjyshi tha, "At'here e ka pasë Shypnia krejt Kosovën". Po gradualisht, qysh i kanë marrë drithnat e tokën qysh ia ka marrë

masi o ardhë Shypnia. Qysh drithnat e këto përgjysë, kush ka punu o shku ia ka marrë shteti. Sikur tash që marrin tatimin e shpisë që vijnë me pagu. At'here shteti ia ka marrë krejt. Edhe tha, "U dufke me mjelë, me ia dhanë gradualisht. O kanë Shipnia, krejt Kosovën e ka pasë". Edhe tash po m'doket po don me ardhë edhe koha e tashtit si e at'hershit. Jonë hi kadal-kadal shpijave. Gradualisht t'u hi si kryetarë, si zavendës, kadal-kadal. Edhe unë po m'kujtohen senet, kur po nij nëpër televizor tash çka po bajnë, po m'kujtohen fjalët e babgjyshit tem.

Kur u fejova u kanë koha e demonstratave. At'here kanë qitë qesi sene, t'fala e... na s'jemi pa at'here nërmjet veti. Na jena kanë, po at'here s'u kanë koha m'u pa mes veti.

Veç përmes fotos po, se kështu jo. Edhe qashtu... vazhdimisht një vjet, mas ni vjete, qashtu para luftës jemi martu. Jem martu me kerre, edhe at'herë, edhe o kanë koha, qysh o kanë ktyneherë me do defa, me do... palidhje. Qysh i kanë bo a din, muzika se muzikën s'kanë mujtë me bo kështu, a din...

Po, o kanë mirë, o kanë për dasma, o kanë mirë se shpijat s'jonë tutë që po iu damtohen, se s'kanë pasë shpija me thanë. Tash ti p'e bon me mobilje, me tana t'mirat, e pe merr ni sobë t'mirë. Për dy orë mysafirt në dasëm ta bojnë mozomakeq.

Po unë kurrë nuk kom lakmu. Kom pas qejf me ba mirë edhe fëmitë i kom mësu me ba mirë. Se Zotin nuk munemi me pa n'fakt kërkush. Hiç kërkush s'munemi me pa. Qe po kthehemini na, po vishem, e po pshtillem me shamija me sy e me krejt, edhe p'e respektojmë Zotin. Zotin e respektojmë me kanë njeri i mirë, e i ndershëm, se pse e vnon ni shami e pse e ki zemrën kërkun hiç, se Zoti s'un t'bon kurgjo. Zoti i don ata shpirtnisht që jonë t'mirë, e jo që pshtillet e e tutë dikon aty. Na s'po shkojmë përpëra, po po kthehemini mrapa.

Kur jom martu, a din, jom konë e knaqun që po martohna n'qytet e nuk po martohna dikun me ni katun. E n'katun s'kom dashtë me shku hiç. Tek e fundit, me t'kallxu, kur ka thanë dikush, "P'e lypë qitu", jo që si, kom thonë, "Mu s'ëm intereson, a osht katun?" "Po" "Hiç! Pa martu rri, e n'katun nuk shkoj". I kom thonë atyne, "Mshoni vijë!"

Qat'here kur u martova jonë konë demonstratat, e hajt, e hajt. Burri o kanë, pak o kanë si xheloz, edhe o kanë pak... diqysh qysh jonë kanë ktynehere... Po une me to mirë kom kalu, me vjehrri, e me këto e... a din. Pak para se me u shpallë lufta, qat'here iu kanë nda, a din, kunetë. Tani une me vjehrri, kunetë. Tani këta vjehrria kanë jetu deri mas luftës. Edhe, a din, kemi nejtë ni kohë t'gatë me kunetë, derisa i kemi pasë edhe fëmitë. Tani e ki pa kur rriten fëmia, rraken fëmia nërmjet veti, jo ky, jo ai. Se mos m'u kanë fëmia, s'dahet kurrë shpija. Ka punu burri se vjehrria jo. Kanë punu edhe kunetët.

Mandej nisi lufta. Neve na kujtohet veç kur na kanë qitë prej shpisë. Jemi dalë prej shpije. M'doket jemi dalë n'rrugë. Tani u bashkangjitën kojshitë e kushëri e plot, u bamë... bashkë me kojshi aty. U bomë afér qaty dikun, afér jemi shku. Edhe u bamë bashkë krejt me ni ven, a din. Se erdhën do të UÇK-së, do a din, edhe u enshin asajde. Veç i kqyrshin, tani thojshin mas atyne, knej na mysin. Po këta të UÇK-së ishin n'grupin e popullatës e ardhshin, se ata s'dojshin me u kthy hiç, s'kishin me çka. Kur na po shkojmë te ata kojshitë, po dalum, kur po dalum që t'veshun. Na kishe UÇK-ja, ata shkije me maska me krejt. Na te kojshia, thamë hajt t'shkojmë te shpija t'marrim diçka ata thanë, "Jo, mos t'ju

gjejmë anej se ju vrasum. Poshtë shkoni” “Kah me shku?” thamë. “Shko nëpër Makedoni, a Shipni, veç dilni dikah, ecni. Këtu s'keni çka vini mo”. Dulëm n'mal. Menojshim që po kthehem, hajt n'mal, ai kur na pajtën n'shpi, t'sheh edhe n'mal se ata dalshin nëpër brigje me snajpera.

Dy ditë, ni natë bujtëm n'mal, t'dytën qysh me bujtë me fmi, fëmia e vogël. Thash, “Valla në m'vrafshin, n'shpi po flej”. Bile flej, këtu çka me bo, ku me flejtë me fëmi, u mërdhijshin, djalin e vogël e kisha. Edhe, tash ata po na gjujnë me snajperka, prej atyshit na shohin prej bregit edhe na gjujnë. Bjen plumi ngat llastiki, po kon me ta rrokë. Dalin krejt... ata krejt na kanë pa qysh po ikim. Edhe u nisëm me ikë tanë prej atjehshit e me do traktora e me do gjysa kamë, e hajt, e hajt, e hajt. U nalëm me ni ven, ishin kanë t'sacionumë, ata prej s'lartit na kanë gjujtë, s'jonë kanë kërkush. Ishin stacionu pak para se me hi n'qytet. Edhe, na bujtëm ni natë, e rrugës u ulëm rrugës me fëmi, napër traktora, do tu ecë edhe bukën çka e kemi pasë me veti, qata tjetër s'kishum mo. T'nesrit, hajde tash tu vra, tu i zhdrypë prej traktorit, tu na maltretu, do i vraqshin, do i prejshin, femnat do... Tmerr! Edhe njëzit jonë t'rrijë, shumë m'u kanë dhimtë kur i kanë qitë me i vra. Se i vraqshin plot. Po ata kështu gjujshin po s'i vraqjnë, po ata t'rrijë.... T'ia Ishunë brrrrr (imiton zhurmën e armëve v.j.) automat, e i vranë. N'prru rajshin, se kon e vraqshin n'prru rajshin. Krejt aty prrojve, tu i vra, tu shku... aty 150 vetë jonë vra plus n'ni shpi i kanë shti i kanë rrehë, i kanë maltretu, i kanë rrehë. Aty e kanë shti edhe burrin tem, po ai për fat t'mirë tha, “Pshtoval! Se aty veç i bijshin krejt, e i rrehshin, more hiç s'i interesojke, me shipkë i rrehshin. Na veç u dridhshim prej tute. Po patën ardhë, erdhën me automata n'kerr, tha, “Pare”.

Na zhdrypën apet prej traktorit. “Hajde se babën Clinton p'e doni edhe nanën Ollbrajt, hajde!” ata thojshin, se qito rene na i dijshum edhe pse folshin serbisht. Ja bomë, “Jo, jo, s'pi dojmë ata as kurgjo” tha, “Po, po p'i doni ju ata, hajde, hajde”, i murrën e i shtinë edhe ata në ni shpi. I kanë rrehë edhe atje, i kanë mytë, do t'plagumë qysh ia u kanë ngulë thikat, edhe rrugës, se s'ka. Masanej e vraqjnë dikon me thikë, e kanë rrehë edhe ma zi. Me dalë prej kolone, sikur me t'hangër uki t'vraqshin. U duftë me u marrë me i zatetë tanë kolonën që me hi n'grup t'popullit ku jonë mbetë, se gjysën i kanë nxonë qashtu i kanë mytë, 150 vetë, s'jonë kon pak. Unë kur e pashtë nji njeri t'vramë, thash, “Ha e paskan vra”. Veç m'u ka dridhë vërrrr a s'guxojsa me thanë kurgjo, as hiç, hiç veç m'u ka dridhë trupi, as s'guxojsa me thanë kurgjo, as hiç. Qajo jakne që e kish pas kish metë e palutë. Edhe, ma prej rrugës gjujshin, na ishum ma poshtë, ngutu me hi midis kolonës, se na ishum përmas, po me na nxerrë problem. Po u ngutëm me traktor, e hijmë para tre-katër traktorave, si n'midis. Femnave na thojshin, “Hajt, hajt se keni pare”. A din, dojshin me t'desh me kqyrëku i ki paret. Kqyrshin me t'i deshë pantollat, “I kanë paret qitu”. Me thika, hiç s'i'u interesojke atyne.

Edhe u kthymë n'shpi. Po masi u kthymë n'shpi, nuk kishim çka me hangër, s'kishe kurgjo, u dufke me dalë m'i ble fëmive do sene. Po me ble s'kishe ku e shkojsa te familja jeme. Shkojsa me iu marrë harç. Kishin pa pre pasterrëm, t'mitë. Kishin harç ata për me hangër, për me pi, ka pasë sa t'dushë. Edhe dulën ata, u çkepën, shpija met vetë, tash unë shkojsa te nana jeme me marrë sene. Edhe tanë tu shku këtu, a din, tu shku te nana jeme, kur ishin kanë policët atje, nji lokal u kanë, si kafe a s'di qysh u kanë me xama i ndërtumë n'rrugë.

Edhe tu shku, s'kishe kah ia man aty, s'kishe kah shkon se ata t'pajshin. Tani qaty, mu m'ka ndodh kjo... a din... kjo dhuna prej tyne. Aty jonë kanë mos gabofsha, jonë kanë gati dhjetë veta, mu ka dokë mu noshta, po plot mu dokshin që jonë, kështu prej tutës. Edhe aty, shkova, ata folshin serbisht, unë s'i kuptojsja, po ata a din, folshin serbisht. E unë s'kom dashtë me hy brenda te lokali. Ata me zor m'kanë marrë. Edhe a din tu m'rrehë. E tani e kanë nxjerrë thikën, m'kanë rreh kështu e kanë nxjerrë thikën ma kanë pre pak ni gisht, m'kanë pre n'kamë, e kom ni shejë. Edhe, masi m'kanë ra me thika mu m'ka ra t'fiktë. Ata tani ia kanë nisë tani n'lomal me m'zhveshë. T'pivjatë me automata e jonë kanë... A din, shyqyr që o shku ni kohë kogja e gatë pak, a din, se s'un i kisha përballu me tregu.

Prej at'hershit kom problem me zorrë t'trashë. Prej at'hershit se ata ishin kanë qashtu t'dhunshëm edhe kur m'ka ra mu t'fiktë nuk e di sa kom nejtë aty. Po mas ni kohe nuk e di sa kom nejtë aty, nuk e di as vetë. Po jom shku pak para akshamit n'shipi, a nuk e di aty sa kom nejtë se unë kur jom shku n'mëngjes me marrë ushqimin. Edhe, kur pak para akshamit, i morra qaty do tesha... ata veç e kanë krytu m'dhunu edhe jonë shku.

Unë e maj mend veç fillimin. M'ka ra t'fiktë edhe ata, nuk e di tani hiç çka kanë ba, a kanë nejtë, a qysh a çka kanë ba me mu, po kur jom çu e kom pa që kom pas shumë gjakderdhje prej zorrës t'trashë. Edhe i kom marrë une, jom ndreq pak, i kom marrë do tesha, do i morra. E kur u kfjella pak, shkova te familja, te t'shpisë tem, masi e dijsha që osht shpija jem, a din, te t'familjes. U konë e zbrazët. E jam shku atje, edhe jam pastru, jam ndreq. Se ma rahat e kisha shpinë tem, t'familjes tem. Edhe shkova aty m'u pastru, m'u nreqë e mos m'u dallu a din, me i ra n'sy dikuj, masi isha pshtue gjallë. Edhe e luta Zotin, thashë shyqyr që kokna pshtue gjallë, për qata fëmi bile. Edhe, kur u ndreqa te shpija jeme. Thanë, "Pse u vonove?" thash, "Po s'guxofta me dalë". Kur u ktheva vjehrrit i kallxova. Tha, "hiç mos e bo t'madhe, shyqyr që koke pshtu gjallë".

I thash, "Te qikjo përpjetëza", qështu-qështu. Tha, "Hiç kurgjo s'koka bo, veç që je pshtu gjallë se kanë përjetu njerëzt shumë e ma shumë sene. Kjo ndodh... masi ke pshtu gjallë mirë u bo, masi s'të kanë marrë me t'çu dikah e mos me ditë na kah je, me t'zhdukë krejt". Tha, "Edhe shuj, mos e bo t'madhe se koke ngjallë për s'dyti herë". Pak m'dha vullnet vjehrri, u kanë shumë i mirë edhe i dashtun kështu shumë.

Më ka mbështet shumë. Jom konë me tutë tani. Edhe dej... u shnosha, ai i dijke do sene, do barna i marojske, do ilaçe a din, m'ka pa nihmu shumë. S'ka pasë nevojë me shku te mjeksi se ai u kanë shumë si doktor u kanë. Diqysh u niva mirë e rahat, kur ma tërheki vërejtjen, kur m'tha "Shyqyr që ki pshtu gjallë" se a din kur menojsa veç për keq, veç kështu...

Këtyne tjerëve u thash qështu-qështu "Jom trishtue t'u ikë prej tyne, prej shkijve t'u ikë, prej policëve, jom vra edhe qështu". Masi shyqyr Zotit, as s'u bo ma keq, jem pshtue mirë. Tani mas lufte i pajsha do andrra, i pajsha... Gjithë u tutsha natën, u frikësojsha natën u çojsha. Ai burri, "Çka ka bre? Çka ka që gjithë natës s'po m'len t'u britë?" "Po prej luftës t'u pa, t'u ikë prej shkijve", s'mujsha m'lì kallxu se nuk o'kanë tip që m'lì kallxu. Vjehrri o kanë shumë i mirë, si mos me kanë i tyne. Vjehrri o kanë, si mos me pasë ato djalë. O kanë i qetë, o kanë i mirë. I kuptushëm. I ka kallxu senet mirë, u kanë, a din me t'i kallxu, me t'i shpjegu senet po me t'met' marak me i ngu. E ky djali i vet, si mos me kon i tijna

hiç, a din hiç... ashtu me i marrë senet ma nervoz. Vjehrri u kanë shumë njeri i mirë, shumë i urtë për tana senet, a din. Ka ditë me na këshillue, me na nihmues. Ma shumë se babën e kom dashtë.

Tash kam probleme me fjet. Sidomos menihere mas lufte. U çojsha kështu, edhe hala kanihere. Kanihere kur bahna nervoz, a me ni diçka keq mu m'ndodhin ato frikësimet e luftës. Tu ikë, tu njekë, tu... dhunu, a din, m'shfaqen ato. Kurni ngjarje diçka t'kqija që m'vranë.

E mytën... ose me pre diçka, ose me pa naj film t'keq, me ba me m'ra n'sy, unë s'i du filmat. Nuk i kqyri asnjo. Që thotë dikush, "E kqyri qit film" hiç nuk i kqyri filmat. Që s'ka njeri që s'i kqyry... .

Kqyri diçka humor me keshë... Me burrin?! S'e di. Mas luftës osht pak ma tip nervoz, pak ma... kanihere m'shkon shumë nerva, osht shumë nervoz, shumë t'bon mu ni keq. Po nuk muj a din me ia shpreh, e kështu i kam a din diqysh, i kam ni fjalë shumë nashti kshtu i ranë.

Djalin e kam, shumë t'nihmon kur t'sheh që je nervoz, e kështu... e ai ka nejtë shumë edhe me babgjyshin e vet, thojsha mos i ka tregu ai naisen a... ky s'ka tregu. Veç munohet me t'qetësu, munohet kështu, a din, me t'folë me atë anën me bo hajgare e sene, me i qitë n'anë pozitive, a din, mos me shku te senet e kqija, me menu keq. Veç me t'qitë n'anën pozitive, a din. Nuk don me t'lanë ato sene me menu keq. Ka qef me t'qitë me shëtitë, ka qef qështu a din... me t'ba argëtuse diçka. Mos me t'lanë me nejtë me kujtue me mendime... Me t'ba nervoz nuk ka qef, a din.

Djali m'thotë "T'ishe kanë ti shkrimitare, a kiske shkru?", i tham, "Për kangi a? Për kangi që p'i qesin dy-tri fjalë, pesë qind kangi i kisha bo. Për qësi kangi sa t'dush i kisha ba". A din me i përshkru nihere, nihere e shkrun nji fjalë, dy fjalë, cilat t'pëlqen i nxjerrë prej tyne, i bashkon a din. Edhe kur osht t'u knu, ty t'kujtohet tjetër... ndryshe. A din, e kundërt, ose kur je tu udhëtu t'kujtohet diçka kundër. Krejt senet t'kundërt t'kujtohen, e qato i përshkrunë, se qato nuk... mun me përshkru qato që e sheh, po qato që e menon. Qajo që e don me nxerrë veç prej vetit. Se nuk munesh me shkrue.

Kur ka vdekë vjehrri vallah keq, shumë keq. Edhe hala a din, me menu, me folë për to shumë, nuk muj me ni.

Deri qitash sa jonë kanë vjehrria, mirë jem kanë. E tash knena u kanë ma shtirë. Qetash e kena ma shtirë se që e kemi pasë. Se kur u kanë vjehrria, i kanë nihmu djemtë e vet, a din. Po, masi jonë dekë ata, ma kërkush. Djemtë jonë rritë, punë s'kanë.

Djemtë jonë t'rritun, s'jonë n'punë as kurgjo. Qështu kanë kry shkollat e fakultetet, nuk jonë t'u punu hala kërkun.

Porosi e kisha lanë, me u marrë pak me rini. Çikat e reja shumë i shoh që as me guxu prej prindërve t'vet e jet' pa shkollë. E nuk guxojnë me bo atë iniciativën me t'regu ty pse s'po shkojnë n'shkollë. Nuk guxojnë me thonë.

10 - VIKI:

UNË DUA TË DËGJOHEM
Libër kujtimi me rrëfimet e grave të mbijetuara
të torturës gjatë luftës së fundit në Kosovë

- **UNË, MOTRA, KUNATA,**
- **ÇIKAT E TEZËS, HALLËS....**

Rreth 17 gra janë mbledhur nga një grup paramilitarësh në një qytet të Kosovës. Sipas dëshmitares janë mbledhur femrat më të bukura të lagjeve. Ishin dërguar në një shkollë në një fshat afër këtij qyteti. Aty, sipas dëshmisë, ka pasur dhjetëra gra që janë mbajtur më ditë të tëra. Kanë përjetuar dhunë seksuale, dhunë fizike dhe gjithçka tjeter.

Njanit i thojshin Peshk, "Ribe", njanit i thojshin Luan, njanit i thojshin Vuçjak. Oh kuku çka na ka bo Vuçjaku neve... Na kanë çky bre, shkurt e shqip na kanë çky. Tu na dhunu na kanë çky. Kuku na çka kena hjekë na.

Rrëfimi në vetën e parë:
NA FUTËN ME NJË SHKOLLË,
• ATY ISHIN KANË PLOT TË SHKRETA
VIKI

Jena kanë dhjetë anëtarë të familjes, baba, nana, pesë motra, tre vllazni. Unë ma e vogla prej familjes. Jetën e kena pas normale. Baba na ka kqyrë shumë... s'e di. O kanë shumë i pasun, na ka majtë mirë boll, na ka ble çka kena deshtë. Mu si sot m'kujtohet, e kom pas një bicikell t'pembe, ndoshta i kom pas pesë-gjashtë vjet, ma ka bo dhuratë për ditëlindje. Ato s'e harroj kurrë. Kështu që, ka edhe gjana t'mira.

Çka o me randësi prej meje osht se jom kanë shumë e aftë deri n'shkollën e mesme.

E shkollën e mesme s'kom mujtë me e vazhdu ma anej. Fakulteti larg. Tani baba m'fejoi, m'martoi. S'e kom njoftë burrin. Masi jom feju, s'jom pa deri mas gjashtë mujve. U martumë. Ditën e parë, dytën, tretën mirë, masanej filloj

xhelozia. O kanë xheloz shumë. Ka pi shumë. M'ka lindë fëmija i parë. I linda edhe dy fëmijë tjerë edhe filloj lufta. Nejshim n'shipi kur i kena ni kërsimat, bam-bam-bam-bam (imiton zhurmën e armëve). U t'merrumë, "Çka u bo?" se s'dishim çka po ndodhë. Edhe këta ranë, burri me fëmitë ranë për tokë. Unë s'disha çka po ndodhë. Menojsha dikush po merr nuse po s'kishin t'nalne, se vishin bajegi afër dritarës. Tri-katër ditë jena shku te një kojshi. Ajo e kish si podrum edhe na murrë, krejt lagja qatë e shtine. N'tri-katër ditë, meta pa pelena. O dashtë me shku n'shipi me e marr noj çarshaf a diçka, s'e kisha larg. Po t'u i shku me trenerka, t'u mendu se jom mashkull edhe m'gjujtë. Por nafaka s'lëm rrokën. M'gjujshin prej kodrës. Gjujshin, si pajshin dikan që po lëvizë gjujshin. Edhe, unë shkova, i mora një pesë-gjashtë çarshafa se fëmja e vogël.

S'ka pas kurrfarë lëvizje. Ata na thanë, "Shkoni ku t'muni se këtu vend s'ka për juve", shkijet. Veç i mshojshin dyrve "Hajde, përjashta! Dilni jashtë!". Tana, çdo fërkemqë ecke autobusi, hishin policia me qyrrë çka ka, tek ka, a ka naj ftyrë t'ngjofshme. Po na, tri-katër orë udhëtumë. Ish dalë nana me m'pritë. Dolën me na pritë tanë si me shku prej ku me ditë kuhit. Veç se jemi gjallë. S'bojshin as telefonat as kurrfarë lidhje s'ka pasë. Shkumë. U rahatumë, u qetësumë. I kanë hy motrës në shpi edhe ia kanë vra burrin, çikën edhe janë dalë knej kah na. Tani erdhën m'murrën edhe mu, i mushën kamionat, kush ish ma e mirë e zgjidhke. "Hypni!", "Hajde!" "Ku po na çojnë?" S'e dishim ku po na çojnë, 17 veta na kanë marrë, krejt femra. Na kanë qitë n'kamion, s'dishim ku na çojnë. Kur shkumë, ish kanë si njifar shkollë e madhe... Edhe aty ishin kanë plot t'shkreta, t'mjera, qysh janë përgjakë ishin bo katastrofë. Hynëm mrena. Na shtyjshin me forcë. Kur hinëm mrena, e vetëm një gru, "Ku jena?" Na kallxoj. "Oh e mjera une për ju", kajke, vetke, "Edhe juve si neve ju paskan marrë". Kush po hike n'duar t'tyne, s'po dilke qysh duhet. Dhamtë na i kanë nxjerrë me dana. Pse? Se refuzojshim me pasë punë me ta. Qe ku e kam t'preme këtu, këtu me thikë që m'kanë pre, n'kamë, n'organe gjenitale. Nëpër duar na kanë shymë cigare, na kanë pre me thika. Tri ditë e tri netë na kanë majtë qatë.

Na kanë dhanë raki me pi, na kanë rrehë, na kanë torturu, na kanë shpu barkun, organet gjenitale, përpara, përmas (psherëtinë). Mas tri dite, na kanë qitën n'kamion me na çu dikun, thojshin, "për Serbi po i çojna se p'i lypë Arkani". Kur kena shku dikun kah mesi i rrugës, motra na i ka zgjidhë duart. E ka thy një shishe aty, na i ka zgjidhë durtë, unë asaj, ajo mu, tu u munu me m'l zgjidhë duartë. E ja kena zgjidhë kunatës, ja kena zgjidhë një pesë-gjashtë vetave, po do thojshin, "Po tutëm!", do "s'po tutëm". Kena kcy një shtatë-tetë veta prej kamionit poshtë, e ish kanë mal larg atje një njeri me kerr me kuqj. "E çka u bo bre motër!" na tha. E kena kcy na gjysa, gjysa a kanë kcy a s'kanë kcy, nuk e di. Qeto çka jena kanë, jena kanë tepërt'bukura që dojshin me ja çu Arkanit atje. "Ku po shkonju motra? çka jeni bo kështu?". Motra i tha, "Jena grrithë nëpër therra tu ikë". Tha, "Ku keni me shku"... Ai magjup ish kanë. Tha, "Hajde se une ju çoj". Hypëm aty, na çoj, por diqysh na u mbulumë se, a e din kështu krejt ramë për toke se u tutshim mos po kthehet kamioni përmas.

Qysh shkumë te nana, kur shkumë, ja nisi vllavi, "Nuk e mbaj!", "Nuk e boj!", e "E kthej!" për nusen. Erdh edhe burri jem tha, "Prej sodit ma, s'je guaja jeme". Nana tha, "Hajr i koftë. Çka kom me bo? S'kam çka boj". "Shko!" Aty me nanën e me vllaun. Vllavi ma s'bojke za, mur vesh. "Nanë bre, qysh..." e knej-anej. Tha,

"Kqyre djali jem, kqyri motrat e tua. Çka ju ka ndodhë motrave t'tuaja i ka ndodhë edhe grusë tandem. Ku me i çu motrat? Grunë ku po don me e çu? A je tranu? Ku po don me i lanë fëmitë?" U nal, s'bojke za hiç por rrike si me rezerva me tetanë. Edhe nanën e kanë dhunu qat ditë që na kanë hy mrena, rend. Po neve që na murrën tanë me veti, e e kanë rrehë se s'dojke me na lëshu. Rreh nanën, rreh, rreh. Mshoji thikë, ktu e ka shejë nana n'kamë, n'kuk, këtu e ka shejën n'kamë. Se ajo s'dojke me na Ishu kurraqsh. Boll u kacafyt me ta por dikur e gjujtë për toke (psherëtinë). Tu u kthy n'shipi, kur u kthymë... nana si nanat, priti mirë boll... Tani erdhën kto tjerat vujtje, jo me dalë nëpër kolona. Me 10 prill, 9 prill o kanë kur kena dalë në kolonë. N'atë kolonë çka kena hjekë na, s'ka hjekë kurrikush. Boll u munumë m'u masku me pelena, me e zhytë ftyrën, po badihava. Badihava... Nja tri herë rrugës na kanë dhunu këta policët. Paramilitarë apo çka janë kanë. Janë kanë krejt t'vizatumë, me ftyra t'vizatume. Nuk mûshtë as me ditë kush janë as tek janë, as. Veç kështu do emra, me nofka a qysh janë thirrë ata nuk e di. Do emra që, a din kështu, t'shkurtë, shumë t'shkurtë janë kanë. Njanit i thojshin Peshk, "Ribe", njanit i thojshin Luan, njanit i thojshin Vuçjak, kishe Vuçjaku t'han. Oh kuku çka na ka bo Vuçjaku neve ja ktheftë Zoti Jarabi, La Ilahi Ilallah, me familje t'vet. Na kanë çky bre, shkurt e shqip na kanë çky. Tu na dhunu na kanë çky. Kuku na çka kena hjekë na. Na kanë dhunu edhe rrugës. Ata e dinë krejt bota. Sa dhunimi u bo. Pesë ditë kena ecë n'kamë me shku, tanë m'u kthy, me fëmi të vogël, me dhunime, me gjakderdhje, me tanat t'zezat. Na bërtitshin, na piskatshin. Ata na rrehshin, qe besa "Pse po na kundërshton?" Edhe ishin kanë pasë hupë çikat krejt. Iшин shku ishin strehu te nana jeme. Kur na qitën prej atyshit, "Çka keni bre?" "Mam çka t'ka ndodhë ty?" Thashë, "Kurrgjo!" Tha, "Jo, po na kena pa". Prej at'herit e dinë po s'ma përmenin kurrë. Jonë pajtu edhe ato me këtë rast. Si t'vjen data e dhunimit unë s'muj me e përballu, prej traumave shkoj n'spital menjherë... Mos e lashtë Zoti fëminë me nanë pa babë... Krejt ishin lagje-lagje, e u tubunë te xhamia. Osht qai veni te xhamie, sa burri, sa gruaja, sa njeri i vramë. Masi jena kthy prej kolone, tanë i kanë mbledhë burrat. I kanë mbledhë burrat e i kanë shti n'burg. Se thojshin se ka me u bo keq.

Na ka qitë dikush dy bukë, e dikush... Na kanë dhanë edhe ushtria e rregullt. Ushtarët serbë, t'rregullt që janë kanë. Ata që s'kanë dashtë me hi n'gjynah me gra edhe me fëmi. Na i kanë qitë tamël pluhën, na jepshin bukë, na jepshin do (psherëtinë)... u shtrydhke si kalladonti... Ushtria e rregullt që janë kanë. Këta që janë kanë me shatora me sene, tri herë na kanë nalë rrugës na kanë dhunu. Bijke shi shumë, vllavi e kish çikën n'dorë. Edhe i tha ushtari, "Nalu!" Atij ja boni nalu, neve jo. U nal, po u nal edhe motra me nusën e unë isha pak ma anej me nanën. E ka nxjerrë thikën edhe po don me e pre vllavin. Ai e kish pa pre këtë yllin, yllin ktu t'kapuçit, e ia kish pasë maru çikës t'vllavit me llastik mos me lagë shiu, se o kanë shi i madh at'herë. Po edhe Zoti ka kajtë për neve për çka kena hjekë (psherëtinë)... Flejshin fëmija udhës. Dikush duart n'xhepa. Une çikën e vogël s'mujsha me e Ishu prej gjyksi. Duart n'xhepa, e veç kur shkojke njana anej e njana anej.

Kemi pas plagë që na i kanë bo me cigare e thika, këto, apet mûshtë vet ka pak me i pastru e me i la, por ato mrena.

Masi o ra NATO-ja ja ka nisë me na mjeku një doktor shqiptar. Masi o hi NATO

kështu mirë me bombardu.

Na dhanë ndihmën e parë, na ka kepë, na ka ndihmu me do masta me na shëru këtë zorrën e trashë. Edhe hapa na ka dhanë për trauma se na kallxumë çka na ka ndodh. Na i murrë emra e mbiemra, krejt. Por që vike çdo javë me kqyrë qysh jemi, se ai ka rreziku shumë se ka ardhë prej një qyteti tjetër. E m' i kqyrë viktimat e dhunës, veç ai e ka bo. Dikush tjetër s'e kish bo. Edhe motra u kanë shumë keq. Ka pasë trauma t'mëdhaja po që nuk dojke mu da prej burrit e çikës. M'tha doktori "A po shkon?", "A po shkon, a po del jashtë!", "Merri çikat edhe dil jashtë se po ta dha besën ki m'u shëru". I morra çikat, ai ma gjeti krejt qysh me shku, tek me shku, m'coi n'Belgjikë m'u shëru. E kom pas mbështetje një belge e martume për shqiptar.

Ajo m'ka këqyrë n'spital. Ajo o' kanë përkthyese numër nja për mu, motër e kom n'atë dyje e n'këtë dyje. 28 ditë m'kanë majtë me infuzion n'dorë, kurrë pa ma hjekë. Kurrë, veç e ndërrrojshin shishen... Edhe, masi jom dalë prej spitalit, pak e mora veten edhe tha, "Du me t'çu n'kamp me t'lajmëru", si azil. Shkumë aty, u lajmërumë, po tha, "du me t'çu n'katin ma t'naltin se mos me pasë ti kontakt me t'tjerët edhe me ta pru ushqimin ty nalt, e veç kur don t'i vetë me ra poshtë". Unë u pajtojsha me çkado që thojke ajo... Kha i kisha mendët te vllavi, burri i nusës, vllavi i dytë, e kishin pasë marrë policia, e tash nëpër gazeta u përfolke se ai ka dekë. Ai nuk kish pas dekë, po e kishin çue e e kishin majtë n'burg, rrehë, maltretu, dhunu. Edhe e kishin pasë çu n'Shqipni. S'disha qysh me kontaktu, me kérkan s'kisha kontakt se telefonat s'bojshin. Se nana ka pasë telefon gjithë, e gjithë ka pas telefon te na. E dikur provo, e provo, e provo, mas gjashtë muaj që u bo atje e thirri, "Nanë, a jeni gjallë, a jeni shnosh, a je mirë?" Tha, "Krejt mirë po vllau s'mutë tu dekë", "Pse?" Tha, qeshtu-qeshtu "E kanë dhunu, i kanë bo 100 t'zeza." E thash, "Vi qetash". Kom mujtë me nejtë nja gjashtë-shtatë mujë. Aty e njoftova nji familje belge e m'thanë, "Oekjo që t'ka ndodhë, na po dojna me t'shpërbly, me të ndihmu..." jonë kanë shumë humanitarë. "Koke metë me tre fëmi, shpi s'paske, po dojmë me ta ble nji shpi veç ku po don ti. Ti zgjidh ku po don".

Unë me shku te nana, nejse atë qytet nuk e du kurrë ma. Pse mas dhunimit që m'ka ndodh, s'muna ma... edhe kur shkoj kështu te nana, m'çon toka peshë se kam shumë histori t'hidhne n'atë vend.

U ktheva.

Motrat, çikat e tezës, çika t'mixhës, çika t'hallës. Krejt jena kanë bashkë. Po gjithkush le t'folë për veti se nashta une s'kam t'drejtë me folë për t'tjerat. Unë kam t'drejtë me folë për motër, për kunatë edhe motër. Motra ka nga mas burrit. Ja kanë marrë burrin..., gjashtë motra e kanë pas qat vlla. Ka ngajtë mas burri se i ka pasë dy djemë. E kanë nxanë n'stacion t'policisë e e kanë dhunu secili për veti.

"Qysh nganë grua ja mas burri?" shkau. Se femna shqiptare gjithmonë o kanë n'sy për moral. Gjatë dhunimit na thojshin, "Ju shqiptarët lypni me ia u bo edhe ma zi se ruani nderin", "E boni këta", "Ia u bofsha nanën kështu", "Kena me ia u bo, kena me ju kallë krejtve", "Kena me ia u bo knena". Veç sa fjalë fyese sa na i kanë thanë, ata se meritojnë as emrin serb me e përmend n'Kosovë. Se le mo që shkojnë n'deti e sene-vene. "Ku po shkon?" "Po shkoj te malazezi" "Po malazezi ta ka bo qat t'zezë bre?" Ma shumë ka pas malazëzë se që ka pas shkije... S'di sa herë kom tentu me bo vetëvrasje masi jom kthy n'Kosovë. Po, se

folshim na, jo filani, jo fëmija anej. I pajsha çikat, thojsha kujt me ia lanë këto. Kush i kqyrë këto?

Çka kanë faj kto? Babën s'e kanë, nanën s'e kanë, ku jesin? Taman i bojsha gati me litar me krejt, at'hëre ato m'tërhekshin. Nja dy herë m'ka nxanë vajza e madhe t'u pi hapa pa kurrfarë kontolle. Po ajo pat reagu shpejt.

Mas tri vjete që jom kthy n'Kosovë, osht ardhë burri. Edhe n'prezencë t'vajzave m'ka gjuitë n'krevet. M'ka dhunu, "A osht mirë me t'dhunu paramilitarët?"

Edhe ajo i bjen dhunë se tri vjet s'e kom pa. "A osht mirë me t'dhunu, a osht kënaqësi?", "A o knej?", "A o anej?" - bërtitke. Bërtit çikat, piskat. Bërtitshin me t'madhe, piskatshin, kajshin. Kajsha vetë. E kom thanë, "Shkon!" demek thirrne dikan, me dorë. Kanë shku e kanë thirrë kojshinë e kanë hjekë prej trupit tem. Mirë që nuk kom pas metë shtatëzane se ma s'di. M'u ka bo traumë, shkova n'spital. Shkova n'spital tetë javë kom pasë nejtë. N'neurokirurgji. Edhe analizat kurr s'ëm dilshin mirë. Kurrë asnji analizë mirë s'ëm dilke. Kur m'rroke ajo far, uuuh, mise traumë anena, tani kjo knej... Mas dy muajve kur m'kanë bo analiza tha, "Ti gru je shatëzane" "Çka?" "Je shtatëzane" Thash, "Po du me abortu. Po du me abortu". Shkova me abortu tha mjekja, "Nuk guxoj se je shumë pagjakësi. Je pa gjak." Abortova.

Kisha pasë një mesazh për gratë që le ta ngrehin zanin, le të nihet zani i tyne se pa folë vetë kërkush s'folë përtyn. Pa e kallxu historinë tane, kurrë kërkush s'ka me e ditë çka t'ka ndodhë ty. Veç le t'na ndihmon shoqnia, mos me na përbuzë, mos me thanë "O valla qajo", "O valla qekjo", "Hajde se e dhunumja" hajde jo se kështu-ashtu, me na përkrahë me një fjalë. Me na përkrahë shoqnia qysh o ma mirë.

Rrëfimi Mbështetës 1 - AGIMI:

UNË DUA TË DËGJOHEM

Libër kujtimi me rrëfimet e grave të mbijetuara
të torturës gjatë luftës së fundit në Kosovë

• KTHIMI IDEALIST

Ai e kishte jetën e mirë në Zvicër, por kishte vendosur që të kontribuonte në çlirimin e Kosovës.

Qëllimin e kishte që të ndërtonte edhe në Kosovë një vend ku u ofrohet e ardhme fëmijëve të tij. Lufta e goditi në pikën më të dobët këtë luftëtar, në grua dhe fëmijë.

Sot është krenar, por nganjëherë turbullohet kur mendon se ndoshta fëmijëve u ka ofruar të ardhme më të keqe se sa do ta kishin sikur të kishte qëndruar në Zvicër.

“Vështirë ashtë. Sidomos te na shqiptarët qysh e kem traditën. Shoja më tregoi menihere qysh ju ka kanë...”

Rrëfimi në vetën e parë:
• **DUHET ME PËRKRAHË...**
Agimi

Në luftë jem kanë... edhe mas dy mujve s'kem ditë as ku janë fmija. Masanej tanë, t'u pyet kah janë shku, a i kanë çu n'Shipni a n'Maqedoni a... i kom gjet, aty te duzina.

Krejt kohën unë ushtar kom qenë në Ushtrinë Çlirimtare. Kom ardhë prej Zvicre me gjithë familjen këtu, po fati e deshti, na rroki lufta. M'i kontribu atdheut. Për qat punë kena ardhë. Edhe sa kom qenë atje, tonat... domethonë çka jonë kanë kontributet e mijë e krejt, i kem dhanë ndihmë.

Dy muaj se kam ditë ku janë fmija. Hiç, hiç, absolut. Edhe ata e kanë ditë që unë

jom i vdekun... s'kom ditë a i kanë marrë najkon, le tani që i kanë bo ashtu... Vështirë ashtë. Sidomos te na shqiptarët qysh e kem traditën. Shoja më tregoi menihere qysh ju ka kanë... Po, sen... pa marrë parasysh, fëmiut tënd me ia bo diçka, a e ki pa me dhunë, edhe nuk t'don, po mundohesh me e mbrojtë. E çka i komthonë, i kom thonë, "Përkrahjen e ki temen".

Tani e kam ditë për ato që ka ndodhë. Kom mendu për fëmijëtë tonë. Edhe e di çfarë martese kena pasë deri sa nuk u konë lufta.

U kanë martesë shumë e mirë.

Kemi jetu ne Zvicer. Shumë jetë eqetë. T'dytë t'u punue, le që e kena pasë për shembull tonëve ju kena nihmu krejt familjes, çka kena pasë akreba, çka kena pasë. Rrogën e kom pasë mi 4200 frankë, e kom pasë une, edhe shoja kah 2000, 1500-2000, s'po m'kujtohet. Jeta u kanë e mirë. .. Po qe, kërciti lufta, erdhëm këtu, metëm. Tash çka o ma e keaja, nuk jom njeri i zhgënjamë... s'di sa po m'kuption, që jom konë ushtar, krenohem. Se pak a shumë, fëmia e mi e dijnë, e dijnë akrabaja që e kom lonë une Zvicren për me luftu. Por fëmia e mi nuk e kanë qato, tash ardhmérinë për shembull qysh kom menu une. Ose që kishin mujtë me e pas sikur me kanë atje... Po vallahi, qysh me thonë, kanë mujtë me pasjetën e mirë, e tash ni shpi menxi e kom maru me ndihma. Po apet i lumbtun, shyqyr fmiacionë shnosh, shoja e di, po çka me bo. Fati, fati...

Unë i kom thonë shoqes, "Çka t'kish, une jom mas teje". Me çfarë mënyre? Ku t'dushë, "Mos m'thuj... e as mos m'kurse sikur qysh i kena pasë, domethonë para luftës atë jetë, e qat lumburi, e tash unë ta ofroj. As që menoj për shembull, a din, me s'di qysh..." thatë ni fjalë popullore "Me ia zanë krytë" a din sikur eh... Asnihere, kurrë, kurrë hiç n'jetën time s'ia përmeni, se e di une çka osht' dhuna. Une jom konë n'luftë, edhe na kena mujtë me bo çmos, po s'e kena ba atë punë. Se na shqiptarët e kena ni mentalitet pak ma ndryshe, se ata.

Me folë haptaz, unë nashtajo si para lufte, si mas lufte, a din me to jom konë. Se tash te ajo ka ndiku bukur shumë. Edhe me ju afrou ma shumë ish shqetësu. Po standard t'u i folë edhe t'u i... ka ndodhë edhe ma keq i kom thanë, ja i ke rritë fminë, ja a din... Po e ki përkrahjen tem. Me mu je, as nuk t'anashkaloj e me t'thonë e me t'a përmend... jo, jo, jo hiç. Edhe... e ka gjithmonë përkrahjen sa te ka ymrin me mu.

Me pasë mujtë me kthy qysh u konë koha po... ama nashta nuk mundem me e kthy atë periudhë. Po, edhe tash, çka me bo,jeta vazhdon... jeta vazhdon, duhet me u ballafaqu me çdo sfidë.

Ka raste që andërr sheh, andërr sheh. Jo veq ata, por edhe senet tjera në luftë. Andërr sheh që ia kanë marrë edhe fmitë me ia vra. Tani shqetësohet. Nuk u konë për shembull veç dhuna, po u konë edhe senet tjera që i kanë përjetu.

Unë, i kisha porositë që as kto nuk e kanë bo me qef. Qefi osht' tjetër. T'flasim sinqerisht, dhuna. Dej para lufte mirë o kanë si bashkëshorte, si shokë si... pa marrë parasysh, edhe tash duhet me përkrahë. Dhuna osht' armë n'veti, asaj s'mundet me i dalë përpara kërkush. Qajo, ishalla nuk provohen mo, a din, n'luftë as fmitë tanë as... Se unë e di çka o lufta, e qajo ish... Unë kisha thanë që me përkrahë secili qe e dion qka ka perjetu femna ne liufte, e jo me e zhdukë, a me e shtypë, e nashta edhe ma keq, shoqen a... pa marrë parasysh motrën a. Kadal se kjo dhunë osht'!

Rrëfimi Mbështetës 2 - M.P. :

UNË DUA TË DËGJOHEM

Libër kujtimi me rrëfimet e grave të mbiqetuarar
të torturës gjatë luftës së fundit në Kosovë

• UNË KAM VENDOS ME E PËRKRAH

Ish ushtari i UÇK-së nuk e ka të lehtë jetën. Nuk e ka pasur të lehtë prej momentit kur e ka vëzhguar me dylbi dhunimin e një grupei të grave. Pjesë e atij grupei ishte edhe gruaja e tij. Ky burrë që tash është bërë mbështetësi me i madh i gruas së tij, e ka parë dhunën duke qëndruar në një shpat rrëth dy kilometra larg vendit të ngjarjes. Thotë se askush nuk guxon t'ia përmend atë që i ka ndodh gruas së tij. "Edhe mirë që nuk guxojnë".

“Unë jom kanë n'mal. Jo bash personalisht gruan time se kom pa, por i kom pa të tjerat kur i kanë marrën. S'di... I kom pa kur nisën me i nda prej grupit. Kur ju kanë hi, i kanë rrehë edhe i dajshin. E kom pa aty dhunën që o përdorën. Dhunën seksuale e kom pa.”

Rrëfimi në vetën e parë:
• **UNË GJITHË I THEM HIÇI MENDTË PREJ ASAJ**
M.P

Unë e kom përkrah me ato mundësitë e mijë sa kom mujt edhe ma shumë sot kisha mujt, po sa kom pas mundësi tjera... Po e lehtë nuk o kanë as përmu e as përata. N'ato momente ma vështirë, ma vështirë, s'ka.

Unë jom kanë n'mal. Jo bash personalisht gruan time se kom pa, por i kom pa të tjerat kur i kanë marrën. S'di... I kom pa kur nisën me i nda prej grupit.

Kur ju kanë hi, i kanë rrehë edhe i dajshin... barrën... e kom pa aty dhunën që o përdorën.

Dhunën seksuale e kom pa. E kanë kapë, si, kur e kanë kapë tanë nuk dojke me u pajtu, bërtitke. Se na jena kanë n'shpat n'mal. N'mal jena kanë na. E shihsha... Largësia o kanë, prej shpatit edhe aty, o kanë një dy kilometra.

Si shpat, knej janë kanë arra edhe do vorre janë kanë aty. Aty janë tubu krejt. E unë isha n'shpat aty, at'herë u shihke krejt ajo. Na ishim palu aty. Metëm midis

masakër ma e madhe!”. Vështirë o kanë puna m'u durue ajo. Unë kom pa femën, kush o kanë ajo s'di kush o kanë, e kanë kapë për dy krahësh, e ajo nuk u dorëzojke, ja kanë shkelë duartë, ja kanë shkelë njanën knena, njanën anena, edhe e kanë...Mozomakeq... Si qata unë as se kom njoftë as kurgjo po...

Vetën kom deshtë me e vra. Vetën. Se jo personalisht t'itemën... Unë nuk e di. Vrasja osht e paqt. Mu pas vra, kisha vajtu nji javë ditë, a dy edhe ma as vetën as ata. Ama kjo tanë jetën. Kjo, unë mundona me hupën, mundona e krejt po nuk osht bash e lehtë kur mu përkujtohen këto krejt sene që i kem pa anena. Edhe kjo at'herë e ndien vetën si n'rreth aty. Edhe kjo e ninë vetën keq si po kujtojnë...tash nashta e kanë marrë keq se përnjime tash o përhapë informata që u kanë në atë grup. Tash po e ninë. Bash nji vade jom kanë, kur e pata, e kqyrshin këta çunat, “S'muj me nejt se po m'kqyrin.”, demek.

Noshta se kanë kqyrë po kësaj ju duke edhe o dashtë mu çue prej dasmës, erdha n'shipi se s'muji me nejtën. Tani unë, qysh e kom ndi vetën ashtu, po tjetër mënyrë s'po kam unë...S'po ka mundësi tjetër.

Ajo menihere mas lufte, ishte një kohë e gjatë që ka qenë e izolume. Mas dy – tri javë e kena... i bjen domethanë shkurt qat'herë i kanë lëshu.

At'herë e pashë si ajo te mjekë kërkoi ndihmë. Te mjekët pat shku... Kanë ardhë t'hujtë njihere e kanë kqyrë. T'hujtë e kanë kqyrë i kanë thanë, “Kjo ka shkue n'minimal. S'ka.” Tani o kanë si gjendje e dobët e sajna, psiqike...Tani e kena çu n'psikiatri. N'psikiatri ka nejt nja dy javë, tri, ka nejtën qashtu me barna. Edhe shoqata i ka ndihmu, i ka ndihmu fort si me fjalë, si me barna, si me këto. E kena ardhë deri qetu. Veç punë e lehtë kjo nuk o. Punë ma e vështirë nuk ka.

E vështirë për mue. Për mue edhe për çdo njanin si e ka marrë vesh. Se ka shumë që nuk lajmërohen. Nuk don edhe... edhe ma mirë që se di kurrikush hiç se nashta ma mirë ish kanë. Mos me e dit kurrikush hiç. Por ajo mund ndodhë, ajo ka ndodh. S'ki çka i bon. Me qefs'ka ndodh po me...

Unë kurrë se kam fol me kérkan hiç për këta që i ka ndodh gruas.

Fëmija deri vonë, se kanë kuptu. S'kanë mujtë. Deri vonë. Qetashti e kanë marrë vesh.

Nuk ju vjen mirë as atyne, nuk ju vjen mirë. E vallahi kto janë punë t'vështira, këto janë punë t'vështira. Këta veç kush e ka provu Zoti, e din zemra e tina e shpirti i tina. Tash kom nis me ni kënaqësi pak. Me jetën. Emocionale... Vallahi njiherë n'fillim o kanë pak problem. Po tash pak po lehtohet pak. Në fillim veç menojsa “Çka me bo? Pse u bo kështu? Çka me bo? Qysh? Qysh?”, Veç njeri sikur i huptë. A e ki pa, pa vullnet, i pa jetë. Ma mirë t'ish vra, ma mirë me vdekë, ma mirë kështu. Po tani u duhke, për hatri t'sajna, o duhke mu paraqit unë me fjalë pak ma ndryshe se s'guxojsa me e kallxu vetën qysh po e ndi ashtu. Ajo ish tu vujtë. Kajke. Dilke n'bahçe kajke. Qashtu dilke atje, u ungjike aty edhe ma s'dike me ardhë. Veç unë i kom ndihmu prej fillimit. Kjo s'kish ditë kurrikah me shku hiç. I kom thanë, “E hiçu asaj pune. Ato kanë ndodhë me zor. Ata janë shkije. Ata nuk kanë... Ata për inati e kanë bo nasha ma fort sesa... E tashti nuk ka bo ajo veç, dy, po kanë bo edhe shumë. Kështu ndodhin këto luftëra, ndodhin.” Kta njerëzt! Nuk janë kanë as gjinët ashtu që i kanë bo, se jo shtazë hesapi. Munona me ja hjekë, “E hiçju asaj pune se ajo sikur mos me pas ndodhë hiç. Sikur mos me pas ndodhë hiç. Hiçu, shlye ata”. Po s'munet. Edhe vet nuk po mundet. Kështu për afërsinë, gru - burr nji kohë o kanë ma vështirësi. Mandej po. Ka mujtë.

Tash jena ma mirë. Tash unë këta, jetën e jap, e këta se jap. Unë këta e njoh. E qysh përpara o kanë e qysh. Po çka me bo, i ndodhi. S'ki çka i bon. Me vajtu muj sa t'duash po badihava. Njihere natën te mjekë e kena çu. Se tani pi bjen edhe t'ligëtit edhe munim. Me tension tani po bohet. Po bjen sikur... Ma s'pari herë kur i ka ra qashtu edhe thash, "Vdiq!" edhe vdiq aty. Edhe e çojmë te mjekë. Bile njihere kur kanë ardhë të KFOR-it me na e kontrollu mas luftës përnihere, kjo se ka ditë, si i ka pa si janë hi, si i ka pa, veç kur u ra.

Si i ka pa ata me tesha si janë hi, tha, "Erdhën shkitë!". Ish kanë përkthyesi me ta. "He çka ka?" edhe shkumojke, ma s'dike. E kanë kapë e kom çu n'Klinë. E kom çu n'Klinë, e kanë mjekue, i kanë dhanë ndihmë. Atëherë u kthjell masanena. Thanë, "Pse bre?" Thashë, "I ka metën se ajo nuk e dike se jeni KFOR-i e jeni përpaqe". I ka vy pak me ardhë në veti.

Ju erdh keq. A te kjo ndikoi keq. Ndikoi keq. Për katër orë ka nejtë n'spital, nuk dike as e gjallë as knej.

Tash i ndodh, por ma rrallë. Ma rrallë tashti. Po tashti po përdor barna e po përdor qesi senesh. Po ma rrallë. Kanjihërë i duket sikur i sheh n'televizor... edhe ajo shkon e i përcjell kur ka qasi sene. Tani e shoh menjihere i ngritet tensioni. I kom thanë, "Mos i qyrr ato. Leji tashti n'kry ato. Tashti mi qyrr t'tjera sene.

Njiherë o kanë kjo shumë ligësht. Tani u tutsha që, pe dinë... qysh me i ndihmu me e shërue e çue. Se o kanë fort, fort ligësht o kanë. Veç lekura i ka mbetë. Tani masanena kur ja nisi mu përmirësu, e qetu t'fundit po mu duket tash ma mirë. Po komunikojna ma mirë. E shtime qatë mu angazhu n'bahçe e anena me ja hup ato. Kanjihere dal edhe e shëtit, hajde me dalë qashtu. Ka qef, ka qef me dalë n'tjetër anë, n'tjetër sen, i ndryshon, sesa n'shipi.

Unë i vetëdijshëm jam. Mu kurrikush s'guxon me ma thanë edhe mirë që nuk guxon me ma thanë.

Edhe hoxha kish folë përbajram. "Ato motrat që janë t'dhunume, ato duhet me e mbajtë kryet naltë edhe duhet me kanë t'lumtuna. Nuk duhet me kanë të mjerë e nuk duhet me kanë, se ato nuk e kanë bo me qefin e tyne." E ajo i ka ndihmu tani shumë. "Mos i quani, përkrahni, domethanë... nuk janë kanë...qashtu".

Unë u kisha thanë krejtve që e kanë përjetu me e harru krejt. Me harru e mos me e majt aty e me mendu hiç edhe me kanë sikurse me kanë përpara e me kanë edhe tash. Unë qashtu kisha pas qef me kanë edhe duhet me kanë. Po duhet me kanë. Po tash mundësitet sa mujnë, sa mujnë m'u përmirësu, sa mujnë m'u kanë. O n'rreth t'mirë. Na jena si e përkrahum, e kuptojmë. E dikush ka, ka nashta ka si nuk din ma tepër, nuk sheh ma tepër, ai mundet edhe me gabue.

Kjo domethanën, ka ndodh pa dëshirën e sajna. E vështirë osht boll, e pakojshme asht boll, po... duhet mi harru...

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18-94
323.282-055.2(496.51)(047)

Unë dua të dëgjohem : libër kujtimi më rrëfimet e grave të mbijetuarat të torturës gjatë luftës së fundit në Kosovë / udhëheqësit e projektit Korab Krasniqi, Kushtrim Koliqi. - Prishtinë : Integra, 2017. - 130 f. ; 21 cm.

1.Krasniqi, Korab 2. Koliqi, Kushtrim

ISBN-978-9951-8941-1-1

UNË DUA TË DËGJOHEM

Fuqizuar nga **Integra** dhe **forumZFD** – programi
në Kosovë në bashkëpunim me **Qendrën
Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarëve të
Torturës.**

Mbështetur nga: Rockefeller Brothers Fund,
Charles Stewart Mott Foundation, Ministria
Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
e qeverisë Gjermane, dhe UN Women.

ISBN 978-9951-8941-1-1



LIBËR KUJTIMI ME RRËFIMET E GRAVE
TË MBIJETUARA TË TORTURËS GJATË
LUFTËS SË FUNDIT NË KOSOVË
PRISHTINË 2017